

Prof.Dr.Hfz
Hajredin Hoxha

LEKSIONE METODOLOGJIKE NGA SIRE-JA

BIOGRAFIA E TË DËRGUARIT TË ALLAHUT,
MUHAMEDIT ﷺ



Prof.Dr.Hfz. Hajredin HOXHA

LEKSIONE METODOLOGJIKE NGA

S I R E-ja

(Biografia e të Dërguarit të Allahut, alejhis salatu ves selam)

Përktheu:

Sedat ISLAMI

Recensent: Ajni Sinani

Redaktore gjuhësore: Mimoza Sinani

Përmbajtja:

Ligjërata I: HYRJE NË STUDIMIN E SIRES PEJGAMBERIKE

Ligjërata II: PERIUDHA E INJORANCËS - PËRMBLEDHJE E SHKURTËR RRETH GJENDJES FETARE NË SHEK. VI GREGORIAN

Ligjërata III: SEKRETI I PËRZGJEDHJES SË GADISHULLIT ARABIK PËR SHPALLJEN E FUNDIT HYJNORE

Ligjërata IV: GADISHULLI ARABIK PARA SHPALLJES SË ISLAMIT

Ligjërata V: NGA LINDJA DERI NË PEJGAMBERLLËK

Ligjërata VI: VETMIMI NË SHPELLË DHE FILLIMI I SHPALLJES

Ligjërata VII: PERIUDHAT DHE ETAPAT E PREDIKIMIT GJATË JETËS SË PEJGAMBERIT [*ALEJHIS SALATU VES SELAM*]

Ligjërata VIII: TORTURAT DHE DHUNA FIZIKE NDAJ BESIMTARËVE

Ligjërata IX: POLITIKA E NEGOCIATAVE

Ligjërata X: BLOKADA EKONOMIKE

Ligjërata XI: MIGRIMI I PARË NË ISLAM

Ligjërata XII: DELEGACIONI I PARË TEK PEJGAMBERI [*ALEJHIS SALATU VES SELAM*]

Ligjërata XIII: VITI I DËSHPËRIMIT

Ligjërata XIV: MIGRIMI I MUHAMMEDIT [*ALEJHIS SALATU VES SELAM*] NË TAIF

Ligjërata e parë:

HYRJE NË STUDIMIN E SIRE PEJGAMBERIKE

1. DEFINICIONI
2. KARAKTERISTIKAT
3. OBJEKTIVAT, DHE
4. BURIMET

1. Njoftim me protagonistin e kësaj sireje (biografie)

Në këtë ligjëratë, me lejen e Allahut, do të flasim për zotërinë e të gjithë pejgamberëve dhe të dërguarve, zotërinë e mbarë njerëzimit, Muhammedin, pejgamberin e mëshirës dhe udhëzimit, atë të cilin Allahu e dërgoi për tërë njerëzimin dhe e dërgoi mëshirë për mbarë botët.

Do të flasim për njeriun më të përsosur, më të mençur, për më oratorin, më të përmbajturin, për tiparet dhe atributet e tij, për butësinë dhe faljen me gjithë mundësinë e hakmarrjes dhe ndëshkimit, për durimin, bujarinë, fisnikërinë, shpirtgjerësinë, për tolerancën, guximin, çiltërsinë dhe dëlirësinë në respekt e dashuri, për mirësjelljen e tij (si bashkëshort), për mëshirën dhe dhembshurinë e tij me të gjitha krijesat, për kureshtjen e tij për besimin e tyre, për modestinë me gjithë pozitën e madhe që kishte, për besën, sinqeritetin dhe nderin, për devotshmërinë - asketizmin në dynja, frikën prej Allahut, respektin e tij për Allahun dhe adhurimin e përsosur për Të. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ishte njeriu në personalitetin e të cilit ishin mishëruar vlerat morale; Kur'ani ishte morali i tij.

2. Karakteristikat dhe veçoritë e këtij Pejgamberi të madh në raport me pejgamberët e mëparshëm

Allahu e gradoi dhe i dha privilegj Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] ndaj pejgamberëve të tjerë për urtësi që vetëm Ai i di. Nëpërmjet prezantimit të disa ajeteve kur'anore dhe krahasimit do të mund të mësojmë diç konkrete nga kjo.

Allahu, përkitazi me Musanë [*alejhis salatu ves selam*], njërin prej Ulu'l Azmit (pesë pejgamberëve më të dalluar) ka thënë:

... e unë u nguta te ti, o Zoti im, që të jesh i kënaqur ndaj meje!" (Taha, 84.)

Ndërsa përkitazi me Muhammedin, [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë:

E Zoti yt do të të japë ty, e ti do të kënaqesh." (ed-Duha, 5.)

Vërtet, ka dallim ndërmjet dy pozitave (të përmendura në këto dy ajete.)

Në një rast tjetër për Musanë thuhet (citohet Musai):

Ai tha: "Zoti im, unë e ngarkova veten e Ti më fal mua!" Dhe Ai ia fali, se Ai është që fal shumë, është mëshirues." (el-Kasas, 16.)

Ndërsa për Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] thuhet:

Ne ty të dhamë (vendosëm për) një fitore të sigurt. 2. Ashtu që All-llahu (pas fitores) të liroi ty prej mëkateve (që t'i mbathën) të mëparshme dhe prej atyre të mëvonshme (kur njerëzit do ta pranojnë fenë islame dhe nuk do të jenë më mëkatarë) dhe ashtu të plotëson mirësinë e Vet ndaj teje e të orienton ty në rrugën e drejtë." (el-Fet'h, 1-2.)

Prapë Musai [*alejhis salatu ves selam*] citohet të jetë lutur:

Ai (Musai) tha: "Ma zgjero (më ndihmo) gjoksin tim!" (Taha, 25.)

Ndërsa për Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] thuhet:

A nuk ta hapëm Ne gjoksin tënd? 2. Dhe Ne hoqëm prej teje barrën tënde," (el-Inshirah, 1-2.)

Dallimi ndërmjet dy rasteve nuk ka nevojë për koment.

Nëse Musai [*alejhis salatu ves selam*] ishte lutur:

“Dhe më lehtëso në këtë punë timen!” (Taha, 26.)

- ne gjejmë në Kur'an se Allahu i është drejtuar Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]: ***“Dhe Ne do të drejtojmë ty në më të lehtën.”*** (el-A'la, 8.)

Dallimi ndërmjet dy gjendjeve është i qartë.

Prej emrave të Allahut, që janë përmendur disa herë në Kur'an, janë edhe err-Rreuf dhe err-Rrahim, e pikërisht këta dy emra i janë dhënë edhe Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], siç thotë Allahu:

Juve ju erdhi i dërguar nga lloji juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është lakmues i rrugës së drejtë për ju, është i ndejshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët.” (et-Teubeh, 128.)

E se sa i rëndësishëm është Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] ose ç'pozitivitet i ka dhënë Kur'ani, mësojmë më shumë kur shohim edhe betimin për jetën e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]. Në Kur'an thuhet:

“Pasha jetën tënde (Muhammed), s'ka dyshim se ata (populli i Lutit) ishin të humbur në dehjen e tyre.” (el-Hixhr, 72.)

Në Kur'an, Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] është thirrur me emrat më të bukur:

“Që pranojnë të dërguarin (Muhammedin), pejgamberin arab, (që nuk shkruan as nuk lexon), të cilin e gjejnë të cilësuar (të përshkruar me virtytet e tij), tek ata në Tevrat dhe në Inxhil, e që i urdhëron ata për çdo të mirë dhe i ndalon nga çdo e keqe, u lejon ushqimet e këndshme dhe u ndalon ato të pakëndshmet, dhe heq nga ata barrën e rëndë të tyre dhe prangat që ishin mbi ta. Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit.” (el-A'rafë, 157.)

“O Pejgamber! All-llahu të mjafton ty dhe besimtarëve që janë me ty.” (el-Enfale, 64.)

Nëse mrekullitë e pejgamberëve të mëparshëm ishin të lidhura me kohën, mrekullia e Pejgamberit Muhammed [alejhis salatu ves selam] – Kur’ani – është i përjetshëm. Allahu e ka marrë në mbrojtje atë.

“Ne me madhërinë Tonë e shpallëm Kur'anin dhe Ne gjithsesi jemi mbrojtës të tij.” (el-Hixhr, 9.)

Allahu e lëvdoi moralin e tij në Kur’an e tha:

“Vërtet, ti je në një shkallë të lartë të moralit!” (el-Kalem, 4.)

3. Objektivat e studimit të sires

a. Kuptimi i personalitetit të tij prej pejgamberi, nëpërmjet jetës dhe rrethanave në të cilat jetoi, për të rezultuar kështu me të vërtetën e pamohuar se Muhammedi [alejhis salatu ves selam] nuk ka qenë vetëm i mençur (siç thonë ata që ia mohojnë pejgamberësinë), por përveç kësaj ka qenë edhe i Dërguar prej Allahut.

b. Që besimtari të gjejë një model që meriton të pasohet në çdo çështje të jetës, kështu që ta përvetësoje siren si program jete. Zaten, Allahu e bëri Muhammedin [alejhis salatu ves selam] shëmbëlltyrë të tërë njerëzimit:

“Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e All-llahut, kuptohet, ai që shpreson në shpërblimin e All-llahut në botën tjetër, ai që atë shpresë e shoqëron duke e përmendur shumë shpesh All-llahun.” (el-Ahzab, 21.)

c. Që besimtari të gjejë një ndihmëtar në sire për të kuptuar Kur’anin dhe për të shijuar shpirtin dhe qëllimet e tij ngase shumë ajete kur’anore komentohen dhe qëllimi i tyre zbardhet nga rastet dhe ngjarjet nëpër të cilat kaloi Muhammedi [alejhis salatu ves selam].

d. Që nëpërmjet studimit të sires, muslimani të fitojë sa më shumë kulturë dhe njohuri të vërteta islame.

e. Që edukatori dhe thirrësi të kenë shembuj të gjallë për mënyrën dhe metodat e edukimit dhe mësimin.

f. Jeta e Muhammedit [alejhis salatu ves selam] përfshin të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe njerëzore, kështu që ajo do të ishte një model i mirë për të rinjtë se

si duhet të jenë të vendosur në të vërtetën, për përgjegjësinë se si duhet të jenë besnik ndaj popullit, për hoxhën se si duhet të thërrasë në fe me urtësi dhe këshillë të mirë, për presidentin se si duhet t'i udhëheqë me mençuri politikat e shtetit, për bashkëshortin se si duhet të çojë jetën të mirë me gruan, për babanë me fëmijët e tij, për komandantin e shkathët ushtarak dhe për politikanin e sinqertë burrështetas....

g. Që sireja të jetë kultivuese e besimit, rritëse e moralit, larguese e së keqes dhe nxitëse e përqaimit të së vërtetës dhe mbajtjes së saj...

h. Që besimtari të kuptojë se i Dërguari i Allahut duhet të jetojë në zemrën dhe ndërgjegjen e tij, në punën dhe veprimtarinë e tij, në mendjen dhe idetë e tij, e që të mos mjaftohet vetëm në dërgimin formal të salavateve për të...

4. Burimet dhe referencat e sires pejgamberike

Nr.	Titulli	Autori
1.	Es-Siretu-n-Nebevijeh	Ibn HISHAM
2.	Kitabu-sh-Shifa	Kadi IJJAD
3.	Es-Siretu-n-Nebevijeh	Ibni KETHIR
4.	Es-Siretu-l-Halebijeh	Ali Ibn Burhanuddin el-HALEBIJ
5.	El-Megazi	El-VAKIDIJ
6.	Err-Rreudu-l-Unuf	Es-SEHLIJ
7.	Hatemu-n-Nebijine	Muhammed Ebu ZEHRE
8.	Abkarijetu Muhammed	Abbas Muhammed el-AKKAD
9.	Fikhu-s-Sireh	Seid Ramadan el-BUTI
10.	Fikhu-s-Sireh	Muhammed el-GAZALI

Ligjërata e dytë:

PERIUDHA E INJORANCËS - PËRMBLEDHJE E SHKURTËR RRETH GJENDJES FETARE NË SHEK. VI GREGORIAN

1. FEJA ÇIFUTE
2. KRISHTERIMI
3. ZJARRPUTIZMI
4. BUDIZMI
5. ARABËT
6. ARABËT PARA SHPALLJES SË ISLAMIT

Studiuesit dhe hulumtuesit e kanë të qartë se fetë e mëparshme, librat dhe ligjet e tyre, kanë rënë pre e shtrembërimeve të injorantëve, mashtruesve dhe shtrembëruesve. Sikur të bënim një hulumtim në historinë e njerëzimit nga aspekti i besimit në Allahun e Madhëruar dhe takimin me Të, do të gjenim se kjo botë i ngjan një të dehuri, që më shumë rri i dehur sesa i kthjelltë, apo (i ngjan) një të sëmuri nga ethet, të cilit i ka humbur vetëdija nga sëmundja e flet jerm duke mos ditur fare... Vetëm Zoti e di sa kohë ka kaluar që nga fillimi i dynjasë e deri tek Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] dhe sa civilizimi e kultura janë shuar. Civilizimi i lashtë egjiptian, grek, indian, kinez, persian e romak kanë mbetur vetëm në histori...

Pastaj edhe nga aspekti logjik dhe emocional, idhujtaria kishte bërë të vetën. Njeriu i qe nënshtruar gjërave më të pavlera. Adhuroheshin lopët, drurët, gurët, ndërsa për çudi shumë popuj i kishin përvetësuar kolektivisht këto besime. Idhujtaria është dobësi që vjen nga brendësia e shpirtit e jo nga elementet jashtë

jetës. Ashtu sikurse i dëshpëruari që supozon se depresioni i tij shkaktohet nga gjërat që janë rreth tij, ashtu sikurse i frikësuari që i imagjinon trupat statikë si lugetër, po kështu edhe njeriu i deformuar (shpirtërisht) supozon se dobësinë shpirtërore dhe paaftësinë mendore i ka nga ambienti në të cilin jeton, prej të cilit adhuron dhe glorifikon gjëra që i do, (qofshin këto) nga bota inorganike dhe shtazore... Shekulli i VI-të gregorian i gjeti të fikur pishtarët e udhëzimit në Lindje dhe Perëndim... Zjarrputizmi (adhuruesit e zjarrit) në Persi ishte si patrullë e vrazhdë e politeizmit fashist në Indi, Kinë, vendet arabe dhe në të gjitha qarqet e tjera injorante... (Poeti thotë:)

Erdha ndërsa njerëzit ishin të shthurur

Nuk kaloje pranë ndonjërit vetëm se duke adhuruar idhullin e gjeje

Mbreti romak shtypte popullin e tij

Ndërsa mbreti persian nga mendjemadhësia është bërë i shurdhër dhe i verbër¹.

1. Feja çifute

Feja çifute në fakt emërton një mori ritualesh dhe zakonesh që nuk kanë shpirt, nuk kanë mision për botën dhe ftesë (thirrje) për ummetin. Feja çifute është mishëruar me besimet dhe bindjet e popujve që jetonin përreth apo ishin në sundim të saj, gjë të cilën e dëshmojnë të gjithë sikurse që e dëshmojnë edhe librat e tyre.... Ata pranuan bindje të shtrembëruara apo edhe politeiste dhe vetë Talmudi është dëshmia më e mirë se si idhujtaria ka luajtur një rol tërheqës të veçantë për çifutët... ²

Madje vetë Talmudi, që është libër i shenjtë tek çifutët dhe që ishte në qarkullim në shek. e VI-të, ishte përplot gjëra të çuditshme, të cilat jo vetëm që një mendje e shëndoshë nuk mund t'i pranonte, porse ato ishin dhe një guxim për të kryer mëkate ndaj Allahut, për të shtrembëruar të vërtetat, për të luajtur me fenë dhe mendjen, gjëra këto që dëshmojnë për rënien e mentalitetit (edhe ashtu të ulët) dhe prishjen e shijes (kuptimit) fetar... ³

¹ Shih tekstin e parafrazuar nga Fikhu's Sire i Imam Gazaliut, f. 15-18.

² Jewish Encyclopedia, Vol-XII, p.568-569, cituar sipas: Es-Siretu'n Nebevijeh e Ebu'l Hasen Ali el-Haseni en-Nedevi, f. 24.

³ Ibid.

2. Krishterimi

Edhe Krishterimi pati të njëjtin fat të shtrembërimit. Ai ra pré e shtrembërimeve të radikalistëve, komentimit të injorantëve, idhujtarisë së romakëve të krishterizuar që nga koha e parë. Ndërsa sa i përket trinitetit dhe depërtimit të tij si dogmë fetare në shek. e IV-të, ai erdhi si ide dhe besim se Zoti i vetëm përbëhet nga tri persona... U përhap në çerekun fundit të shekullit të IV-të, ndërsa vazhdoi së ekzistuari si pjesë e kredos së krishtere e pranuar në të gjitha anët e botës së krishtere... ⁴

Krishterimi, më pas, përjetoi edhe ndryshime të tjera rrënjësore. Kësaj radhe u mishëruan me bindje dhe besime politeiste... (Si pasojë) Ata (idhujtarët e hyrë në Krishterizëm) morën një prej dëshmorëve (dhe sipas besimeve të tyre politeiste) i dhanë attribute hyjnore. Pastaj punuan edhe statuja për ta dhe kësioj politeizmi dhe adhurimi i putave depërtoi në fenë e krishtere... Ky shekull nuk mbaroi pa u përhapur gjithandej në botën e krishtere adhurimi i evliave dhe dëshmorëve, si hap për bindjen dhe besimin e formuar më vonë se evliatë bartin attribute hyjnore dhe se ata bashkërisht me shenjtorët janë ndërmjetësues ndërmjet Allahut dhe njerëzve... ⁵

Ndërsa shekulli i VI-të do ta gjente të përçarë botën e krishtere. Të krishterët e Shamit, Irakut dhe Egjiptit do të hasnin në shumë kundërthënie për të vërtetën mbi Isain [*alejhîs salatu ves selam*], kundërthënie këto që do të merrnin edhe karakter të ashpër, kur jo vetëm që do ta shpallnin njëri-tjetrin renegatë porse edhe do të luftonin ndërmjet vete⁶.

3. Zjarrputistët

Ata, qysh nga lashtësia, janë të njohur për adhurimin e elementeve natyrore, me theks të veçantë zjarrit, për të cilin edhe ndërtuan tempuj dhe faltore. Krahas adhurimit të zjarrit, ata madhëruan dhe shenjtëruan edhe diellin, kështu që feja tek ata u bë diç që nënkuptonte një mori ritualesh dhe zakonesh që ata i kryenin

⁴ Shih: Dairetu'l mearifi'l kathulikijeh, artikulli: Et-Tethlith el-mukaddes, vo.14, f. 295. Cituar sipas: Es-Sairetu'n Nebevijeh, f. 25.

⁵ Për më tepër shih: Rev. James Houston Bzxtar: The History of Christianity in the Light of Modern Knowledge. (Glasgow. 1959), p. 407.

⁶ Parafrazim nga referenca paraprake, f. 25-26.

në vendet e tyre të posaçme. Ata e kishin për obligim që ta adhuronin diellin katër herë në ditë, e bashkë me të edhe hënën, zjarrin dhe ujin... Iranianët, gjatë lutjeve të tyre, drejtoheshin nga zjarri. Njëherë kishte ndodhur që mbreti i fundit i sasanidëve, Yazdegerd, ishte betuar për diellin dhe kishte thënë: Betohem për diellin që është zoti më i madh! Pastaj, ata besuan në dualizëm dhe kjo gjë u bë moto e tyre. Ata besuan në dy zota, zotin e të mirës apo dritën dhe zotin e të keqes apo errësirës. Të parin e quajtën Ahurmezda, ndërsa të dytin e quajtën Yezdan⁷.

4. Budizmi

Budizmi është i përhapur në Azinë e Mesme dhe në Indi. Ata i bartin me vete idhujt ngado që shkojnë. Ndërtojnë tempuj dhe faltore në të cilat vendosin statujat e Budës. Dijetarët dyshojnë që ithtarët e kësaj feje besojnë te Zoti që krijoi qiejt, tokën, njeriun, ngase nuk kanë dëshmi që e vërtetojnë një gjë të tillë.

Ndërsa Berhemizmi (hinduizmi) është feja bazë e Indisë, e cila dallohet për faltore dhe zota të shumtë. Zotat e tyre, sipas llogaritjeve të bëra, në shekullin e VI-të ishin 330 milionë. Për ta çdo gjë e mirë dhe e dobishme ishte zot që adhurohej. Në këtë kohë gdhendja e statujave ishte profesioni që kishte arritur kulmin e zhvillimit. Padyshim se idhujtaria ishte e përhapur në tërë botën dhe pothuajse se të gjitha fetë: e krishtere, semite, budiste, garonin se kush do t'i shenjtëronte më shumë idhujt...⁸

5. Arabët

Arabët, që besuan në fenë e Ibrahimit [*alejhis salatu ves selam*] dhe qëndruan në tokën e Shtëpisë së Allahut (Mekë), për shkak të distancës kohore të madhe nga koha e pejgamberisë dhe izolimit në gadishullin e tyre, kohët e fundit qenë sprovuar me një lloj idhujtarie, e ngjashme me atë të hinduizmit. Ata i përshkuan Allahut shok dhe krahas Tij adhuruan edhe zota të tjerë, për të cilët besuan se kanë ndikim në gjithësi, se mund të bëjnë mirë dhe keq, se mund të krijojnë dhe vdesin... Aq shumë u përhap idhujtaria saqë qe e pamundur të gjeje familje, fis apo qytet pa idhujt e tyre të veçantë. Në brendësi të Qabesë, të cilën e ndërtoi

⁷ Shih: Arthur Christensen, *Iran fi ahdi's Sasanijjine*, f. 155.

⁸ The Discovery of India, Jawahir Lal Nehru, p.2001-2002; C.V. Vaidya: History of Mediaeval Hindu India, Vol/ 1 (Poona). 1921, p. 101.

Ibrahimi [*alejhis salatu ves selam*], ishin jo më pak se 360 idhuj. Ata adhuronin gurët, ndërsa për zota merrnin melekët, xhinët, yjet... Ata besonin se melekët ishin vajza të Allahut, ndërsa xhinët ishin ortakë të Tij...⁹

6. Arabët në kohën e shpalljes së Islamit

Koha kur u shpall Islami i gjeti arabët të zhytur në injorancë, epshe, shthurje dhe degjenerim. Ata konsumonin rakinë, luanin bixhoz, ndërsa shpirtligësia e tyre kishte arritur deri në atë shkallë saqë i varrosnin vajzat të gjalla. Plaçkitnin karvanët, ndërsa e nënvlerësonin gruan aq shumë saqë e trashëgonin ashtu siç trashëgohen gjësendet. Ata bënë dallime edhe në ushqime. Disa prej ushqimeve ishin të veçanta vetëm për burrat. Këtij të fundit bile i lejohej që të merrte gra sa donte, pa shifër të caktuar... Disa prej tyre i mbysnin fëmijët duke qenë ende të vegjël nga frika e varfërisë.

Fanatizmi fisnor ishte i madh, ndërsa dashuria për luftën ishte diç e mishëruar me shpirtrat e tyre. Luftërat ndërmjet fiseve vazhdonin me dekada, ndërsa viktimat llogariteshin të ishin me mijëra...¹⁰

Banorët e Mekës ishin shumë të dhënë pas epsheve kështu që nuk logjikonin shumë. Zaten, edhe këto të dyja nuk shkojnë bashkë. Mund të vëresh se si njerëzit që nuk kuptojnë as gjërat më elementare, shtyhen dhe garojnë ndërmjet vete se kush do të grumbullojë më tepër pasuri. Kjo mendjehetësi ka ekzistuar përgjatë gjithë historisë së njerëzimit... Mekasit e mohonin Allahun dhe nuk e besonin Ditën e Llogarisë, ndërsa ishin shumë të dhënë pas kënaqësive të kësaj bote... Ekzistonte një dëshirë e madhe për të sunduar dhe udhëhequr... Fanatizëm degjenerues... Luftohej dhe bëhej paqe vetëm për hir të tij... Në Mekë kishte të atillë madje që ia kalonin edhe Faraonit për nga kryeneçësia. Amr Ibn Hishami duke arsyetuar refuzimin që ia bënte fesë së Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] thoshte: Benu Abdu Menafët na kanë shpallë rivalitet në nder... Thanë se kanë pejgamber që i shpallet... Për Zotin nuk kemi për ta besuar përderisa edhe ne nuk kemi një të tillë që i shpallet. Ndërsa Velib Ibn Mugire i kishte thënë Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]: Sikur pejgamberësia të ishte e vërtetë, unë

⁹ Nedevi, Es-Siretu'n Nebevijeh, f. 30.

¹⁰ Ibid.

do të kisha pasur më shumë të drejtë në të se ti, ngase jam më i moshuar dhe kam më shumë pasuri...

Pikërisht në këtë ambient, me shembuj të tillë devijimi dhe fanatizmi dhe qindra të tjerë të ngjashëm, Islami filloi të përhapet dalëngadalë dhe t'i nxjerrë njerëzit nga errësira në dritë, nga fanatizmi në tolerancë dhe transparencë, nga humbja në udhëzim, madje edhe i bëri pishtarë dhe kandila udhëzues... Islami i ngriti popujt nga humnera në majat e nderit, moralit, krenarisë dhe dijes...¹¹

Ligjërata e tretë:

¹¹ Shih: Gazali, Muhammed. Fikhu's Sire, 1-23.

SEKRETI I PËRZGJEDHJES SË GADISHULLIT ARABIK PËR SHPALLJEN E FUNDIT HYJNORE

1. Evropa
2. Perandoria romake lindore
3. Perandoria iraniane
4. India
5. Sekreti i përzgjedhjes së Gadishullit Arabik

Ishte dëshira dhe vullneti i Allahut që përcaktuan Gadishullin Arabik si vendin në të cilin do të paraqitej i Dërguari i fundit i Allahut për njerëzimin, ndërsa arsye e kësaj përzgjedhjeje do ta kuptojmë vetëm atëherë kur të bëjmë një krahasim ndërmjet këtij gadishulli dhe vendeve përreth në zakonet, traditat dhe fetë e tyre.

1. Evropa

Jetesa e popujve evropianë i ngjante një ferri të vërtetë. Ata shquheshin për injorancë, analfabetizëm, luftëra të përgjakshme, shpërbërje familjare dhe ishin larg çdo civilizimi të mirëfilltë, shkencës dhe edukatës. Ishin të ndytë dhe nuk e përdornin fare ujin për pastrim, sidomos klerikët e tyre fetarë. I ndëshkonin ashpër njerëzit, ndërsa për gruan diskutonin nëse ishte kafshë apo njeri, nëse kishte shpirt të përjetshëm apo jo, nëse kishte të drejtën e shitblerjes apo jo... Disa hulumtues e kanë konsideruar Evropën, ndërmjet shekujve V-X-të, si një cofëtinë kulturore e cila po kundërmonte, ndërsa mësimet e saj po zhdukeshin... Bënin jetë të shthurur, ndërsa ligji që sundonte ishte ai i xhunglës...

Me një fjalë, shekulli në të cilin u dërgua Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] ishte njëri ndër më të errëtit e historisë së njerëzimit, ishte më pesimisti i mundshëm përgjatë gjithë shekujve... Ishte kohë e fanatizmit, jotolerancës. Ndërmjet shtetit sasanid dhe atij bizantin zhvilloheshin luftëra... Kaosi politik dhe shoqëror patën një rol tepër të madh në zhdukjen e kësaj shtrese sikurse ishin faktorët më të rëndësishëm të paralizimit të mendimit njerëzor...¹²

2. Perandoria romake lindore

Është e njohur si Perandoria Romake bizantine, ndërsa arabët e njohin si 'Roma.' Sundonte disa shtete dhe kontinente, si: Greqinë, Ballkanin, Azinë e Vogël, Sirinë, Palestinën, Egjiptin, Afrikën Veriore, ndërsa kryeqytet kishte Kostandinopojën (Stambollin). Historiku i saj fillon në vitin 395 dhe mbaron përfundimisht më 1454, atëherë kur shteti osman mbizotëron mbi Stambollin.

Në këtë shtet ndodhën probleme dhe trazira të shumta, për shkak të të cilave në vitin 532 humbën jetën jo më pak se 30.000 veta. Jeta e tyre ishte përplot kundërthënie. Ata ishin shumë kureshtarë dhe tepër të dhënë pas muzikës, lojës dhe dëfrimit. Arenat e gladiatorëve ku luftohej deri në vdekje, ndonjëherë njeriu kundër njeriut e ndonjëherë edhe kundër egërsirave, ishin vendet në të cilat tuboheshin kolektivisht për t'u dëfryer. E donin dhunën dhe lojërat vrastare. Ndëshkimet i kishin të rrëqethshme. Liderët e tyre bënë jetë luksoze dhe të mbushur përplot me të këqija. Egjipti ishte një ndër kryeqendrat e shtetit bizantin. Ishte i pasur por vuante nga persekutimet fetare dhe politike. Romakët e konsideronin Egjiptin si një dele, e cila milej mirë por nuk e ushqenin mirë. Edhe Siria ishte një ndër qendrat e rëndësishme të shtetit bizantin. Atë e kishin lënë nën administrimin e të huajve, të cilët e keqtrajtonin shumë popullsinë vendase dhe e ngarkonin me gjëra, për përmbushjen e të cilave detyroheshin të shisnin madje edhe djemtë e tyre. Përjetonin tmerrin më të rëndë të mundshëm...¹³

¹² Parafrazim nga: Nedevi, Es-Sirtu'n Nebevijeh, f. 39-42.

¹³ Ibid.

3. Perandoria iraniane

Kjo perandori u themelua në v. 224 nga Erdeshiri. Ajo sundonte Persinë, Azerbajxhanin, Taberistanin, Serhasin, Xhurxhanin, Kermanin, Belhin, Horasanin, Irakun, Jemenin, si dhe disa pjesë të Indisë. Zoroastrizmi ishte feja e tyre, ndërsa Zoroastro ishte shfaqur në shek. e VII-të para erës sonë. Pushtetarët dhe udhëheqësit e patën përqafuar si fe të tyren. Prej filozofisë së saj ishte edhe ajo se martesë e njeriut me nënën, vajzën apo motrën e vet preferohej, madje vetë Yazdegerd II ishte martuar me të bijën¹⁴.

Kjo fe, që nga fillimi i saj, e kundërshtonte idenë e luftës ndërmjet dritës dhe errësirës, shpirtit të së mirës dhe shpirtit të së keqes, zotit të së mirës dhe zotit të së keqes... Reformatori i saj, Mani, i cili u shfaq në shek. III-të gregorian, ftoi në murgëri (largim nga martesë), për të ndalur të keqen dhe trazirat në botë. Ai kishte shpallur se bashkimi i dritës dhe territ është diç prej së cilës duhet shpëtuar, kështu që ai e ndaloi martesën, për t'i mundësuar dritës të triumfojë ndaj errësirës. U internua për vite pastaj u kthye në Iran...¹⁵

Pastaj, në shek. e V-të paraqitet një tjetër devijues i humbur, emri i të cilit ishte Mazdek. Ai ftonte në lejimin e pasurive dhe grave dhe se njerëzit mund të ishin ortakë në to. Si rezultat, njerëzit hynin në shtëpi të ndryshme, merrnin pasurinë dhe çnderonin gratë. Në një dokument historik iranian të njohur si 'Nametenser' thuhet: Nderi që shkelur, ligji nuk respektohej dhe si pasojë që formuar një gjeneratë që nuk njihnte vlera, punë dhe që nuk kishte të kaluar krenare... Nuk iu interesonte asgjë... Papunësia ishte sinonim i tyre... Ishin të aftë dhe të zotë për bartje fjalësh, punë të këqija, shpifje dhe akuza. Kjo ishte gjëja me të cilën ata fitonin jetesën dhe arrinin tek pasuria dhe fama...

Rezultat i këtyre bindjeve dhe ideve ishte edhe revolucioni i bujqve grabitës, të cilët sulmuan pallatet e të pasurve, duke ua grabitur pasurinë dhe gratë, si dhe pronat dhe gjësendet e tjera.

Ndërsa në kohën e sasanidëve, kohë kjo që llogaritet të jetë ndër më të mirat në Iran, në shek. e VI-të, gjendja ishte e rëndë. Populli ishte nën mëshirën e

¹⁴ Buti, Muhammed Seid. Fikhu-s-Sire, f. 30. Shih edhe: Shehristani.El milel ve'n nihâl, v.2, f. 86-87.

¹⁵ Ibid.

mbretërve, të cilët përcaktoheshin sipas trashëgimisë. Ata e konsideronin veten më me vlerë se tjerët, madje mbi gjithë të tjerët dhe (preferonin të) thirreshin si 'zot'... Të gjitha burimet e të ardhurave të shtetit ishin në duart e tyre. Ata kishin shërbëtorë, gra, robëresha, djelmosha (shërbëtorë), si dhe mësues kafshësh. Një gjë të tillë e dëshmon edhe fakti se mbreti i tyre i fundit, Yazdegerdi, kur iku nga kryeqyteti për shkak të çlirimit islam, kishte marrë me vete 1000 kuzhinier, 1000 këngëtarë, 1000 mësues - rritës tigrash, 1000 rrobaqepës dhe pjesë të tjera të suitës së tij.

Populli jetonte në kushte jashtëzakonisht të këqija. Varfëria në njërin anë dhe taksat e larta shtetërore në anën tjetër ia kishin humbur shijen jetës. Ata jetonin sikur kafshë nën kthetrat e dy perandorive, asaj sasanide dhe asaj bizantine.¹⁶

4. India

Populli i Indisë shquhej për shkencat matematikore, për astronomi, mjekësi dhe ishte i zhytur thellë në filozofi. Historianët pajtohen se etapa më e errët e Indisë, si në aspektin fetar po kështu edhe në atë shoqëror dhe moral, ishte në fillim të shekullit të VI-të gregorian. Faltoret tanimë ishin vende për punë të pista. Gruaja nuk kishte asnjë vlerë a të drejtë. Ajo madje jo rrallëherë edhe humbej e fitohej në bixhoz. Ndërsa kur i vdiste burri, pothuajse edhe ajo vdiste. Ajo nuk kishte të drejtë martesë dhe as që meritonte respekt. Ishte përhapur edhe dukuria e djegies së tyre pas vdekjes së burrit, sidomos në shtresën aristokrate, si shenjë respekti për burrin e vdekur dhe ikje nga dëshpërimi. Kështu vazhdoi derisa India u kolonizua nga Anglia. India dallohej nga vendet fqinje për dallime të mëdha shtresore dhe dallime ndërmjet individëve. Ekzistonte një sistem brutal, që përkrahej edhe nga feja dhe besimi. Ligjvënësit indianë në ligjin e tyre qytetar, që kishte një sfond fetar, i kishin ndarë banorët e Indisë në katër shtresa:

- 1) *Brahmanët* - shtresa e priftërinjve dhe klerikëve,
- 2) *Ksatija* -shtresa e luftëtarëve dhe sovranëve,
- 3) *Vaisija* - shtresa e tregtarëve dhe artizanëve, dhe
- 4) *Shudra* -shtresa e shërbëtorëve.

¹⁶ Ibid, 33-34.

Në fakt, kjo e fundit ishte shtresa më e ulët dhe nuk kishte të drejtë tjetër veçse t'iu shërbente tri shtresave të mëparshme....

Ky ligj ua dha brahmanitëve një pozitë të cilën shudranët nuk mund ta kishin. Brahmani ishte njeri me mëkate të falura, nuk i obligohej asnjë obligim material, sikurse që në asnjë rast nuk mund t'i shqiptohej dënimi me vdekje. Shudranët nuk e kishin të drejtën e përfitimit të parave apo deponimit të tyre, sikurse që nuk mund të qëndronin me brahmanët, as t'i preknin me duar dhe as të mësonin prej librave të shenjtë.

India jetonte e izoluar nga bota dhe dallohej për zakone dhe tradita të këqija. Po ashtu ajo dallohej për dallimet e thella ndërmjet shtresave dhe fanatizmin që çonte madje deri në vrasje...¹⁷

5. Sekretet e përzgjedhjes së Gadishullit Arabik

Allahu i Madhëruar i zgjodhi arabët për pranimin e kësaj feje, e më pas edhe kumtimin e saj tek bota mbarë, për arsytet në vijim:

1. Zemrat e tyre, në krahasim me të tjerët, e me theks të veçantë romakët, persianët, indianët, që vuanin nga probleme shpirtërore dhe ideore gati pothuajse të pazgjidhura, ishin (më) të pastra. Ata nuk ishin të ndikuar nga faktorët e jashtëm, fe apo ideologji qofshin ato.
2. Ata (deri diku) ishin në *fitre* (fe të pastër, ose e kishin të freskët fenë e Ibrahimit [*alejhis salatu ves selam*]), ishin njerëz me vullnet të fortë dhe të gatshëm çdoherë për t'u sakrifikuar për të vërtetën.
3. Ishin seriozë dhe aktualë, nuk ishin të mbrapshtë dhe nuk tradhtonin askënd. E kishin bërë shprehi thënien e së vërtetës dhe vendosmërinë e lartë.
4. Arabët nuk vuanin nga luksi dhe shpenzimet e tepruara, kështu që do të ishte e vështirë t'i largoje prej diç me të cilën do të kishin qenë të familjarizuar.
5. Ishin njerëz të sinqertë, e mbanin fjalën dhe ishin trima. Hipokrizia nuk ishte pjesë e karakterit të tyre.

¹⁷ Ibid, 37-38.

6. Ishin luftëtarë të zotë, kalorës me nam, trima të mëdhenj në njërën anë, ndërsa në anën tjetër ishin asketë. Kalorësia ishte një ndër karakteristikat më të theksuara të tyre...
7. Fuqia e tyre mendore ishte e nivelit të lartë dhe, për fatin e mirë të tyre, ajo nuk qe harxhuar së koti me filozofira imagjinare dhe polemika shterpe të tipit bizantin... Ishin njerëz që e kishin marrë jetën me vullnet, vendosmëri dhe entuziazëm.
8. Ishin njerëz që qenë zhvilluar në liri, barazi dhe dashuri për natyrën dhe nuk i ishin nënshtruar ndonjë qeverie të huaj...
9. Dallimet ndërmjet arabëve dhe të tjerëve, duke iu referuar pikës paraprake, ishin vërtet të mëdha. Ata ishin edukuar në frymën e krenarisë dhe madhështisë, kështu që nuk pranonin t'i nënshtroheshin askujt, madje as princërve dhe mbretërve. Në periudhën paraislame, një mbret kishte kërkuar nga fisi Beni Temim një kalë por nuk ia kishin dhënë.
10. Gadishulli Arabik ishte ndërmjet dy superfuqive të kohës që garonin ndërmjet vete, asaj të krishtere dhe zjarrputiste, asaj perëndimore dhe lindore dhe, me gjithë këtë fakt, kishte ruajtur lirinë dhe prestigjin duke mos iu nënshtruar asnjërës nga fuqitë e përmendura më sipër¹⁸.
11. Karakteret e tyre ishin si lëndët e para të papërpunuara në ndonjë uzinë dhe, normalisht, pastërtia dhe natyrshmëria ishte ajo që i shtynte ata nga humanizmi, përmbushja e premtimeve, bujaria, nderi, veçse atyre iu mungonin njohuritë që do t'ua zbulonin rrugën e vërtetë...
12. Pozita gjeografike e arabëve ishte e atillë që shërbente si një pikë ndërmjet dy kulturave, asaj perëndimore materialiste dhe kësaj lindore shpirtërore...
13. Edhe i Dërguari i tyre, por edhe vetë ata, me dëshirën dhe vullnetin e Zotit, ishin analfabetë, ashtu siç thotë Allahu:
"Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ua lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme." (el-Xhumuah, 2)
 Ai, i Dërguari i tyre, nuk pati lexuar më parë dhe as që dinte të shkruante, dëshmi kjo për vërtetësinë e pejgamberisë së tij dhe arsye për të mos dyshuar në të.

¹⁸ Ibid, f. 42-49.

14. Allahu i Madhëruar e bëri Qabenë, e cila ishte vendkthim dhe siguri për njerëzit, shtëpinë e parë për njerëz për adhurim dhe kryerje të ceremonive fetare, si vërtetim të fesë se pastër të Ibrahimit [*alejhis salatu ves selam*] dhe shtrirje të saj deri në amshim...
15. Allahu me urtësinë e Tij caktoi që gjuha e Librit të Tij, Kur'anit, të jetë gjuha arabe, gjuhë kjo që shquhet për specifikat, karakteristikat dhe dallimet nga gjuhët e tjera. "*...Më së miri All-llahu e di ku ta vërë dërgesën (risalen) e Vet...*"¹⁹

¹⁹ Pjesë e ajetit 124 të kaptinës el-En'amë. Shih: Buti, Muhammed Seid Ramadan, f. 30-33.

Ligjërata e katërt:

GADISHULLI ARABIK PARA SHPALLJES SË ISLAMIT

1. SHITRESAT SHOQËRORE TË ARABËVE
2. UNIFIKIMI GJUHËSOR
3. MARRËDHËNIET E GADISHULLIT ME FETË PARAPRAKE
4. MARRËDHËNIET E MISIONIT TË MUHAMMEDIT [*ALEJHIS SALATU VES SELAM*] ME MISIONET E MËPARSHME QIELLORE
5. XHAHILIJETI (PERIUDHA E INJORANCËS) DHE PJESË TË MBETURA TË FESË SË PASTËR (EL HANIFIJJEH)

1. Shtresat shoqërore të arabëve

Arabët, sipas vjetërisë, ndahen në:

- 1) Arabë baide²⁰
- 2) Arabë aribe²¹, dhe
- 3) Arabë musta'rebe apo mutearrebe²².

Sipas gjenealogjisë ndahen edhe në:

- 1) Kahtanijë, vendbanimet e para të të cilëve ishin në Jemen, dhe

²⁰ Arabët baide, sipas gjenealogëve, janë banorët autoktonë të Gadishullit Arabik. Këtu bëjnë pjesë populli Ad, Themudi, fisi Xhurhum, etj.

²¹ Janë nga bijtë e Kahtanit. Kanë qenë bashkëkohës të arab baidëve.

²² Këta e kanë origjinën nga Ismaili, [*alejhis salatu ves selam*] dhe njihen ndryshe edhe si arabët adnanitë. Shih: Mubarekfuri, SafijuRrahman. (1999) *Nektari i Vulosur i Xhennetit*. Nun: Shkup, f. 13.

2) Adnanijjë, vendbanimet e para të të cilëve ishin në Hixhaz.

Disa i marrin Kahtanijjët si autoktonë, ndërsa të tjerët, sidomos në kohën bashkëkohore, anojnë nga mendimi se në fakt autoktonë ishin Adnanijjët. Kahtanijjët dhe Adnanijjët ishin në armiqtësi shekullore. Ismaili [alejhis salatu ves selam] ishte gjyshi më i lartë i arabëve të llojit të tretë (Arab musta'rebe apo mutearrebe). Ata u quajtën me këtë emër ngase Ismaili [alejhis salatu ves selam] fliste sirianishten, ndërsa kur fisi xhurhum zbriti në Mekë dhe filluan lidhjet shoqërore me ta (martesat), atëherë Ismaili [alejhis salatu ves selam] dhe bijtë e tij mësuan arabishten, gjë për të cilën ata morën edhe këtë emërtim.

Zoti e di më së miri, por duket se ky mendim nuk është më i qëlluari. Kjo për shkak se koha e Ibrahimit [alejhis salatu ves selam] dhe të birit, Ismailit, [alejhis salatu ves selam] ishte kohë origjinale arabe. Ibrahimit dhe Ismailit [alejhimas selam] iu përkisnin fiseve aramite arabe të lashta, koha e të cilëve nuk kishte asnjë lidhje me kohën e çifutëve. Në këtë të vërtetë aludon edhe Kur'ani:

“Ibrahimi nuk ka qenë as jehudi as i krishterë, por ai ishte larg besimeve të kota, ishte musliman dhe nuk ishte prej idhujtarëve.” (Ali Imran, 67)

Pastaj, Ibrahimit [alejhis salatu ves selam] pati lindur në Irak dhe kishte qëndruar në qytetin Ur Kaldaja, ndërsa idhujtarët u përpoqën ta digjinin atë në një fshat të Kufës. Vetëm më pas Ibrahimit, [alejhis salatu ves selam] do të shkonte në Harran, në veri të Gadishullit. Pas kësaj kohe, Ibrahimit [alejhis salatu ves selam] bashkë me gruan e tij, Sarën dhe nipin (djalin e vëllait), Lutin [alejhis salatu ves selam], do të shkonin në Palestinë, më pas në Egjipt, për t'u kthyer më vonë prapë në Palestinë. Këtu në fakt ata edhe do të ndaheshin. Luti [alejhis salatu ves selam] do të qëndronte në jug të Detit të Vdekur, ndërsa Ibrahimit [alejhis salatu ves selam] me gruan e dytë, Haxheren dhe të birin, Ismailin [alejhis salatu ves selam], do të shkonin në Mekë. Ibrahimit [alejhis salatu ves selam] do të qëndronte vetëm pak dhe do të kthehej në Palestinë, ku edhe do të vdiste në qytetin Hebron²³.

2. Unifikimi gjuhësor

Gadishulli Arabik, me gjithë gjerësinë dhe shtrirjen e madhe, si dhe me gjithë dallimet ndërmjet fiseve, shquhej për gjuhën e unifikuar ndërmjet malësorëve

²³ Shih: Nedevi, Ebu'l Hasen. *Es-Siretu en Nebevijeh*, f. 66-67; Atlas es sirtin nebevijeh, f. 23-24.

dhe qytetarëve, kahtanijëve dhe adnanijëve, edhe pse dialektet mund të kenë qenë të ndryshme deri diku. Gjuhët dallonin në dialekte për shkak të distancave dhe ky unifikim gjuhësor në Gadishull hapi rrugën për një përhapje të shpejtë të Islamit në të...²⁴

3. Marrëdhëniet e Gadishullit me fetë paraprake

Gadishulli Arabik është djep i shumë *pejgamberive*. Është vendi në të cilin janë dërguar shumë pejgamberë. Allahu ka thënë:

Përkujto vëllain e Adit (Hudin) kur popullin e vet në Ahkafë e qortoi, megjithëqë qortime pati edhe para edhe pas tij, (u tha): "Të mos adhuroni tjetër vetëm se Allahun, pse unë i kam frikë dënimit tuaj në ditën e madhe!" (el-Ahkaf, 21)

Sipas historianëve, Adi (si popull) ishte prej arabëve tiranë, arabëve baide. Ata qëndronin në Ahkafë, vend me rërë të shumtë, në jug të Gadishullit apo më konkretisht në jug të Rubu'l Halit, afër Hadramevrit. Allahu i shkatërroi me një erë të fuqishme, e cila erdhi si tufan me rërë. Vetë ajeti dëshmon se Hudi ishte paraprirë dhe pasuar me të dërguar:

"Përkujto vëllain e Adit (Hudin) kur popullin e vet në Ahkafë e qortoi, megjithëqë qortime pati edhe para edhe pas tij..." (el-Ahkaf, 21)

Ndërsa tek Themudi, që banonin Gadishullin apo më saktë Hixhrin, një vend ndërmjet Hixhazit dhe Tebukut, u dërguar Salihu [*alejhis salatu ves selam*]. Kur'ani na rrëfen për këtë:

"Edhe populli i "Hixhres" i përgënjeshtroi të dërguarit. 81. Ne u patëm parashtruar atyre argumentet (mrekullitë) Tona, por ata i kundërshtonin ato. 82. Ata skalisnin shtëpia në kodra shkëmbore për të qenë të sigurt. 83. E ata në mëngjes i goditi gjënim i tmerrshëm e shkatërrues." (el-Hixhr, 80-83)

4. Marrëdhëniet e misionit të Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] me misionet e mëparshme qiellore

Imam Muslimi transmeton se Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë:

²⁴ Ibid, f. 67.

“Vërtet, shembulli im dhe shembulli i pejgamberëve të dërguar para meje është sikurse shembulli i një njeriu që ndërton një shtëpi të mirë e të bukur, vetëm se ka lënë pa vendosur një tullë në një qoshe. Njerëzit e vizitonin dhe iu pëlqente shtëpia, por nga kureshtja pyesnin: Ah, sikur të ishte vënë edhe kjo tullë! (Vini re!) Unë jam ajo tullë dhe unë jam vula e pejgamberëve!”

Duke u bazuar në këtë hadith, misioni i Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] është vërtetues por edhe plotësues. Për ta sqaruar më mirë këtë themi se çdo fe është e ngritur mbi dy baza:

1. Besimi (kredoja), dhe
2. Legjislacioni dhe morali.

Sa i përket bazës së parë, përmbajtja e saj nuk ka ndryshuar që nga Ademi [*alejhis salatu ves selam*] e deri tek Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*]. Secili nga pejgamberët që vinte vërtetonte pejgamberësinë e të dërguarit paraprak. Kështu, ata kanë pasuar njëri-tjetrin duke i ftuar njerëzit që adhurimet dhe lutjet t’ia dedikojnë vetëm Allahut. Këtë na e ka treguar Allahu në Kur’an:

“Ai ju përcaktoi juve për fe atë që ia pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të. Për idhujtarët është rëndë kjo në çka ju i thirrni ata. All-llahu veçon për të (për besim të drejtë) atë që do dhe e udhëzon në të atë që i drejtohet Atij.” (sh-Shura, 13)

Nuk është e logjikshme që pejgamberët të ftojnë ndryshe nga njëri-tjetri në akide-besim, përderisa kjo e fundit është prej llojit të lajmërimit, që nuk guxon të mos jetë e ngjashme tek të gjithë pejgamberët. P.sh. nuk lejohet apo është e pamundur që një pejgamber – ruana Zot! – të proklamojë trinitetin, ndërsa tjetri që vjen pas tij të proklamojë njëshmërinë.

Ndërsa sa i përket ligjeve dhe dispozitave, ato ndërroreshin për nga lloji dhe sasia dhe ato nuk ishin të llojit informues siç ishte rasti tek besimi. Këtë do ta kuptojmë më mirë kur të kemi parasysh edhe faktin se ligjet miratoheshin në varësi me rrethanat kohore. Zaten, ligjet nxirren për interesin e njerëzve. Pastaj, dërgimi i çdo pejgamberi në të kaluarën bëhej për një popull të caktuar, me tradita dhe karakteristika të ndryshme, kështu që ishte e domosdoshme të nxirreshin ligje që përputheshin me këto tipare dhe veçori të tyre. Le të marrim si

shembull për këtë legjislacionin e Musait [*alejhis salatu ves selam*]. Në të ligjet nxirreshin jo në bazë të lehtësimeve (err-rruhas), por në bazë të atyre që ishin më të forta (el-azaim²⁵)... Ishte një legjislacion i rëndë. Ndërsa Isai [*alejhis salatu ves selam*], pejgamberi pasues, erdhi me një legjislacion më të lehtë. Këtë na e tregon edhe Kur'ani. Në kaptinën Ali Imran, ajetet 3 dhe 50, Allahu thotë:

"Ai ta zbret ty (Muhammed) librin me argument që është vërtetues i librave të mëparshëm. Ai e zbriti më parë Tevratin dhe Inxhilin."

"Dhe (kam ardhur) që t'ju vërtetoj Tevratin që e keni para duarsh, t'ju lejoj disa që u ishin ndaluar juve, kam ardhur me argument nga Zoti juaj, pra kini frikë All-llahun dhe më dëgjoni mua."

Duke u bazuar në këtë, misioni i çdo pejgamberi përbëhej nga besimi dhe legjislacioni; besimi për të vërtetuar misionet e mëhershme, ndërsa legjislacioni në shumicën absolute të rasteve ka anuluar atë të mëparshmin, edhe pse ka raste kur ndonjë aspekt i legjislacionit të mëparshëm mund të jetë përkrahur (përvetësuar) apo mund të jetë lënë në heshtje, gjë që mund të kuptohet si aprovim i saj.

Nga ky prezantim mund të kuptojmë se nuk bëhet fjalë për një pluralizëm fesh qiellore, por për një pluralizëm legjislacionesh qiellore, që, për interesa të popujve ku janë dërguar, kanë ndërruar nga populli në popull, dhe këtë derisa ka ardhur Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*], pejgamberi misionin e të cilit Zoti e zgjodhi që t'i anulonte të gjitha legjislacionet e mëparshme, por edhe të mos kishte më legjislacion pas tij. Pra, feja në fakt është një. Kjo është feja me të cilën u dërguan Ibrahim, Ismail, Ja'kubi, Musa, Isa [*alejhimus selam*].

"E kush largohet prej fesë së Ibrahimit përveç atij që e poshtëron vetveten? Ne atë e bëmë të zgjedhur në këtë botë, kurse në botën tjetër ai është njëri prej të lartëve. 131. Kur Zoti i vet atij i tha: "Dorëzohu"! Ai tha: "Iu kam dorëzuar Zotit të gjithësisë"! 132. E Ibrahim i porositi bijtë e tij me këtë (fe), e edhe

²⁵ 'El-Azaim' janë dispozitat që nuk ndryshojnë, por mbesin ashtu siç janë ligjësuar në fillim. Ato janë obligim për të gjithë dhe askush nuk lirohet prej tyre, p.sh.: namazi, që është ligjësuar për të gjithë dhe në çdo gjendje. Ndërsa 'err-rruhas' janë të kundërtat. Për më shumë shih:

http://www.islamweb.net/newlibrary/display_book.php?idfrom=96&idto=101&bk_no=99&ID=126

Jakubi. (u thanë) "O bijtë e mi, All-llahu ua zgjodhi fenë (islame) juve, pra mos vdisni ndryshe, por vetëm duke qenë muslimanë!" (el-Bekare, 130-132)

"Ata (që besuan) thanë: "S'ka dyshim, ne jemi të kthyer te Zoti ynë". 126. Ti nuk hakmerresh ndaj nesh vetëm pse besuam në argumentet e Zotit tonë, pasi që na erdhën ato. Zoti ynë, na dhuro durim (për dënimin që do të na e bën faraoni) dhe na bëjë të vdesim muslimanë!" (el-A'rafë, 125-126)

"E kur e kuptoi Isai vendosmërinë e tyre në mosbesim (dhe qëllimin që ta mbysin), tha: "Kush janë ndihmëtarët e mi për në rrugë të All-llahut"? Havarijjunët thanë: "Ne jemi ndihmëtarë të fesë së All-llahut, ne i besuam All-llahut, e ti dëshmo për ne se jemi muslimanë (të bindur, të dorëzuar)!" (Ali Imran, 52)

Kësisoj, të gjithë pejgamberët janë dërguar me Islam, fenë e vetme që Allahu e pranon, ndërsa ithtarët e librit e dinë fare mirë se pejgamberët janë dërguar për të vërtetuar njëri-tjetrin, por ata shpifën për pejgamberët e tyre atë që ata fare nuk e kanë thënë...²⁶

5. Xhahilijeti (periudha e injorancës) dhe pjesë të mbetura të fesë së pastër (el hanifijeh)

Konsideroj se studimi i kësaj pike, para se t'i qasemi Sires, është me rëndësi të veçantë. Si konkluzion mund të themi se Islami (i Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]) në fakt është shtrirja horizontale e fesë së natyrshme të Ibrahimit [*alejhis salatu ves selam*]. Allahu na e shtjellon shumë qartë në Kur'an një gjë të tillë:

Luftoni me një luftë të denjë për hir të All-llahut, se Ai ju zgjodhi ju (ju përcaktoi për të luftuar për rrugën e Tij) dhe nuk ju obligoi në fé me ndonjë vështirësi, në fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai edhe më parë, e edhe ky (Kur'an) ju quajti muslimanë, e për të qenë i dërguari dëshmitar juaji dhe për të qenë ju dëshmitarë ndaj njerëzve, pra falni rregullisht namazin, jepni zeqatin, përmbahuni me All-llahun se Ai është ndihmëtari juaj. Sa mbrojtës i mirë dhe sa ndihmëtar i madh që është." (el-Haxh, 78)

Me kalimin e kohës, e vërteta filloi të njollosej apo të pështillej e kota me të, kështu që depërtoi idhujtaria dhe njerëzit filluan të adhuronin putat dhe të

²⁶ Buti, Muhammed Seid Ramadan, *Fikhu's Sire*, f. 34-36.

përvetësonin tradita të shëmtuara. I pari që e futi në mesin e tyre idhujtarinë ishte Amr Ibn Luhaj, gjyshi i Huzaëve. Ky ishte i pari që devijoi nga feja e Ismailit [*alejhis salatu ves selam*] dhe vendosi putat. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] për të ka thënë:

E kam parë Amr Ibn Luhaj Ibn Kam'ah Ibn Hindifin, babanë e tyre Beni Ka'bëve, tek tërhiqte zorrët e tij (zvarrë) në Xhehenem!" (Muslimi)

Ngjarja se si e solli idhujtarinë është e njohur. Thuhet se në njërin prej udhëtimeve të tij jashtë Mekës kishte parë disa njerëz tek adhuronin putat. I kishte pyetur për ata idhuj që i adhuronin dhe kishte marrë përgjigje se kur i lusnin për shi, ua sillnin atë, kur kërkonin fitore, iu ndihmonin... Amri kishte kërkuar një idhull prej tyre që ta dërgonte tek arabët. Ata ia dhanë dhe kur arriti në Mekë i urdhëroi njerëzit që ta adhuronin dhe madhëronin putin që kishte sjellë, i cili quhej Hubel. [Tregimin me detaje të tjera mund ta gjeni tek Siretu Ibni Hisham, 1/76-77]

Megjithëkëtë, një grup njerëzish vazhduan ta ruanin traditën e pastër të besimit; besonin në ringjallje dhe llogari dhe se Allahu i shpërblen me të mira adhuruesit e sinqertë, ndërsa i ndëshkon mëkatarët. Prej tyre, si më të njohurit, ishin: Kis ibn Saide el-Ijjadij, Riab esh-Shenijj, prifti Buhajra etj.

Po kështu iu kishin mbetur edhe disa nga traditat fetare, edhe pse të devijuara dhe shtrembëruara, si fjala vjen, respektimi i Qabesë, Tavafi, Haxhi, Umreja, qëndrimi në Arafat etj. Zanafilla e tyre kthehet tek koha e Ibrahimit [*alejhis salatu ves selam*], vetëm se ata i praktikonin gabimisht dhe iu vishnin gjëra apo i demonstironin jo ashtu siç ishin në të vërtetë. P.sh. në telbijjen e Haxhit, në të cilën haxhilerët shprehin besimin e tyre të pastër tek Allahu, ata bënin të kundërtën. Siç transmetohet [në Sahihun e Muslimit], ata telbijjen e bënin në këtë formë:

Lebbejke Allahumme lebbejke! Lebbejke la sherike leke il-la sheriken huve leke, temlikuhu ve ma meleke...

“Të përgjigjemi o Zot, të përgjigjemi! Të përgjigjemi Ty që nuk ke shok, përveç njërit, që Ti e posedon atë, ndërsa ai jo!”²⁷

²⁷ Në komentimin e pjesës së fundit ose më konkretisht pjesëzës ‘ma’ disa kanë thënë se ajo është pjesëz mohuese, e që i bie të përkthehet: Ti e posedon atë ndërsa ai nuk posedon asgjë, ndërsa disa të tjerë mendojnë se kjo është një pjesëz lidhëse, e që sipas tyre kuptimi duhet të jetë: ‘e posedon atë dhe tërë çka ai posedon.’ Përkthyesi.

Ligjërata e pestë:

NGA LINDJA DERI NË PEJGAMBERLLËK

Prejardhja: Muhammed Ibn Abdullah Ibn Abdu'l Muttalib [thirrej Shejbetu'l hamdi] Ibn Hashim Ibn Abdu Menaf [quhej Mugire] Ibn Kusaj [quhej Zejd] Ibn Kilab Ibn Murreh Ibn Ka'b Ibn Luej Ibn Galib Ibn Fihri Ibn Malik Ibn Nadr Ibn Kinaneh Ibn Huzajmeh Ibn Mudrikeh Ibn Iljas Ibn Mudar Ibn Nezzar Ibn Meadd Ibn Adnan. Origjina e Adnanit mbaron tek Ismaili [*alejhis salatu ves selam*].

Abdu'l Muttalibi kishte dhjetë djem, ndërsa më i miri ndër ta ishte Abdullahu. E martoi me Aminen, të bijën e Vehbit, zotërisë së Beni Zehreve. Muslimi transmeton në Sahihun e tij se Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë:

Vërtet, Allahu nga bijtë e Ismailit zgjodhi Kinanen, e prej tij zgjodhi Kurejshët, prej Kurejshëve zgjodhi bijtë e Hashimit ndërsa prej tyre më zgjodhi mua!"

Lindja: Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] lindi ditën e hënë, më 12 Rebiu'l Evvel të vitit të elefantit, që sipas kalendarit gregorian i bie 20.04.571 apo 22.04.571. Ishte ajo sigurisht dita më e mirë dhe më e lumtur në të cilën ka lindur dielli.

Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] lindi jetim. Babai i kishte vdekur ende pa lindur. Kështu, në përkujdesje e mori gjyshi, Abdu'l Muttalibi, i cili sipas zakonisht e dërgoi tek një grua e fisit Benu Sa'd Ibn Bekër, që quhej Halime bint Ebi Dhuvejb, për ta ushqyer me qumësht gjiri. Tek Halimeja qëndroi dy vite...

Gjatë kohës që qëndroi tek Halimeja ndodhi pastrimi i gjoksit të tij. Atij i erdhën dy melekë, të cilët ia çanë barkun dhe i nxorën nga zemra një copë të zezë, të

cilën më pas e hodhën. Ata e pastruan zemrën dhe më pas e kthyen trupin në gjendjen që kishte qenë më parë.

Në moshën 6 vjeçare atij i vdiq nëna, Aminja, në një vend ndërmjet Mekës dhe Medinës dhe komplet kujdestarinë për të tani do ta merrte gjyshi, Abdu'l Muttalibi.

Por vetëm dy vjet më vonë, Abdu'l Muttalibi vdes. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] do ta shijonte prapë të qenët jetim. Për të tani do të përkujdesej xhaxhai, Ebu Talibi.

Në moshën nëntëvjeçare [apo dymbëdhjetë siç thuhet në disa transmetime] xhaxhai e mori për tregti në Sham. Gjatë rrugës ndaluan tek qyteti Busra, ku takuan priftin Buhajra, i cili ishte njohës i Inxhilit dhe fesë së krishtere. Kur Buhajra pa gjurmët e pejgamberisë u interesua për ta dhe, jo si zakonisht, u përgatiti gosti. Ai e porositi Ebu Talibin që të kthehej menjëherë me nipin në Mekë dhe ta ruante atë nga çifutët, ngase e ardhmja do të rezervonte një pozitë të veçantë për të. Hulumtuesit dhe ekspertët islamë kanë folur për vërtetësinë e këtij rrëfimi, por, siç mund ta vërejmë, rrëfimi vazhdon të ekzistojë dhe madje shumica e librave e përmendin atë, gjë që të bën të bindesh për vërtetësinë e tij.

Pastaj, erdhi periudha e rinisë, në të cilën do ta gjejmë Pejgamberin [*alejhis salatu ves selam*] tek interesohet për fitimin e jetesës. Ruante delet. Buhariu transmeton nga Ebu Hurejre se Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë:

“Allahu nuk ka dërguar ndonjë pejgamber që nuk ka qenë paraprakisht bari delesh. Shokët i thanë: A edhe ti?! Po, - u përgjigj dhe shtoi: - Ua ruaja mekasve për ca para [ose në Kararit, nëse ky është emër vendi siç është komentuar nga disa.]”

Në moshën 14 ose 15 vjeçare përjetoi dhe luftën ‘harbu’l fuxh-xhar’ ndërmjet kurejshëve dhe kajsive. Xhaxhallarët e morën me vete dhe aty u njoh me luftën, kalorësinë, djemurinë...

Në moshën 25 vjeçare u martua me Hatixhe Bint Huvejlidin, zonjën e grave kurejshite, gruan e shquar për mendjemprehtësi, nder, moral dhe pasuri. Ishte e vejë. Burri i saj, Ebu Hale, vdiq ndërsa ajo i kishte dyzet vjet. Kur u njoftua për besnikërinë e Muhammedit, [*alejhis salatu ves selam*], ajo e dërgoi si kryesues të karvanit të saj, bashkë me shërbëtorin e saj, Mejseren. Pejgamberi [*alejhis salatu*

ves selam] e pranoi ofertën dhe shkoi në Sham, prej nga u kthye me fitime të mëdha. Hatixheja i ofroi martesë. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] pranoi. Me të i pati të gjithë fëmijët, me përjashtim të Ibrahimit [*alejhis salatu ves selam*], të cilin e kishte me Marijen.

Ndërtimi i Qabesë: Kur Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] ishte 35 vjeç, kurejshët qenë tubuar për ndërtimin e Qabesë. Kur punimet po i afroreshin ruknit, atëherë u shfaqën mospajtime se kush duhet ta vendoste Gurin e Zi. Kundërshtitë ishin aq të thella saqë gati u vranë ndërmjet vete. Pas disa ditë mosmarrëveshjeje, më në fund u pajtuan se çështjen do t'ia linin në dorë atij që do të hynte i pari në derën e Qabesë. Dhe qëlloi që i pari të ishte Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*]. 'Ky është emin (besnik). U pajtuam. Ky është Muhammedi...' Pra, ishte Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] ai që e zgjidhi këtë problem madhor.

Hilf fudul: Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] përjetoi dhe Hilf Fudulin. Shkak i kësaj ishte se një njeri nga Zubejdi kishte ardhur për tregti në Mekë. El-As Ibn Vail, një nga të parët e Mekës, kishte blerë diçka prej tij, por nuk ia kishte paguar hakun. Zubejdi u ankua tek paria mekase, por nuk mori përgjigjen e duhur. Por, nuk ngjau kështu edhe me burrat e vërtetë, të cilët nga xhelozia e madhe për nderin dhe burrërinë u tubuan në një punim darke në shtëpinë e Abdullah Ibn Xhedanit, ku ranë dakord që të bëhen bashkë për t'iu ndihmuar atyre që iu bëhej padrejtësi kundër të padrejtëve. Si hap konkret, shkuan tek el-Asi dhe ia morën mallin e Zubejdit. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] shprehte simpatinë e tij për atë marrëveshje, madje edhe pasi që u dërguar pejgamber dhe, siç rrëfëhet, kishte thënë: "Në shtëpinë e Abdullahut kam qenë pjesëmarrës i një marrëveshjeje, për të cilin po të thirresha edhe (tash) në Islam do t'i përgjigjesha (pozitivisht)." ²⁸

Mësimet dhe porositë e dala nga këto ngjarje

1. Sa i përket origjinës së Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*], në të ka argument se Allahu i veçoi arabët nga të gjithë njerëzit, ndërsa kurejshët nga të gjitha fiset. Këtë e dëshmon edhe hadithi, të cilin Tirmidhiu e shënon në Sunenin e tij nga el-Muttaleb Ibn Ebi Vedah se Ibni Abbasi kishte shkuar tek Pejgamberi [*alejhis salatu*

²⁸ Shih: Nedevi. *Es-Sire en-Nebevijeh*. F. 99-144; Buti. *Fikhu's Sire*. F. 44-59.

ves selam] dhe i kishte thënë diç në fshehtësi, gjë pas së cilës Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] kishte hipur në minber dhe kishte thënë:

“Kush jam unë?- i pyeti njerëzit. Ti je i Dërguari i Allahut, paqja qoftë mbi ty! – iu përgjigjen njerëzit. Unë jam Muhammedi, i biri i Abdullahut, birit të Abdul Muttalibit. Vërtet, Allahu i ka krijuar krijesat, ndërsa mua më ka bërë më të mirin e tyre. Pastaj i ndau njerëzit në dy grupe dhe mua më vendosi në grupin më të mirë. Pastaj ata i ndau në fise dhe mua më vendosi në fisin më të mirë. E pastaj i ndau edhe në shtëpi dhe mua më vendosi në shtëpinë më të mirë dhe shpirtin më të mirë.” [Albani në el-Mishkah, 5757, e cilëson autentik.]

2. Dashuria për Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] parasheh edhe dashurinë për popullin dhe aq më parë për fisin në të cilin u lind, kuptohet, jo për të gjithë, por për ata që nuk iu shmangën të vërtetës kurrë...

3. Vdekja e babait dhe gjyshit nuk janë rastësi. Gjithsesi se në këtë vendim të Allahut fshihen urtësi, ndoshta më e rëndësishmja prej tyre është që njerëzit të mos thonë për misionin e tij se ka marrë udhëzime dhe këshilla prej babait dhe gjyshit.

4. Halimes iu shpagua munda i saj për shkak të marrjes së Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] për ta ushqyer me gji. Allahu i dha të mira të shumta dhe për këtë nuk ka asgjë për t’u çuditur kur kemi parasysh faktin se, nga pikëpamja fetare, lejohet që ta lusim Allahun për sjelljen e bereqetit nëpërmjet ndonjë njeriu të mirë të gjallë, siç bënë sahabët pas vdekjes së Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*]. Ata thirrën Abbasin, xhaxhain e tij, të lutej për shi dhe Allahu iu lëshoi shi.

5. Ndodhia e çarjes së gjoksit llogaritet ndër parashenjat e pejgamberisë dhe përgatitjes për misionin e madh. Kjo nuk ka kuptimin e rëndomtë të heqjes së një cope mishi nga trupi për t’u bërë mirë, ndryshe operacionet e tilla do të ishin më të njohurat në histori, por kjo nënkupton përgatitjen e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] që nga vegjëlia për mision e ardhshëm, vetëm se kjo është bërë me gjëra që njerëzit mund t’i perceptojnë më lehtë, për ta besuar – rrjedhimisht – edhe atë më lehtë. Pra, çarja e gjoksit është operacion abstrakt, kuptimor, që ka marrë këtë formë ndijore. Ne, këtë dhe të vërtetat e ngjashme me të, i pranojmë

duke përfillur kriteret e transmetimit dhe duke aplikuar domethëniet dhe rregullat e gjuhës arabe.

6. Rasti i priftit Buharja gjithsesi se është një dëshmi se ithtarët e feve të mëparshme qiellore, pra të krishterët dhe çifutët, kishin njohuri për dërgimin e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]. Ose më saktë, në librat e tyre kishin parashenjat e dërgimit dhe shenjat e këtij pejgamberi. Madje çifutët jo rrallë iu thoshin fiseve Evs dhe Hazrexh se gati ishte koha e dërgimit të një pejgamberi, me të cilin do t'i sulmonin ata. Për këtë ka aluduar edhe Kur'ani:

"E kur u erdhi atyre prej All-llahut libri (Kur'ani) që është vërtetues i atij, që e kishin pranë, e që para se t'u vinte e kërkonin ndihmën e tij kundër mosbesimtarëve, e mohuan atë (Muhammedin) që e njihnin, kur u erdhi. Pra mallkimi i All-llahut qoftë kundër mosbesimtarëve!" (el-Bekare, 89)

Selman Farisiu e kishte pranuar Islamit për shkak se kishte përcjellë shenjat dhe përshkrimin e tij në Inxhil.

7. Ruajtja e deleve ishte një simbolikë me të cilin Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] dëshironte t'ia lehtësonte sadopak xhaxhait mbajtjen e tij. Pra, është një simbolikë falënderimi, sikur që është edhe një aludim për jetën të cilën Allahu e pëlqen për robërit e Tij në këtë botë.

Sigurisht se Allahu ka pasur mundësi që t'ia krijonte kushtet për një jetë luksoze, por me këtë aludohet se pasuria më e mirë për njeriun është ajo që e fiton me dorën e vet. Në këtë, po kështu, ka mësim edhe metodologjik se çdo thirrje a mision që nuk zhvillohet në baza vetjake, por është i varur, nuk do të ketë sukses. Që njeriu të jetë dhe mbetet i lirë duhet të ketë një burim të ndershëm të të ardhurave, me të cilin mund ta proklamojë lirshëm të vërtetën dhe të mos ketë frikë nga askush...

8. Puna si mbikëqyrës në pasurinë e Hatixhes ishte vetëm vazhdimësi e fitimit të jetesës. Vlera dhe pozita e Hatixhes tek Pejgamberi, [*alejhis salatu ves selam*] mbeti përgjithmonë e rëndësishme. Buhariu dhe Muslimi transmetojnë faktin e të qenit të saj si gruaja më e mirë e të gjitha kohëve. E po kështu këta transmetojnë edhe rastin e Aishes, e cila thoshte se nuk xhelozonte asnjë nga gratë e Pejgamberit, [*alejhis salatu ves selam*] sa xhelozonte Hatixhen, për shkak se shumë shpesh

Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] e zinte në gojë. Një ditë Aisheja qe hidhëruar dhe i kishte thënë Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*]: Hatixheja! (Sikur vetëm atë po e përmend...) Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] i tha: “Unë jam begatuar me dashurinë e saj..” Ndërsa në një version tjetër: “...Jo, pasha Allahun, Allahu nuk ma ka kompensuar atë me ndonjë më të mirë; ajo më besoi kur njerëzit më mohuan, më vërtetoi kur njerëzit më përgënjeshtruan, më ndihmoi kur njerëzit më privuan, dhe Allahu më dha fëmijët me të e jo me gratë e tjera...”

9. Ndërsa sa i përket martesës së Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*] me Hatixhen, natyrisht se gjënë e parë që mund ta vërejmë është martesa e tij nuk ishte për qëllime epshore, ngase ajo ishte shumë më e vjetër se ai. Motiv për atë martesë ishte, para së gjithash, nderi dhe morali i saj. Madje, sa ishte gjallë ajo, Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] nuk qe martuar me grua tjetër. Padyshim se ky është një fakt zhvleftësues për bindjet e orientalistëve dhe të tjerëve përkitazi me Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*]. Ata u përpoqën ta paraqisnin Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] si njeri të zhytur në epshe, por, siç dihet, orientalistët janë njerëz që shpifjen e kanë profesion.

10. Tregimi i ndërtimit të Qabesë fsheh në vete shenjtërinë e kësaj shtëpie, ndërtimin e së cilës pati nderin ta bëjë babai i pejgamberëve, Ibrahimit [*alejhis salatu ves selam*] me të birin, Ismailin [*alejhis salatu ves selam*]. Po cila është rëndësia e saj? Kur Allahu e urdhëroi Ibrahimin [*alejhis salatu ves selam*] t’i thyente putat, ishte më se normale që njerëzit të ndienin nevojën për t’iu drejtuar dikujt, të kishin një qendër të monoteizmit, një vend i cili do ta bashkonte tërë njerëzimin nga të gjitha anët e botës. Ky dhe është kuptimi i fjalës së Allahut:

“Dhe kur shtëpinë (Qabenë) e bëmë vendkthimi dhe vendsigurie për njerëzit, (u thamë): Vendin ku qëndroi Ibrahim pranojeni për vendfaljeje! Ibrahimin dhe Ismailin i urdhëruam: ju të dy pastrojeni shtëpinë Time për vizituesit, për ata që qëndrojnë aty dhe për ata që falen aty.” (el-Bekare, 125)

11. Ndërsa sa i përket historisë së ndërtimit të Qabesë, mbështetur në versionin më të saktë, ajo është ndërtuar katër herë përgjatë gjithë historisë:

- 1) Në kohën e Ibrahimit dhe Ismailit [*alejhimas selam.*]
- 2) Në kohën paraislamike, kur kurejshët e ndërtuan atë, ndërtim në të cilin mori pjesë edhe Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*].

- 3) Në kohën e Jezid Ibn Muavijes, i cili e kishte rrethuar me ushtrinë e tij Abdullah Ibn Ubejr in në Mekë, në v. 36 sipas hixhrit. Ata e kishin sulmuar shtëpinë me katapultë dhe e kishin demoluar dhe djegur. Abdullahu në sezonin e haxhit u konsultua me njerëzit për ndërtimin e saj, kështu që u këshillua të mos e rrëronte atë por ta rinovonte. Abdullahut nuk i pëlqeu ky mendim dhe tha se sikur të digjeshin shtëpitë tuaja sigurisht se do t'i ndërtonit nga fillimi, por unë po marr mendimet tuaja e më pas do të vendos pasi që ta kem lutur Allahun për tri ditë me radhë. Pas tri ditësh e filloi ndërtimin e saj që nga themelet dhe ia la dy dyer, njëren për të hyrë e tjetren për të dalë...
- 4) Pas vdekjes së Abdullahut (Ibn Zubejr), Haxh-xhaxhi i kishte shkruar Abdul Melik Ibn Mervanit për këtë ndërtim që kishte bërë Abdullahu. Abdul Meliku e kishte pranuar ndërtimin e bërë lart por i kishte refuzuar gurët e shtuar dhe e kishte mbyllur derën e (dytë të) hapur... Harun Rreshidi, siç thuhet, kishte dashur ta rikthente atë ashtu siç e kishte ndërtuar Abdullahu, por Malik Ibn Enesi e kishte lutur të mos e bënte një gjë të tillë ngase mbretërit do ta bënin shprehi rindërtimin e saj pas tij dhe kështu Qabesë do t'i humbte madhështia dhe respekti ndër njerëz.
- 5) Për këtë ndërtim, që në fakt do të duhej të ishte në krye të listës, thuhet se e bëri Ademi [*alejhis salatu ves selam*] e pas tij Nuhu, por transmetimet janë të dobëta dhe nuk qëndrojnë.

12. Alternativa e ofruar nga Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] për zgjidhjen e konfliktit të arabëve rreth vendosjes së Gurit të Zi gjatë rindërtimit të Qabesë flet për zgjuarsinë dhe mendjekthjelltesinë e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], që sigurisht se ishin fryt i të qenit pejgamber...

13. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] gëzonte një autoritet dhe famë të madhe në mesin e kurejshëve. E quanin Emin – besnik... Të gjithë e donin...

Ligjërata e gjashtë:

VETMIMI NË SHPELLË DHE FILLIMI I SHPALLJES

1. VETMIMI NË HIRA
2. FILLIMI I SHPALLJES

Vetmimi në Hira

Në kohën kur Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] po i afrohej të dyzetave, tek ai kohë pas kohe filloi të shfaqej dëshira për t'u vetmuar. Hira-ja, një kodër në veriperëndim të Mekës, ishte një vend në të cilin vetmohej dhe merrej me adhurim për net të tëra, madje deri një muaj të tërë. Pastaj, kthehej në shtëpi, por nuk qëndronte gjatë dhe prapë i kthehej vetmisë. Kështu vazhdoi derisa Xhibrili ia zbriti shpalljen...

Mësimet dhe këshillat e përfituara

Kjo vetmi gjithsesi se përmban domethënie madhështore. Ajo doemos se ka luajtur një rol të madh në jetën e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], e patjetër se luan edhe tek pasuesit e tij, hoxhallarët. Se ç'ëndësi ka do të mundohemi ta mësojmë nga shtjellimi në vijim:

1. Besimtari nuk do të mund ta perfeksionojë besimin e tij dhe nuk do të mund të stoliset me moral të mirë nëse nuk ndan kohë për t'u vetmuar me Allahun, për ta llogaritur veten, për të medituar për madhësinë e krijesave të Tij... Nëse kjo vlen për çdo musliman, atëherë për ata që mendojnë të marrin pozitën e thirrësve, këshilluesve dhe liderëve, patjetër se vlen edhe më shumë.

2. Shërimi i sëmundjeve shpirtërore, të tilla si: mendjemadhësia, zilia, syefaqsia, dashuria për dynjanë, ka nevojë për vetmi. Njeriu patjetër duhet të ndalet dhe, kohë pas kohe, të meditojë për të vërtetën mbi këto sëmundje dhe për nevojën e madhe që Allahu t'i japë sukses. Pra, duke menduar për vartësinë e tij prej Allahut, për llogaritjen në Ditën e Kiametit dhe duke e shëtitur mendjen në këto kopshte madhështish, njeriu arrin ta zhveshë zemrën nga këto sëmundje të rrezikshme...

3. Kultivimi i dashurisë për Allahun në zemra është një gjë tjetër, të cilës duhet t'i kushtojmë vëmendje të veçantë. Kjo për faktin se kjo dashuri nuk realizohet vetëm nga besimi teorik, ngase kështu orientalistët do të ishin në krye të besimtarëve... A të ka rënë të dëgjosh ndonjëherë që ndonjë shkencëtar apo matematikan ka sakrifikuar jetën e tij për ndonjë formulë?!

Kësisoj, rruga për të realizuar dashurinë e Allahut, është meditimi mbi faktet dhe argumentet e Tij, mbi mirësitë dhe dhuntitë e Tij, si dhe përkujtimi i shpeshtë i Tij... Dhe të gjitha këto nuk do të mund të arrihen kurrë nëse më parë nuk je larguar nga pengesat e dunjasë dhe nëse nuk ke organizuar një kohë të caktuar vetëm për to...

4. E kur dashuria për Allahun të ketë pushtuar zemrën, atëherë asgjë nuk mund të dalë si pengesë para saj, sikurse që asgjë, pavarësisht kostos, nuk mund ta pengojë atë. Kjo është ajo që besimtarët duhet ta kenë patjetër në pronësi të tyre, është pajisje pa të cilën nuk bën dot. Kjo është gjëja me të cilën Allahu e përgatiti Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] për misionin e tij... Kjo për shkak se motivet shpirtërore bëjnë më shumë se ç'bën vetëm të kuptuarit mendor...

5. Dijetarët janë unanimitë sa i përket asaj se duhen përdorur mjete të ndryshme për realizimin e këtyre motiveve shpirtërore, madje disa prej tyre edhe e kanë emërtuar atë 'Ilmu's suluk' (Shkenca mbi sjelljen). Për këtë shih mendimet e

Shehu'l Islam Ibni Tejmije-s në *Fetava*, vol. 10. Sigurisht se vetmimi i Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] ka qenë një prej këtyre mjeteve...

6. Vetmia nuk duhet të kuptohet në mënyrë ekstreme, si izolim i tërësishëm nga njerëzit. Disa kanë gabuar në këtë drejtim. Ata i janë shmangur kontakteve me njerëzit, kështu që kanë banuar në shpella dhe vende të braktisura. Kjo nuk përputhet me udhëzimin pejgamberik. Izolimi apo vetmia është në fakt si një ilaç që duhet marrë vetëm atëherë kur të ndiesh se je sëmurë, ndryshe mund ta pësosh keq. Atë që mund ta hasim tek disa njerëz të mirë (asketë) nuk mund ta marrim si argument; ajo ka të bëjë vetëm me ata.

Fillimi i shpalljes²⁹

Aishja rrëfen për vetë ngjarjen, për dritën e cila filloi ta shpërndajë terrin dhe errësirën e mosbesimit e të lajthitjes. Me anën e kësaj drite fillon të ndryshojë rrjedha e jetës dhe fati i historisë.

Aspekti i parë i Shpalljes së Resulullahut ka qenë “er-ru’ja es saliha” - vegime të vërteta. Këto ëndrra i vinin sikurse agimi i mëngjesit dhe menjëherë pas kësaj vetmohej në shpellën Hira. Çdo herë bëhej më i devotshëm dhe më i përsëritshëm. I jepej ibadetit disa net rresht, e para vajtjes në Hira furnizohej me ushqim në shtëpi, vizitonte Hatixhen radijAllahu anha, pastaj tërhiqej në vetmi.

Kjo zgjati gjer te paraqitja e Xhibrilit, i cili i erdhi një ditë Resulullahut në shpellën Hira e i tha: “Ikre!” - “Lexo, mëso!”

“Unë nuk di të lexoj”, - u përgjigj Muhammedi.

Pastaj vazhdoi: “Më përqafoi dhe më shtrëngoi aq sa më kaploi mundimi. Këtë e përsëriti tri herë, e pastaj më lëshoi dhe më tha:

“Lexo në emër të Zotit tënd, i cili ka krijuar (çdo gjë). Ka krijuar njeriun prej gjaku të ngjizur. Lexo, se Zoti yt është më bujari, që ia mësoi njeriut penën (të shkruajë), që njeriut ia mësoi atë që nuk dinte”. (El-Alak, 1-5).³⁰

²⁹ Me kërkesë të vetë autorit kam bërë disa shtesa, siç është kjo këtu, e marrë nga ‘Nektari i vulosur i Xhennetit.’

³⁰ Atë natë Resulullahut i janë shpallur vetëm pesë ajete të sures El-Alek.

Pastaj Resulullahu u kthye në shtëpi i tronditur dhe i shqetësuar, hyri te Hatixhja dhe i tha: *“Më mbulo! Më mbulo!”* I tregoi asaj *“lajmin”* e tha: *“Kam pasur frikë për veten”,* e H. Hatixhja iu përgjigj: *“Jo, jo për Zotin, Allahu ty kurrë nuk do të të turpërojë, sepse ti je njeri që i viziton të afërmit e tu, kujdesesh për të varfrit, e kompenson të humburën, e gostit mysafirin, i ndihmon të tjerët dhe ndjek të drejtën gjithnjë.”*

H. Hatixhja shkoi me Muhammedin te djali i axhës së vet, që quhej Vereka b. Neufel b. Esed b. Abdi Uzza. Ky njeri e kishte pranuar Krishterimin në kohën e xhahilijetit. E njihnte shkrimin e vjetër hebraik, e kjo ia kishte mundësuar përshkrimin (transkriptimin) e disa pjesëve të Ungjillit.

Ishte plak i këputur (shumë i moshuar) dhe i verbër. Hatixhja i tha: *“O djalë i xhaxhait, dëgjoje tregimin e djalit të vëllait tënd”,* e Vereka i tha (Resulullahut): *“O djali i vëllait tim, më trego çka ke parë?”* Resulullahu ia shpjegoi ndodhinë që e kishte përjetuar në shpellën Hira. Vereka e dëgjoji mirë dhe i tha: *“Ky ka qenë i besuari i Zotit, të cilin Allahu ia ka dërguar edhe Musait. Sikur ta kisha fatin të isha i ri, sikur të donte Zoti të jem gjallë, kur populli yt do të të dëbojë.”* Resulullahu tha: *“Mos, vallë do të më persekutojnë ata?”* *“Po. Dije se asnjëri që ka sjellë diçka, sikurse ti, nuk ka qenë pa armiq. Nëse e pres atë ditë, do të të ndihmoj me gjithë zemër.”*

Nuk kaloi shumë kohë pas kësaj, Vereka vdiq. Edhe shpallja u ndërpre për një kohë.³¹

Taberaniu dhe Ibni Hishami transmetojnë disa plotësime, të cilat janë të dobishme. Për shembull: Pas shpalljes, Resulullahu ka dalë i habitur nga shpella Hira, pastaj është kthyer menjëherë prapa, ka qëndruar pak kohë dhe ka shkuar në Mekë. Tradita e Taberaniut hedh një shkëndijë në shembullin e daljes së tij. Ja teksti i tij:

Resulullahu ka thënë: *“Nga krijesat e Allahut më së tepërmi kam urryer bejtexhinjtë dhe të çmendurit. Nuk kam pasur dëshirë as t’i shoh me sy. U kam thënë kurejshëve që kurrë të mos flasin me ta për mua...”* Pastaj vazhdoi: *“Kur arrita në mes të malit, dëgjova një zë nga qielli që më tha: “O Muhammed! Ti je i Dërguari i Allahut, e unë jam Xhibrili.”* - Pejgamberi shtoi: *“E ngrita kokën nga qielli dhe e pashë Xhibrilin në figurën e njeriut. I shihja vetëm këmbët që i arrinin gjer në qiell.”* Ai përsëri tha: *“O*

³¹ Sahihu-l-Buhari: 1/2, 3. Buhariu e ka nxjerrë këtë hadith nga libri *“Tefsiri dhe komentimi i ru’jes”*.

Muhammed! Ti je i Dërguari i Allahut, e unë jam Xhibrili." Pejgamberi tha: "U ndala dhe fillova ta shikoja, nuk u nisa as përpara as mbrapa. Gjithnjë mundohesha ta largoja shikimin prej tij, në anën tjetër të qiellit, por ngado që ktheja kokën, aty ndodhej edhe ai. Kështu qëndroja në vend, as përpara as mbrapa, derisa Hatixhja dërgoi dikë që të më thërriste për t'u kthyer. Lajmëtarët vinin dhe ktheheshin në shtëpi, e unë nuk mund të lëvizja nga vendi. Pastaj Xhibrili shkoi, e unë u ktheva në familjen time.³² Kur arrita në shtëpi, u ula afër Hatixhes dhe u mbështeta tek ajo, e ajo më tha: "O Ebu Kasim, ku ishe? Pasha Allahun, i kam dërguar njerëzit që të të kërkojnë nëpër tërë Mekën, por nuk të gjetën." Mandej unë i tregova se ç'kisha parë e ajo tha: "Më gëzo, o kushëri, dhe ma vërteto. Pasha Krijuesin dëshiroj të jesh Pejgamber i këtij umeti."³³ Pastaj ajo u ngrit dhe shkoi te Vereka dhe e njoftoi për ngjarjen, kurse Vereka iu përgjigj: "Kuddusun, kuddusun - O Allah, O Allah! Pasha Atë në duart e të cilit është shpirti im, Muhammedit i ka ardhur i besueshmi i Allahut, i cili i ka ardhur edhe Musait. Ai është Pejgamber i këtij umeti (populli). Thuaji atij, oj Hatixhe, le të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm." Hatixhja, radijAllahu anha, u kthye dhe ia tregoi fjalët e Verekës.

Kur Resulullahu e kreu qëndrimin në shpellën Hira, u kthye në Mekë. Atëherë Vereka e takoi dhe pasi dëgjoji rrëfimin e Resulullahut, i thotë: "Pasha Atë në duart e të Cilit është jeta ime, ti je Pejgamber i këtij umeti. Të ka ardhur i besueshmi i Allahut, i cili i ka ardhur edhe Musait."³⁴

Ndërprerja e Shpalljes

Se sa ka zgjatur ndërprerja e shpalljes, është një pyetje që kërkon përgjigje. Ibni Mes'udi transmeton nga Ibni Abbasi lajmin që shkon në favor të atyre që thonë se ndërprerja ka zgjatur ditë me radhë.³⁵ Ky mendim do të ishte më i fuqishmi dhe më i sakti, pas shqyrtimit të të gjitha rrethanave rreth kësaj ngjarjeje. Megjithatë, mendimi se ndërprerja ka zgjatur plot tre vjet ose dy vjet e gjysmë, nuk është i saktë. Por këtu nuk është vendi që ta shpjegojmë këtë. Është me rëndësi të dimë se Resulullahu, në kohën e ndërprerjes së Shpalljes, ka qenë gjithnjë i deprimuar, i pikëlluar, i hutuar dhe i befusuar. Buhariu, në librin e vet El-Te'abir, rrëfen si vijon: "Shpallja u ndërpre dhe kjo e pikëlloi Resulu-llahun...i paraqitej Xhibrili, i cili thoshte: "O Muhammed, ti me të vërtetë je i Dërguari i Allahut."

³² Teksti nga Taberaniu: II/207.

³³ Teksti i Ibni Hishamit: I/237-238.

³⁴ Transmetuar në pika të shkurtra nga Ibni Hishami: I/238

³⁵ Fet'hu-l-Bari: I/27, XII/360.

Këto fjalë i jepnin përsëri fuqi dhe vullnet për jetë, e kur iu zgjat sërish periudha e ndërprerjes së Shpalljes, ai përsëri shkonte në mal, përsëri ndodhte e njëjta gjë dhe me fjalët e Xhibrilit kthehej mbrapa i inkurajuar.”³⁶

Xhibrili paraqitet për herë të dytë

Ibni Haxheri thotë: *“Kjo ka ndodhur (ndërprerja e Shpalljes që ka zgjatur ditë me radhë) me qëllim që Resulullahu të lirohej nga frika dhe të fitonte përsëri vetëbesim. Kur është zhdukur pavendosmëria, kur janë vërtetuar shenjat e së vërtetës dhe kur Resulullahu ka qenë i vetëdijshëm për bindjen e fuqishme se është bërë Pejgamber i Allahut të Lavdëruar dhe të Lartësuar, dhe se Xhibrili është transmetues i Shpalljes e jo ndonjë halucinacion, se ky është ai që do të mbarte Shpalljen nga qielli, vetëm atëherë, në qetësimin dhe në baraspeshimin e plotë shpirtëror, i erdhi përsëri Xhibrili, përkatësisht për të dytën herë.”*

Buhariu transmeton nga Xhabir b. Abdullahu, i cili e ka dëgjuar Resulullahun, duke shpjeguar ndërprerjen e Shpalljes, të thotë: *“Ndërsa shkoja (përtej malit) dëgjova një zë nga qielli. Ngrita shikimin lart dhe e pashë engjëllin, i cili më pat ardhur në Hira. Rrinte ulur në një karrige, e cila qëndronte pezull, as në qiell e as në tokë, atëherë pata frikë nga ai dhe ula shikimin në tokë. U ktheva në shtëpi dhe ashtu i frikësuar, thashë: “Më mbuloni! Më mbuloni!”, e ata më mbuluan, kurse Allahu shpalli:*

“O ti i mbuluar! Ngrihu dhe tërhiqu vërejtjen (duke i thirrur)” gjer te fjala fehcxhur, mandej shpallja ka ardhur rregullisht.”³⁷

Mësimet dhe këshillat e përfituara nga fillimi i shpalljes

1. Hadithi i ‘fillimit të shpalljes’ është themel mbi të cilin ndërtohen të gjitha të vërtetat e fesë, që nga besimi e deri te ligjet, ndërsa kuptimi i tij dhe bindja në të janë dy parakushte për t’u bindur në tërë fenë, me të cilën u dërgua Muhammedi [alejhis salatu ves selam].

Nga këtu, nuk është për t’u çuditur pse armiqtë e Islamit e trajtojnë aq shumë punën e shpalljes (vahjit) dhe derdhin tërë atë mund dhe energji për të ndërlikuar kuptimet dhe domethëniet e saj duke e pështjellë atë me inspirim,

³⁶ Sahihu-l-Buhari: Kitabu Tab’ir, kaptina që fillon me: Shenjat e para të Shpalljes te Resulullahu kanë qenë me anë të er-ru’ja saliha, II/34.

³⁷ Sahihu-l-Buhari: Libri El-Tefsir, II/733.

vesvese, pëshpëritje, e madje edhe çmenduri. Për ta luftuar Islamit dhe zhvleftësuar kredon e tij, ato fokusohen pikërisht te shpallja – vahji...

Prej tyre pati të atillë që dhanë mendimin se Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] vazhdoi të meditonte derisa vetvetiu zbuloi një kredo me të cilën mendonte se mund ta zhdukte idhujtarinë. Ata pretendojnë se Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] e mori Kur'anin dhe parimet e Islamit nga prifti Buhajra... Kishte edhe të atillë që e akuzonin Muhammedin, [*alejhis salatu ves selam*] për të çmendur dhe fanatikë.

2. Çuditja e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] nga befasia e pamjes së Xhibrilit [*alejhis salatu ves selam*] i cili i thoshte: Lexo! Është për të kuptuar se Vahji nuk është diç e brendshme, nuk është nga të folurit e brendshëm (vesi, përshtirja) por është diç që po pranohet, takim me një të vërtetë të jashtme, që nuk ka të bëjë aspak me vetveten (akuzat se nuk është fjala për melek por për imagjinatë, iluzion etj.)

Shtrëngimi i tij nga meleku tri herë dhe përsëritja e urdhrit: 'Lexo!' -janë një tjetër argument shtesë për atë që thamë më parë.

3. Dukuria e shpalljes nuk ka ardhur si plotësuese e ndonjë gjëje që mund ta ketë imagjinuar njeriu. Jo. Befasia e Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*] flet për diç që nuk e ka pritur më parë... Ndryshe, inspirimi dhe gjërat e tjera që i përmendën ata nuk do të duhej të shkaktonin frikë, pasiguri, ndryshim gjendje...

4. Fakt tjetër, po kështu nga vetë rasti, është se frika e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], kur u shtrëngua nga meleku, ishte jo prej melekut (ngase nuk e dinte) por nga ndonjë xhin. Ishte Hatixheja ajo që e qetësonte duke i thënë se një njeri sikurse ty xhinët nuk mund ta pushtojnë dhe nuk mund t'i bëjnë asnjë të keqe.

5. Urtësia hyjnore parasheh që personaliteti i Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*] pas shpalljes të jetë krejtësisht ndryshe nga ai i para shpalljes, për të shpjeguar kështu se kredoja islame nuk ishte diç në të cilën Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] i ishte mbushur mendja që t'i ftonte njerëzit më herët.

6. Shkuarja e Hatixhes tek kushëriri i saj, Vereka, për të diskutuar mbi atë që i ndodhi të shoqit, flet për një lidhje vertikale të të gjithë pejgamberëve...

Ndërprerja e shpalljes për një kohë, po kështu, fsheh në vete një urtësi. Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] nuk do ta shihte melekun për një kohë të gjatë, aq sa do të dyshonte se Zoti e kishte braktisur për ndonjë gabim të tijin. Kjo është për t'ua mbyllur gojën atyre që shpifin se kinse Muhammedi [alejhis salatu ves selam] nuk ka pasur kontakt me botën e jashtme (melekët)...

Pejgamberi [alejhis salatu ves selam] ishte analfabet dhe njeriu nuk mund t'i mësojë vetvetiu të vërtetat historike, si fjala vjen tregimi i Jusufit [alejhis salatu ves selam], nënës së Musasë [alejhis salatu ves selam] që hodhi të birin në det, tregimin e Faraonit, mu ashtu siç thotë Allahu:

“Ti (Muhammed) nuk ishe që lexon ndonjë libër para këtij, e as që shkruaje atë me dorën tënde të djathtë, pse atëherë do të dyshonin ata të prishurit.” (el-Ankebut, 48)

Ligjërata e shtatë:

PERIUDHAT DHE ETAPAT E PREDIKIMIT GJATË JETËS SË PEJGAMBERIT [ALEJHIS SALATU VES SELAM]

Prej fillimit të shpalljes e deri në përfundim të jetës së Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], daveja apo predikimi ka kaluar nëpër këto faza:

- 1) Faza e predikimit të fshehtë, që ka zgjatur plot tri vite
- 2) Faza e predikimit verbal publik, që ka zgjatur nga kjo periudhë e deri në Hixhret (në Medinë)
- 3) Faza e predikimit publik, por duke luftuar armiqtë dhe ata që ua paraprinin me luftë. Kjo fazë ka zgjatur nga Hixhreti e deri në marrëveshjen (ar. sulhin) e Hudejbijes

- 4) Faza e predikimit publik duke luftuar të gjithë ata që pengonin predikimin islam apo refuzonin të hynin në Islam, idhujtarë apo të tjerë qofshin, kuptohet pasi që më parë të ishin thirrur në Islam.

Kjo është periudha në të cilën është vendosur apo stabilizuar sheriatu islam dhe mbi bazën e tij është ndërtuar dispozita e xihadit në Islam.

Faza e parë: Predikimi fshehtas

Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] filloi t'i përgjigjej urdhrit hyjnor dhe të ftonte njerëzit në besimin e pastër dhe braktisjen e idhujve. Por, duke pasur parasysh fanatizmin e madh të kurejshëve për idhujt e tyre, atëherë, si hap strategjik, ai ftonte fshehurazi. Nga frika e reagimeve, ai nuk e kumtonte Islamin në ambiente të hapura, por fokusohet kryesisht tek disa të afërm të cilët i njihte mirë. Prej të parëve që iu përgjigjen thirrjes së tij ishte Hatixheja, gruaja e tij, pastaj Aliu, Zejd Ibn Haritheh, Ebu Bekri, Uthmani, Zubejr Ibn Avvami, AbduRrahman Ibn Afi, Sa'd IbnEbi Vekkasi etj. Këta takoheshin fshehurazi me Pejgamberin [*alejhis salatu ves selam*]. Nëse ndonjëri donte të kryente ndonjë adhurim, atëherë këtë e bënte larg syve të mekasve.

E kur numri i tyre arriti në dyzet, atëherë lindi edhe nevoja e një vendtakimi për udhëtim dhe këshilla, kështu që Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] zgjodhi shtëpinë e Erkam Ibn Erkamit. Shumica e atyre që pranuan Islamin në këtë kohë, me ca përjashtime, ishin nga radhët e të varfërve.

Mësimet e përfituara nga predikimi në këtë fazë

1. Fshehja e predikimit në fillim të shpalljes nuk është bërë pse Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] kishte frikë për veten. Assesi. Ai e dinte mirë se ishte i Dërguar i Allahut dhe se ishte nën mbrojtjen e Tij. Këtë e dëshmojnë ajetet:

"O ti i mbuluar! 2. Ngrihu dhe tërhiq vërejtjen (duke i thirrur)." (el-Muddeth-thir, 1-2)

Fshehja e predikimit patjetër se është bërë për një urtësi të madhe, e kjo është që thirrësve pas Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] t'iu mësohet metoda e përfilljes së shkaqeve së pari, e pastaj të mbështeten tek Allahu i Madhëruar...

Nga këtu mund të kuptojmë se metodologjia e tij e thirrjes nuk ishte nga aspekti i të qenit të tij pejgamber, por nga politika fetare (strategjia), pra nga aspekti i të qenit lider.

Bazuar në këtë, thirrësit janë të lirë që të zgjedhin metodologjinë e thirrjes që përshtatet me kushtet dhe rrethanat në të cilat jetojnë, me kusht që metoda e zgjedhur të ketë dobi për thirrjen.

Po kështu, bazuar në këtë fazë të predikimit pejgamberik, dijetarët kanë nxjerrë konkluzionin e përbashkët se në rastet kur besimtarët janë të paktë dhe kanë fituar bindjen se po iu rrezikohet edhe ekzistenca, atëherë duhet t'i japin përparësi interesi individual ndaj atij fetar, pra ta fshehin përkatësinë fetare për ta ruajtur jetën e tyre.

Përfundimisht, mund të themi se nëse kumtimi publik paraqet rrezik, atëherë predikimi mbahet i fshehur, ndryshe, nëse në predikimin publik nuk ka rrezik dhe njerëzit kanë dobi në të, predikohet haptazi. Nëse muslimanët e kanë fuqinë, atëherë ata nuk kanë përse të lidhin marrëveshje me tiranët dhe armiqtë. Përkundrazi, ata në rastet kur fuqia është në anën e tyre nuk guxojnë t'i shmangen xhihadit, qoftë edhe në tokat dhe vendbanimet e jomuslimanëve.

2. Të parët që nxituan të hynin në Islam ishin kryesisht nga radhët e njerëzve të varfër dhe pa ndonjë pozitë. Kështu kanë qenë të gjithë pasuesit e pejgamberëve. Nuhut [alejhis salatu ves selam], disa prej popullit të vet, ia "arsyetuan" refuzimin me faktin se pasuesit e tij janë njerëz pa autoritet.

"Paria që nuk besoi nga populli i tij tha: "Ne nuk të shohim ndryshe vetëm si njeri, sikurse edhe ne, ne nuk po shohim se të pasoi kush, përveç atyre që janë më të poshtrit e më mendjehetit nga mesi ynë dhe ne nuk shohim se ju keni ndonjë vlerë mbi ne, përkundrazi, ne ju konsiderojmë gënjeshtarë!" (Hud, 27)

Kështu i tha edhe Salihut [alejhis salatu ves selam] populli i vet:

"Krerët kryelartë nga populli i tij u thanë atyre që ishin më të dobët e që kishin besuar: "A e dini se me të vërtetë Salihu është i dërguar nga Zoti i tij?". Ata thanë: "Vërtet, ne jemi besimtarë të asaj me çka është dërguar"." (el-A'rafë, 75)

Sekreti i kësaj qëndron në atë se misioni i kësaj feje, me të cilën janë dërguar të gjithë pejgamberët, është nxjerrja e njerëzve nga pushteti i njerëzve në pushtetin e Allahut. Kjo është një e vërtetë që lëkund karriget dhe fronet e pushtetarëve, ndërsa reflekton shpresë për të dobëtit. Dhe, normalisht, pushtetarët do të reagonin duke shfaqur mendjemadhësi, refuzim dhe mëri ndaj kësaj thirrjeje. Imazhe të këtij predikimi islam mund të hasim përgjatë gjithë historisë islame. Në Betejën e Kadisijes, gjatë takimit të një ushtari musliman me Rustemin, komandantin persian, ky i fundit e pyeti ushtarin musliman: -Përse na luftoni? Çfarë iu shtyri të vini në vatrën tona? Përgjigja e ushtarit ishte: -Kemi ardhur për t'i nxjerrë ata që duan nga adhurimi i njerëzve në adhurimin e Zotit të njerëzve!

3. Kjo, zhvleftëson edhe shpifjet dhe akuzat e pabaza të orientalistëve dhe të tjerëve se kinse misioni i Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] ka të bëjë me ambientin arab dhe se ai paraqet një lëvizje ideore arabe. Sikur të ishte kështu, atëherë ata dyzet muslimanët e parë, burra e gra, nuk do të ishin nga radhët e fukarenjve, shërbëtorëve dhe të dobtëve, dhe ata nuk do të detyroheshin ta lëshonin fare Mekën për të shkuar në Etiopi!

Faza e dytë: Predikimi publik

Ibni Hishami, një ndër historianët më me famë, për periudhën në fjalë thotë: Pastaj njerëzit filluan ta përqaфонin me të madhe këtë fe, burra dhe gra, kështu që Islami filloi të përhapej në Mekë dhe njerëzit filluan të flisnin për të. Allahu e urdhëroi të Dërguarin që ta kumtonte të vërtetën dhe t'i ftonte njerëzit në të...

"Publiko haptas atë për të cilën urdhërohesh, e hiq idhujtarëve." (el-Hixhr, 94)

"Dhe tërhiqja vërejtjen farefisit tënd më të afërt. 215. E të jesh i butë ndaj besimtarëve që të pranuan ty." (esh-Shuara, 214-215)

Si veprim praktik, Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] u ngjit në kodrën Safa dhe filloi të thërrasë: - O bijtë e Fehrit! O bijtë e Adijit!... Kur u tubuan të gjithë, atëherë Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] iu tha: -Çfarë thoni, sikur t'iu thosha se pas kësaj kodre ka armiq që duan t'iu sulmojnë, a do të më besoni? - Kurrë nuk na ke gënjyer, - i thanë. - Atëherë, unë (iu lajmëroj se) jam qortues (ua tërheq vërejtjen) për një dënim të ashpër. Xhaxhai i tij, Ebu Lehebi, i tha: - Shkatërruar qofsh tërë ditën, a për këtë na paske thirrur...

Allahu për këtë rast shpalli:

“Qoftë i shkatërruar Ebi Lehebi, e ai më është shkatërruar! 2. Atij nuk i bëri dobi pasuria e vet, as ajo çka fitoi! 3. Ai do të hyjë në një zjarr të ndezur flakë. 4. E edhe gruaja e tij, ajo që barti dru (ferra), 5. E në qafën e saj ajo ka një litar të përdredhur.” (el-Mesed, 1-5)

Pastaj, Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ftoi dhe tuboi të gjithë të afërmit dhe farefisën e tij dhe iu tha: -O bijtë e Ka’b Ibn Luejit! Shpëtojeni veten nga zjarri i xhehenemit! O bijtë e Murrçrre Ibn Ka’bit! Shpëtojeni veten nga zjarri i xhehenemit! O bijtë e Abdu Shemsit! Shpëtojeni veten nga zjarri i xhehenemit! O bijtë e Abdul Muttalibit! Shpëtojeni veten nga zjarri i xhehenemit! Oj Fatime (bija e Muhammedit), shpëtoje veten nga zjarri i xhehenemit, ngase unë nuk mund t’iu ndihmojë tek Allahu asgjë, përveç që jemi të lidhjes amnore, për çka do ta informoj Atë.

Kurejshët, siç pritej, e refuzuan thirrjen e tij me pretekstin se nuk mund t’i braktisnin zotat e baballarëve të tyre, me gjithë faktin se Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] iu foli për rëndësinë e çlirimit nga imitimi i verbër, sikurse që u foli për kotësinë e adhurimit të idhujve.

“E kur u thuhet atyre: "Ejani tek ajo që e zbriti All-llahu dhe tek (ajo çka thotë) i dërguari, ata thonë: "Na mjafton ajo që i gjetëm prindërit tanë", (a mjafton) edhe nëse prindërit e tyre ishin që nuk dinin asgjë dhe nuk ishin në rrugë të drejtë.” (el-Maide, 104)

E kur ua “ofendoj” zotat, ata e kundërshtuan pa asnjë rezervë...

Mësimet e marra nga kjo fazë predikimi

1. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] i kishte befasuar kurejshët dhe të gjithë arabët me thirrjen e tij. Ata nuk e kishin pritur fare këtë gjë. Këtë e shohim nga fjalët e Ebu Lehebit... Ky është një fakt dhe dëshmi kundër atyre që misionit të Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] i japin karakter nacional (kombëtar) dhe se kinse Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] me thirrjen e vet nxitonte për të realizuar shpresat dhe ambiciet e arabëve. Kjo është një akuzë qesharake dhe marrja me të do të ishte vetëm humbje kohe. Krejt ata që kanë lexuar jetën e tij e dinë shumë mirë se ajo është një shpifje dhe asgjë më shumë.

2. Veçimi, fillimisht, i familjes dhe fisit me thirrje, fsheh në vete urtësi, të cilat reflektojnë përgjegjësinë dhe shkallët apo nivelet e saj. Niveli i parë i përgjegjesisë është *përgjegjësia për vetveten*, dhe këtë mund ta vërejmë në periudhën në të cilën Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] nuk ftoi askënd në Islam derisa u bind se vërtet ishte i Dërguar i Allahut dhe se ajo që i shpallej ishte prej Zotit. Pas kësaj, vjen *përgjegjësia për familjen* dhe të afërmit. Nuk ka dallim ndërmjet thirrjes së pejgamberëve [*alejhimus selam*] në popujt e tyre dhe thirrjes së njeriut në familjen dhe të afërmit e tij. Ashtu sikurse që nuk i lejohet një pejgamberi të braktisë misionin e tij, po kështu nuk i lejohet një kryefamiljari të shmanget nga thirrja e familjarëve dhe të afërmeve të tij në Islam. Niveli i tretë i përgjegjesisë është *përgjegjësia e dijetarit për lagjen dhe rrethin ku banon dhe përgjegjësia e kryetarit për popullin dhe shtetin e vet*. Që të dy, edhe dijetari edhe kryetari, janë zëvendësues të pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*], për arsye se ai vetë i ka emërtuar: të parët (dijetarët) si trashëgimtarë dhe të dytët si zëvendës (halife).

Kësisoj, ne shohim se Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] bartte përgjegjësinë për veten, si çdo njeri tjetër i obliguar me detyra fetare, pastaj ndiente përgjegjësi për familjen si kryefamiljar, dhe ndiente përgjegjësi edhe për të gjithë njerëzit si i Dërguar i Zotit për të gjithë ata.

Pra, bashkëpjesëmarrës me Pejgamberin [*alejhis salatu ves selam*] në nivelin e parë të përgjegjesisë është çdo musliman në moshë të rritur, në të dytin çdo familjar dhe në të tretin dijetarët dhe pushtetarët.

3. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ia pa për të madhe popullit të vet traditat e trashëguara nga të parët, pa selektuar të mirën dhe të keqen. Ai i ftoi ata në çlirim të mendjes nga robëria e imitimit të verbër. Ky rast provon se Islami është fe e mendjes dhe logjikës. Mu për këtë, prej kushteve të besimit (imanit) është ndërtimi i tij mbi bazat e bindjes dhe mendimit të lirë, pa asnjë presion a ndikim nga jashtë. Autori i Xhevheretu't Teuhid përfundon me konkluzionin se: "*Besimi i atij që imiton në besim (teuhid) nuk mund të jetë i pastër nga dyshimet.*"

4. Kjo, po kështu, është dëshmi se feja ka ardhur për të luftuar traditat (e urryera), ato që njerëzit i përvetësuan qoftë në gazmendet apo edhe në pikëllimet

e tyre. Të gjitha këto janë të njohura si 'tradita' dhe të gjitha (që nuk përputhen me fenë) duhet të kundërshtohen.

Nëse e kemi kuptuar si duhet këtë, atëherë do të kuptojmë edhe rrezikun e madh që bart shkujdesja e njerëzve në përdorimin e fjalës 'tradita islame', fjalë me të cilën nënkuptojnë adhurimet, dispozitat, ligjet dhe moralin islam. Të gjitha ligjet dhe normat e Islamit janë të themeluara mbi bazën e medimit dhe mendjes dhe jo se Islami mbështetet në doke e zakone.

Islami është feja e cila ka ardhur për të pastruar mendjen nga bakteret e zakoneve dhe traditave. Zhvillimi dhe prosperiteti duhen kontrolluar nën hijen e parimeve e jo të zakoneve. Zakonet, në fakt, janë parazitë që zhvillohen në mendjet e njerëzve, janë barishte të egra, që patjetër duhen shkukur me rrënjë...

Ligjërata e tetë:

TORTURAT DHE DHUNA FIZIKE NDAJ BESIMTARËVE

Kurejshët e torturuan në forma të ndryshme Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*]. Abdullah Ibn Amr el-Asi rrëfen se derisa Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] falej në dhomën e Ismailit [*alejhis salatu ves selam*], shkoi Uke Ibn Muiti dhe e lidhi me një rrobe për fyti duke e shtrënguar shumë. Kështu e mbajti derisa erdhi Ebu Bekri dhe i shtyu duke i thënë: - A doni ta mbytni një njeri vetëm pse thotë 'Zoti im është Allahu'?!...

Abdullah Ibn Omeri transmeton një tjetër ngjarje nga dhuna që ushtrohej ndaj Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*]. Derisa Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ishte në sexhde duke u falur, shkoi Ukbe Ibn Muiti dhe i hodhi sipër zorrë kafshësh. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] mbeti në atë gjendje në sexhde derisa erdhi Fatimja, e bija, dhe ia hoqi ndërsa ai lutej kundër atyre që ia bënë këtë...

Ndërsa ofendimet verbale ishin më shumë se ç'mund të regjistrohen. Sa herë kalonte rrugës pranë tyre, e shanin, e ofendonin, talleshin me të, e ndonjëherë dikush merrte një grusht me dhé e ia hidhte fytyrës. Kështu i ngjau një ditë dhe ai nuk e shkundi fare dheun nga fytyra, derisa shkoi në shtëpi, ku njëra prej

vajzave të tij u ngrit duke qarë dhe ia hoqi atë. Pejgamberi [alejhîs salatu ves selam] e qetësonte duke i thënë asaj se Allahu ka për ta mbrojtur babanë tënd!

Tortura dhe persekutime përjetuan edhe shokët e tij, madje disa prej tyre edhe vdiqën e u gjymtuan, por kjo nuk i bëri të lëkunden kurrë në besimin e tyre. Buhariu transmeton nga sahabiu i nderuar, Habbab Ibn Eretti, i cili thotë se kishte shkuar tek Pejgamberi [alejhîs salatu ves selam] për t'iu ankuar për gjendjen në të cilin ishin ata në Mekë. E gjeti atë të mbështetur në një rrobe të tijën nën hijen e Qabesë dhe i tha: - O i Dërguari i Allahut! A nuk do të lutesh për ne? Pejgamberi u ul, ndërsa fytyra i qe skuqur dhe tha:

Para jush ndodhte që njeriu të merrej dhe të futej në një gropë, t'i vihej mbi kokë një sharrë, e cila e ndante në dysh dhe kjo prapë nuk e largonte prej fesë së tij. Ndodhte po kështu që mishi t'iu krihej me krehër të hekurt, derisa ndahej mishi nga eshtrat dhe as kjo nuk i largonte nga feja. Pasha Allahun, Allahu ka për ta plotësuar këtë fe, derisa udhëtari (me kalë apo mjet udhëtimi) do të ecë nga San'aja deri në Hadramevt duke mos ia pasur frikën askujt përveç Allahut apo ujkut për delet e tij, por ju po nguteni."

Mësimet fetare, shoqërore dhe metodologjike që merren nga kjo fazë persekutimi

1. Pyetja e parë që do t'i vinte ndërmend njeriut pasi që të ketë lexuar për torturat që përjetoi Muhammedi [alejhîs salatu ves selam] dhe shokët e tij është: Nëse Muhammedi [alejhîs salatu ves selam] dhe shokët e tij luftonin për të vërtetën, atëherë pse nuk i mbrojti Allahu? Përgjigja është se njeriu në këtë botë është i ngarkuar me detyra dhe obligime, të cilat mund të jenë të rënda dhe të vështira. Sigurisht se edhe thirrja në rrugën e Allahut dhe xihadi për ngritjen dhe lartësimin e fjalës së Tij janë të lidhura me këtë obligime dhe këto vështirësi. Ndryshe, nënshtrimi dhe adhurimi nuk do të kishin kuptim përderisa njeriu nuk është i obliguar. Kjo, rrjedhimisht, nënkupton edhe përballimin e vështirësive dhe mundimeve, si dhe luftimin e epshit dhe nefsit...

2. Bazuar në këtë, muslimanët e kanë për obligim që, për sa kohë të jenë gjallë, të punojnë për dy gjëra:

- a) Mbajtjen e fesë së Allahut dhe organizimin e jetës në nivel familjar dhe shoqëror sipas kësaj feje, dhe

- b) Rrezikimin dhe shpenzimin e të mirave materiale për realizimin e këtyre qëllimeve.

Kjo pra do të thotë se Allahu na ka obliguar parimisht me besim, por dhe me gjëra të tjera të cilat ndihmojnë në realizimin e këtij besimi, në këtë rast dhënies dhe kontributit material për të.

3. Në këtë fshihet dhe një urtësi tjetër. Allahu, po të donte, sigurisht se do ta bënte të lehtë themelimin e një shoqërie islame, por atëherë nuk do të mund të dalloheshin të mirët nga të këqijtë, të sinqertit nga gënjeshtarët dhe hipokritët, e kështu me radhë.

4. Pra, tërë ajo që e përjetojnë thirrësit në rrugën e Allahut për themelimin e shoqërisë islame është brenda kornizave të një ligji hyjnor, të aplikuar përgjatë gjithë historisë.

Në fakt, këtë ligj e përcaktojnë tri gjëra me rëndësi:

- a) Atributi i njeriut prej robi të nënshtruar ndaj Allahut, siç thotë Allahu:
“Unë nuk i krijova xhinët dhe njerëzit për tjetër pos që të më adhurojnë.”
(edh-Dharijat, 56)
- b) Atributi i të qenët i obliguar që është si rezultat i atributit paraprak, pra atij i të qenit rob i Allahut. Nuk ka musliman, në moshë të rritur dhe i aftë mendërisht, që nuk është i obliguar për ta zbatuar fenë e Allahut në vete, familje dhe shoqërinë ku jeton, pavarësisht kostos së madhe që kërkon zbatimin e kësaj.
- c) Shfaqja e sinqeritetit dhe gënjeshtërisë. Sikur dashuria për Allahun dhe fenë e Tij të shfaqeshin vetëm në mënyrë verbale, vështirë se do të mund të dallohej besimtari i mirë nga të tjerët, i sinqerti nga hipokriti. Peshorja e vlerësimit të besimit dhe mungesës së tij është sprova. Allahu ka thënë:
“Elif, Lam, Mim. 2. A menduan njerëzit të thonë: "Ne kemi besuar, e të mos vihen në provë?" 3. Ne i sprovuam ata që ishin para tyre, ashtu që All-llahu gjithqysh do t'i dallojë ata që e thanë të vërtetën e do t'i dallojë edhe gënjeshtarët.” (el-Ankebut, 1-3)
“A mos menduat ju se do të hyni në xhennet e All-llahu pa e ditur (pa u vërtetuar në praktikë) se cilët prej jush kanë luftuar dhe pa e ditur cilët prej jush ishin të durueshëm.” (Ali Imran, 142)

5. Nëse ky është ligj i Allahut, atëherë dije se ai nuk ndryshon për askënd dhe rrjedhimisht as edhe për të Dërguarit e Allahut. Si rezultat i kësaj, ti sheh se u persekutua i Dërguari i Allahut dhe shokët e tij, e madje nga këto persekutime vdiqën shumë prej tyre.

6. Nëse këtë arrijmë ta kuptojmë esencialisht, atëherë bindja dhe shpresa jonë për të kumtuar mesazhin e Allahut do të jenë më të forta. Kjo për shkak se disa nga njerëzit ndonjëherë i shohin barrierat si të pakapërcyeshme, ndërsa kur ta mësojnë këtë binden se fjala është vetëm për një ligj të Allahut që duhet përfillur dhe i cili nuk ndryshon përveçse duke përjetuar vështirësitë dhe sprovat, të cilat mund të them se janë të mishëruara sidomos me fenë tonë.

7. Besimtarët duhet të përgëzohen me fitore, sa herë që sprovat dhe mundimet iu shtohen. Këtë do ta gjesh edhe në Kur'an. Allahu thotë:

"Po ju menduat se do të hyni në xhenet, pa u provuar edhe ju me shembullin e atyre që ishin para jush, të cilët i patën goditur skamjet e vuajtjet dhe qenë tronditur, saqë i dërguari thoshte, e me të edhe ata që kishin besuar: "Kur do të jetë ndihma e All-llahut"?! Ja (u erdhi ndihma) vërtet ndihma e All-llahut është afër!" (el-Bekare, 214)

Përgjigja për ata që nuk e kuptuan natyrën e kësaj feje dhe menduan se sprovat janë vetëm shkak i largimit të tyre nga feja, ishte: *"Ja (u erdhi ndihma,) vërtet ndihma e All-llahut është afër!"*

8. Këto domethënie dhe këto botëkuptime janë të fshehura edhe në përgëzimet e Pejgamberit [alejhis salatu ves selam] për shokët e tij për çlirimin e shteteve persiane dhe romake. Ai i paralajmëroi për një gjë të tillë, por vetë nuk arriti t'i shihte të çliruara ngase vdiq. Do të kishte qenë imazh dashurie ndaj Pejgamberit [alejhis salatu ves selam] sikur këto vende të çliroheshin në të gjallë të tij, por, ligji hyjnor që e përmendëm sipër, sikur parashihte se muslimanët duhet të japin ende më shumë. Në fakt, çlirimi i shteteve nuk lidhet doemos me udhëheqjen fizike të Muhammedit [alejhis salatu ves selam]: e rëndësishme është t'i qëndrohet besnikërisht besës së dhënë Allahut, siç thotë vetë Ai:

"All-llahu bleu prej besimtarëve shpirtrat dhe pasurinë e tyre me xhenet. Luftojnë në rrugën e All-llahut, mbysin dhe mbyten. (All-llahu dha) Premtim të

cilin e vërtetoi në Tevrat, Inxhill e Kur'an. E kush është zbatues më i sigurt i premtimit të vet se All-llahu? Pra, gëzojuni tregtisë që e bëtë me Të. Ky është sukses i madh.” (et-Teube, 111)

Ligjërata e nëntë:

POLITIKA E NEGOCIATAVE

Ibni Is'haku³⁸ tregon: “Jezid b. Zijadi tregon se Muhammed b. Ka'bi ka thënë: “Kjo ka ndodhur kur Utbe b. Rebia ishte kryepar. Një ditë në këshillin e kurejshëve ky tha (Resulullahu ishte i ulur vetëm në mesxhid): “O kurejshë, a dëshironi të shkoj te Muhammedi? Do të flas me të dhe do t'i propozoj disa gjëra. Ndoshta do të pranojë ndonjërin prej tyre. Do t'i japim gjithçka dëshiron, vetëm të na lërë të qetë.” Kjo ka ndodhur pas kalimit të Hamzës në Islam.

Duke qenë se numri i as'habëve të Muhammedit [alejhis salatu ves selam] rritej nga dita në ditë, ata thanë: “S'ka mbetur tjetër, ngrihu o Ebul-Velid, shko dhe fol me të.” Utbe u ngrit, iu afrua Muhammedit [alejhis salatu ves selam] dhe tha: “O nipi im, siç e di edhe vetë, ti je nga gjaku dhe origjina jonë fisnike. E ke vendin tënd në familje dhe

³⁸ Me kërkesën e autorit është shtuar edhe kjo pjesë nga Nektari i vulosur i Xhennetit, f. 124-125.

në brez. Popullit tënd i bëre padrejtësi të madhe, i ke ndarë në grupe, ua ke rrënuar ëndrrat, ua ke poshtëruar zotat dhe besimin e tyre, gjyshërit tanë i bëre jobesimtarë. Më dëgjo, po të ofroj disa zgjidhje, besoj se do t'i pranosh, bile disa nga ato."

"Fol, o Ebul-Velid, po të dëgjoj," - tha Resulullahu.

"O nipi im, nëse dëshiron pasuri për këtë fe që je duke kumtuar, ne do ta mbledhim nga pasuritë tona dhe do të jesh më i pasuri në mesin tonë. Nëse dëshiron të na sundosh, do të zgjedhim për kryepar tonin dhe asgjë nuk do të bëjmë pa dijen tënde. Nëse dëshiron pushtet, do të të zgjedhim për kryetar. Nëse tërë këtë që je duke përjetuar dhe po të shtiret se je pejgamber nuk mund ta dëbosh nga vetvetja, do të kërkojmë mjek për ty dhe nuk do të kursejmë asgjë vetëm që ti të shërohesh nga kjo sëmundje, sepse vetë natyra e njeriut nganjëherë e ngadhënjën atë, andaj ka nevojë për shërim." "A e kreve, tanimë o Ebul-Velid?" "Po", - tha ai. "Atëherë, pra, më dëgjo mirë," - tha Muhammedi.

"Bismil-Lahir-Rahmanir-Rahim. Ha, Mim. (Kjo është) Shpallja prej Bamirësit, Mëshiruesit. Libër, argumentet e të cilit janë të qarta, (që është) Kur'ani në gjuhën arabe, për popullin që di. Si sihariques dhe paralajmërues, por shumica e tyre janë shmangur (prej studimit të tij) e nuk duan të dëgjojnë. (Por) Thonë: "Zemrat tona janë të mbuluara (blinduara e nuk kuptojnë) për atë që na thërret ti, veshët tanë janë të shurdhër për atë, e mes nesh e teje ka perde, andaj puno ti (në idenë tënde), (por) me të vërtetë, dhe ne do të punojmë". (Fussilet: 1-5).

Resulullahu vazhdoi të këndonte ajete nga kjo sure, kurse Ebul-Velidi dëgjonte në heshtje. Duart i kishte vënë prapa shpine, dhe i mbështetur edhe më tej dëgjonte, dëgjonte. Kur Resulullahu arriti tek ajeti i sexhdes, bëri sexhde dhe tha: "O Ebul-Velid, kjo që nga unë, e ti mund të vepros si të duash."

Utbe u ngrit dhe vajti te shokët e vet, të cilët flisnin për të. Kur e panë, thanë: "Betohemi për Zotin se Ebul-Velidi po kthehet me fytyrë tjetër nga ajo me të cilën ka shkuar, është i disponuar ndryshe." Pasi u ul, ata pyetën: "E, ç'u bë? Çfarë lajme na solle?" Ai u përgjigj: "Ju solla lajme se dëgjova fjalë që, për Zotin tim, nuk i kam dëgjuar gjer më tani. Për Zotin, nuk janë vargje të poetit, e as fjali të magjistarit, e as mërmëritje të shortarit. O popull, o kurejshë, bëhuni të dëgjueshëm dhe fenë e tij ma lini mua. Lëreni këtë njeri vetëm dhe shmanguni nga ai. Betohem në Zotin se, ligjërimi që dëgjova, sjell porosi madhështore. Nëse arabët e refuzojnë atë, atëherë ju do të jeni të mjaftueshëm për të, por nëse shkon puna mbarë e të gjithë arabët e pranojnë, atëherë pushteti i tij do të jetë edhe juaji, nami i tij do të jetë edhe nami juaj, me të do të bëheni

populli më fatlum." Ata thanë: "O Ebul-Velid, të paska bërë magji!" Ai tha: "Ky është mendimi im për të, e ju veproni si të doni."³⁹

Në një version tjetër thuhet se Utbe e ka dëgjuar këndimin e Kur'anit, derisa Resulullahu, ka arritur gjer te:

"Nëse shmangen (refuzojnë besimin), ti thuaju: "Ju paralajmëroj me bubullimë (dënimin e tmerrshëm), asi dënimi çfarë e goditi Adin e Themudin." (Fussilet: 13).

Pastaj, u ngrit i shqetësuar dhe ia vuri Resulullahut dorën në gojë e tha: "Beto hem për Zotin se kjo është gjë e mirë." Me siguri këtë e ka thënë që të mos ishte i paralajmëruar. Pastaj u ngrit dhe shkoi te populli i vet dhe u tregoi për të gjitha.⁴⁰

Në këtë pjesë të sires pejgamberike gjenden tri argumente të rëndësishme:

Argumenti i parë:

Argumenti i parë shpalos thelbin dhe esencën e misionit të Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], sikurse që sqaron objektivat dhe idealet e tij. Ky argument është i rëndësishëm për faktin se promotorët e lëvizjeve dhe thirrjeve të ndryshme për reformim vuajnë nga mungesa e idealeve të tilla; në fakt ata mund t'i trumbetojnë publikisht ato, por në esencë, siç është dëshmuar dhe dëshmohet, ata kanë para së gjithash aspektin material.

Armiqtë e Islamit u munduan shumë ta dobësonin Islamin nga ky aspekt, por deshi Allahu dhe përpjekjet e tyre shkuan huq. Shumë mendimtarë jomuslimanë u munduan që të njollosnin misionin e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], kinse pas thirrjeve të tij qëndronte motivi për lidërsip dhe pasuri, por ky argument i zhvleftëson krejt ato fjalë. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] iu tha shumë qartë: Unë nuk kam ardhur për të kërkuar pasurinë, nderin dhe pozitën (lidërsipin) mbi ju, por Allahu më dërgoi tek ju si pejgamber dhe më shpalli libër... Më urdhëroi që të jam përgëzues dhe qortues në mesin tuaj...

Gjëra të tjera që dëshmojnë qëllimet e pastra të Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*] janë edhe:

³⁹ *Ibni Hisham: I/293, 294.*

⁴⁰ *Tefsiri Ibni Kethir: VI/159-161.*

a) Fjalët e tij ishin përkthim origjinal i jetës së tij. Ai iu largua pasurisë jo vetëm me gjuhë, por edhe fizikisht. Jetesa e tij ishte një jetesë e përkorë. Aisheja, siç transmeton Buhariu, ka thënë:

Vdiq Pejgamberi [alejhish salatu ves selam], ndërsa nuk unë kisha në dollapin tim diç që do ta hante ndonjë gjallesë, me përjashtim të ca elbi prej të cilit haja për një kohë të gjatë derisa e mata⁴¹ dhe u harxhua."

b) As shtroja dhe mbuloja e tij nuk ishin hiç më të mira. Ai nuk fjeti kurrë në diç të butë. Flinte në një hasër. Me një fjalë bënte një jetë të thjeshtë. Një ditë gratë iu ankuan dhe kërkuan që të paktën të kishin jetë të ngjashme me shoqet e tyre përreth, gjë që e hidhëroi shumë Muhammedin [alejhish salatu ves selam] dhe nuk u përgjigj derisa Allahu shpalli:

"O ti Pejgamber, thuaju grave të tua: "Në qoftë se lakmoni jetën e kësaj bote dhe stolitë e saj, atëherë ejani: unë po ju jap furnizimin (për lëshim) dhe po ju lëshoj ashtu si është e rrugës. 29. E në qoftë se e doni All-llahun, të dërguarin e Tij dhe botën tjetër, atëherë të jeni të sigurt se All-llahu ka përgatitur shpërblim të madh për ato prej jush që bëjnë punë të mira." (el-Ahzab, 29)

Pejgamberi [alejhish salatu ves selam] ua lexoi këto ajete kur'anore dhe i la të lira të zgjidhnin, por, kuptohet, ato zgjodhën jetën e vështirë vetëm e vetëm që të mos ndaheshin nga i Dërguari i Allahut.

Nuk di si mund të dyshohet në qëllimet e Muhammedit [alejhish salatu ves selam] pas kësaj që mësuam?! Me çfarë logjike mund të thuhet se pas misionit të tij fshihen ambiciet për para, luks, pozitë, pushtet?!

Argumenti i dytë:

1. Legjislacioni islam përcakton jo vetëm qëllimet, por edhe mjete për realizimin e tyre. Pra, qëllimet nuk realizohen me çfarëdo mjetes. Shikuar nga këndvështrimi politik, Pejgamberi [alejhish salatu ves selam] do të mund të pranonte pozitën e liderit për ta përhapur më pas Islamin me forcën e pushtetit,

⁴¹ Aisheja, siç komentohet, kishte pak elb, kështu që e maste për ta ditur se sa kishte mbetur... Përkthyesi.

gjë të cilën e ëndërrojnë promotorët dhe propaganduesit e lëvizjeve të ndryshme për t'ua imponuar njerëzve bindjet dhe idetë e tyre. Ideja për një gjë të tillë iu duk e mbrapshtë Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*], kështu që e refuzoi atë, ngase ajo has në kundërthënie me parimet e vetë këtij misioni. Po kështu, po të merrej si bazë kjo politikë, vështirë se do të mund të bënim dallim ndërmjet të sinqertit dhe hipokritit.

2. Filozofia e kësaj feje është e ngritur mbi ndershmërinë në qëllime dhe mjete. Ashtu sikurse që qëllimi duhet të jetë i ndërtuar mbi themelet e së vërtetës dhe sinqeritetit, po kështu edhe mjetet duhet të kenë bazë të tillë. Kjo, në një formë, është dhe një thirrje për muslimanët e devotshëm që për hire të kësaj feje duhet të sakrifikojnë shumë, ngase kjo fe është diçka që nuk lejon kthim djathtas e majtas.

3. Është gabim që urtësia (el-hikmeh) në da've të perceptohet si rruga më e lehtë dhe kursim për thirrësit nga sprovat dhe problemet. 'Urtësia' është mjet për t'ua bërë sa më të kapshme fenë njerëzve, për t'ua zbërthyer sa më thjesht domethëniet e saj, ndryshe, nëse në rrugën e davetit hasim në pengesa dhe barriera, atëherë 'urtësi' është xhihad dhe sakrifikimi me të gjitha format... Urtësi është të vësh gjërat në vendin e duhur dhe këtu qëndron edhe dallimi ndërmjet saj dhe '*muhadeas*' (mashtrimit, kurtheve). Tregimi i Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*] me disa liderë kurejshitë dhe Abdullah Ibni Ummi Mektumin dëshmon për këtë të vërtetë.

4. Konkludimi apo përfundimi që mund të nxirret nga kjo është se askush nuk ka të drejtë të ndërrojë diç nga parimet dhe dispozitat e Islamit me pretekstin e aplikimit të urtësisë (el-hikme) dhe këshillës (en-nesiha) në da've. Urtësia nuk merret për urtësi përderisa nuk është brenda kornizave të sheriatit islam.

Argumenti i tretë:

1. Qëndrimi i Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*] para kërkesave të kurejshëve ishte për t'u lakmuar. Pikërisht, dijetarët e kanë lidhur me atë qëndrim shpalljen e ajeteve në vijim:

"Ata thanë: "Nuk të besojmë ty derisa që të na nxjerrësh prej tokës burime". 91. Ose, (nuk të besojmë deri që) të kesh kopshte me hurma e me rrush, e të bësh të

rrjedhin vazhdimisht lumenj në mesin e tyre. 92. Ose, (nuk të besojmë derisa) të bie mbi ne qielli copa - copa, ashtu si po mendon ti (se do të na dënojë Zoti), apo të na sjellësh All-llahun dhe engjëjt pranë nesh. 93. Ose të kesh një shtëpi prej ari apo të ngjitesh lart në qiell, po ne nuk të besojmë për ngjitjen tënde derisa të na sjellësh një libër që ta lexojmë?!" Thuaj: "Subhanallah - i Madhërishëm është Zoti im, a mos jam unë tjetër vetëm se njeri, Pejgamber?" (el-Isra, 90-93)

Arsyeja pse Allahu nuk iu përgjigj kërkesave të tyre nuk është pse Muhammedi, [alejhis salatu ves selam] kishte mrekulli vetëm Kur'anin, (jo, ai kishte dhe shumë mrekulli të tjera) por se Allahu e dinte se kërkesat e tyre buronin vetëm nga mohimi, mëria, tallja dhe përqeshja me të Dërguarin e Tij, e jo se iu interesonin ato gjëra. Ndryshe, Allahu do t'ua plotësonte kërkesat, por puna e tyre ishte sikurse e atyre që Allahu i përshkroi në një vend tjetër në Kur'an:

"Edhe sikur Ne t'u hapnim atyre një derë në qiell dhe të ngjiteshin vazhdimisht lart në të (e t'i shihnin engjëjt e fshehtësitë). 15. Ata gjithqysh do të thoshin: "Neve na janë ndalë sytë (të parit). Jo, ne jemi njerëz të magjepsur". (el-Hixhr, 14-15)

Ligjërata e dhjetë:

BLLOKADA EKONOMIKE

Bojkoti i gjithëmbarshtëm⁴²

Kurejshëve u ndodhën katër ngjarje të paharrueshme brenda një kohe shumë të shkurtër, vetëm prej katër javësh. Hamza pranoi Islamit, pastaj këtë e bëri Umeri, pastaj Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] e refuzoi pazarllëkun e tyre rreth fesë islame dhe, më në fund, vendimi i përbashkët i Benu Hashimitëve dhe Benu Abdu-l-Muttalibëve, i besimtarëve dhe jobesimtarëve, për ta mbrojtur dhe për ta përkrahur Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*].

Mushrikët ishin të shqetësuar, të hutuar dhe të habitur. Nuk dinin çka të bënin. Nëse e mbytnin Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*], në luginën e Mekës do të derdhej shumë gjak për shkak të tij. Kjo mund t'i rrezikonte edhe më tepër ata dhe fenë e tyre, prandaj, për një kohë të shkurtër, hoqën dorë nga vrasja e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]. Por së shpejti do t'i shohim me marifetllëqe të reja dhe me tortura të llojit tjetër.

Kontrata mbi torturimin dhe armiqësinë

Kurejshët u tubuan në shpatet pjellore të fisit Benu Ken'aneh dhe u përbetuan kundër familjeve Benu Hashim dhe Benu El-Muttalib. Ata vendosën që të mos martoheshin me ta, të mos tregtonin dhe të mos flisnin me ta derisa ta dorëzonin Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] për ta mbytur. Ata e shkruan kontratën në një faqe letre, duke shtuar se kurrë nuk do të lidhnin paqe me benu hashimitët.

⁴² Kjo pjesë është marrë nga Nektari i vulosur i Xhennetit, f. 127-130.

Ibnu-l-Kajjimi shënon: “Ata thonë se këtë kontratë e ka shkruar Mensur b. Ikrime b. Amir bin Hashimi”, kurse të tjerët thonë Nadar b. El-Harithi. E vërteta është se shkrues i kontratës ka qenë Bagia b. Amir b. Hashimi. Resulullahu [alejhis salatu ves selam] i është lutur Allahut që ta ndëshkonte për këtë dhe atij iu paralizuan duart.⁴³ Pas nënshkrimit të këtyre vendimeve të rëndësishme për kurejshët, fletën e varën në brendi të Ka’bes, kurse benu hashimitët, benu muttalibët, të gjithë me radhë, përveç Ebu Xhehlit, i dërguan në izolim. Këtë e bënë më një muharrem në vitin e shtatë të pejgamberisë, kurse vendi i izolimit ishte Shu’ab-i -pronë e Ebu Talibit.

Tre vjet izolimi

Pasi fqinjët i përforcuan kufijtë e vendit të rrethuar “Shu’ab Ebu Talib”, ata ndërprejnë çdo kontratë me të izoluarit. Ndaluan hyrjen e ushqimit në Mekë, e nëse ndonjë mall paraqitej në treg atëherë nguteshin që ta blinin të tërin për vete që të mos arrinte te të izoluarit. Këta u gjendën në situatë të vështirë. Nuk kishin ushqim, andaj filluan të hanin gjethe, lëkura etj. Ndërsa jashtë mureve të kampit të përqendrimit dëgjoheshin klithmat e fëmijëve, gjëmat e grave dhe njerëzve të uritur. Ngandonjëherë furnizoheshin përmes kanaleve të fshehta me ushqim sa për të mbetur gjallë. Nga kampi i përqendrimit mund të dilnin vetëm në muajt e shenjtë. Herë-herë dilnin të blinin ndonjë deve nga tregtarët që ktheheshin, por mekasit e rritnin çmimin aq sa këta hiqnin dorë nga blerja, sepse nuk kishin me çka të paguanin.

Nganjëherë Hakim bin Hizami i dërgonte fshehtazi drithë kushërirës së vet, Hatixhes radijAllahu anha. Një herë Ebu Xhehli e zuri dhe deshi ta varte, por Ebu-l-Buhturi i ndau dhe i mundësoi Hakimit t’ia dërgonte drithin kushërirës.

Ebu Talibi kujdesej shumë për sigurinë e Resulullahut. Kur njerëzit niseshin për të fjetur, e urdhëronte atë të flinte në vendin e vet, por kur të gjithë binin në gjumë, i thoshte të ndërronte vendin. E mbronte kështu që të mos e rrëmbenin. Nganjëherë afër shtratit të tij vendoste djemtë apo vëllezërit e vet të bënë rojë. Gjatë kohës së Haxhit, Resulullahu dhe muslimanët dilnin dhe i thërrisnin njerëzit në Islam.

⁴³ *Zadu-l-Me’ad: 1/46.*

Prishja e kontratës mbi izolimin

Kaluan tre vjet e situata e muslimanëve të izoluar nuk ndryshoi fare. Në muajin muharrem⁴⁴ të vitit të dhjetë të pejgamberisë ndodhi ndërprerja e kontratës.

Në mesin e kurejshëve kishte njerëz që ishin të kënaqur me nënshkrimin e kontratës, por kishte edhe nga ata që nuk ishin të kënaqur me të. Këta të fundit e ndërprejnë fjalën e dhënë dhe i anuluan nënshkrimet e veta në letër. Nismën për ndërprerjen e kontratës e mori Hisham b. Amri nga familja Benu Amir b. Lu'j. Ky dërgonte fshehtazi, edhe natën, ushqim në kampin e përqendrimit. Një natë shkoi te Zuhejre b. Ebi Umejeh El-Mahzumi dhe i tha: *"A je i kënaqur duke ngrënë e duke pirë, ndërsa dajat e tu janë në asi gjendje që e di edhe vetë?"* Ai përgjigjet: *"Vaj halli për ty nëse mendon kështu, por ç'të bëj unë i vetmuar? Sikur të kisha pranë qoftë edhe një njeri të vetëm, do ta thyeja premtimin."* Ky thotë: *"Ta kam gjetur një njeri."* *"Kush është ai?"* *"Unë"*, - përgjigjet Zuhejre, - *"ti gjeje edhe njeriun e tretë."*

Hishami shkoi te Mut'am b. Adijj, i përkujtoi lidhjet farefisnore me benu hashimitët dhe benu el-muttalibët, gjyshi i përbashkët i të cilëve është Abdu Menafi. Pastaj e qortoi për pranimin e tij të kësaj mënyre të keqtrajtimit. Mut'ami pyet: *"Më trego se çfarë të bëj? Unë jam vetëm. Njëri nuk mund të bëjë kurrgjë vetëm."* Hishami i thotë: *"E kam gjetur njërin."* *"Kush është ai?"* *"Unë vetë."* Pastaj Mut'ami thotë: *"Gjeje të tretin!"* Hishami përgjigjet: *"Këtë e kam bërë."* *"E kush është ai?"* *"Zuhejre b. Ebi Umej-je,"* - përgjigjet ky. *"Kërkoje pra edhe të katërtin,"* - thotë Mut'ami.

Hishami shkoi tek Ebu-l-Buhturi b. Hishami. Edhe këtij ia përsëriti të gjitha ato çka i kishte thënë Mut'amt, përkitazi me lidhjet farefisnore dhe padrejtësinë që u ishte bërë. Pastaj Ebu-l-Buhturi e pyeti: *"Po a ke përkrahje?"* *"Po."* *"E kush janë këta?"* *"Zuhejre b. Ebu Umejje, El-Mut'am b. Adijji dhe unë,"* - iu përgjigj Hishami. *"Gjeje edhe të pestin,"* - thotë Ebu-l-Buhturi.

Hishami shkoi te Zum'ah b. el-Esved b. El-Muttalib b. Esedi. Foli me të për familjet e tyre, për obligimet farefisnore dhe për të drejtat e tyre. Pastaj Zum'ati e pyeti: *"A ke bashkëpunëtorë për këtë punë?"* Hishami i përgjigjet pastaj i numëron njerëzit me të cilët kishte biseduar. *"Thirri të gjithë,"* - tha Zum'ati. Më vonë të

⁴⁴ Ebu Talibi ka vdekur gjashtë muaj pas ndërprerjes së kontratës, në muajin rexheb, e jo në ramazan.

gjithë tubohen tek El-Huxhuni dhe merren vesh për ndërprerjen e kontratës. Zuhejre thotë: *“Unë do t’ju përfaqësoj dhe do të flas i pari.”*

Të nesërmen u nisën ku e kishin ndërmend. Me ta vajti edhe Zuhejre i veshur me baldakin (uniformën) e bukur. Ky e kreu tavafin rreth Qabesë, pastaj u kthye nga njerëzit dhe tha: *“O banorë të Mekës! Deri kur do të hamë dhe do të vishemi mirë, ndërsa benu hashimitët janë duke u shkatërruar, as që blejnë e as që shesin diçka? Pasha Allahun, nuk do të ulem derisa ta grisni atë letër të mallkuar!”*

Ebu Xhehli, i cili qëndronte mënjanë mesxhidit, tha: *“Gënjen, për Zotin, nuk do ta grisësh.”* Zum’ah b. El-Esvedi i tha: *“Ti gënjen, për Zotin! Ne as që kemi dashur që ajo kontratë të shkruhet ashtu në letër. Kjo është vepër e jotja.”* Ebu-l-Buhturi briti: *“Zum’ah thotë të vërtetën. Ne nuk kemi dashur që kjo të shkruhet në letër e të nënshkruhet.”* Mu’am b. Adijji tha: *“Ju jeni duke thënë të vërtetën, e kush flet ndryshe, ai gënjen. Kërkoj mbrojtje prej Zotit nga ajo (kontratë) dhe nga përmbajtja e saj.”* Hisham b. Amri foli diçka të ngjashme. Ebu Xhehli tha: *“Për këtë sigurisht jeni marrë vesh mbrëmë në ndonjë vend tjetër.”*

Ebu Talibi gjatë gjithë kohës rrinte ulur në fund të mesxhidit dhe shikonte se ç’po ndodhte. Këtu kishte ardhur sipas porosisë së Resulullahut, sepse Allahu e kishte informuar Resulin për kontratën e shkruar në një copë letër, e cila rrinte varur brenda Qabesë dhe se Allahu kishte dërguar një krimb që ta brente tërë atë që ishte shkruar në letër, përveç emrit të Allahut. Resulullahu e njoftoi për këtë xhaxhanë e vet dhe ky erdhi në mesin e kurejshëve. Pasi Ebu Talibi e dëgjoi tërë bisedën, u ngrit dhe u tregoi atyre se ç’kishte porositur Resulullahu, nipi i tij. Nëse gënjen atëherë veproni ndaj nesh siç keni vepruar gjer më tani, por nëse thotë të vërtetën, ndërpriteni izolimin dhe torturimin ndaj nesh. Kurejshët thanë: *“Ke folur drejt.”*

Pas kësaj, Ebu Xhehli filloi të konsultohet me popullin, kurse El-Mu’am i vajti të sillte copën e letrës - kontratën - për ta grisur. Por mbeti i shastisur kur pa se krimbi e kishte brejtur tërë tekstin përveç fjalëve: *“Në emrin Tënd o Allahu im”* dhe emrin *“Allah”* në vetë tekstin e kontratës.

Pas kësaj u ndërpre izolimi dhe Resulullahu me shoqërinë e tij dolën nga kampi i përqendrimit Esh-Shu’ab. Mushrikët patën një argument të mrekullueshëm për

t'u bindur për pejgamberinë e Resulullahut, por edhe më tutje mbetën të atillë siç i ka thënë Allahu:

“Po, kur shohin ndonjë mrekulli, ata kthejnë kokën e thonë: “Kjo është magji e vazhdueshme!” (El-Kamer: 2)

Ata, me gjithë vërejtjen, nuk e përfillën këtë ajet, por e përforcuan edhe më shumë mosbesimin e tyre.⁴⁵

Mësimet e marra nga këto rrjedha dhe ngjarje

Këto rrëfime gjithsesi se flasin për vuajtjet dhe mundimet që përjetoi Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] bashkë me besimtarët muslimanë përgjatë tri viteve. Pamë se si bijtë e Hashimit dhe Muttalibit u solidarizuan me muslimanët në përballimin e tyre dhe nuk pranuan të hiqnin dorë nga i Dërguari i Allahut.

1. Motivi i përkrahjes së Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] prej Beni Hashimëve dhe Beni Muttalibëve nuk qe për shkak të pejgamberësisë së tij, por për shkak të afërsisë familjare. Këta njerëz preferuan që të mos largohen nga idhujtaria por njëherësh, nga fanatizmi familjar, ta mbrojnë familjarin, i drejtë qoftë apo jo. Pra, ajo që neve na intereson këtu është të kuptojmë se përkrahje dhe mbrojtja e Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*] nga ana e tyre nuk ka qenë pse ai ishte i Dërguar i Allahut, por për shkak se ishte i afërm i tyre.
2. Muslimanët, bashkë me Pejgamberin [*alejhis salatu ves selam*], i përballuan këto sprova për të shprehur gatishmërinë për zbatimin e çdo urdhri të Allahu dhe për favorizimin e ahiretit ndaj dynjasë. Kjo nënkupton se ata që e cilësojnë misionin e tij si një lëvizje të majtistëve (fukarenjve) kundër djathtistëve (të pasurve) e kanë gabim.

Të gjithë ata që janë njoftuar, qoftë edhe kalimthi, me vuajtjet dhe persekutimet që iu janë bërë muslimanëve, e dinë se nuk ka qenë në pyetje

⁴⁵ Ne kemi mbledhur fragmente të ndara nga: *Sahihu-l-Buhari*, kaptina: *vajtja e Resulullahut në Mekë: I/216 dhe kaptina: komploti i mushrikëve kundër Resulullahut: I/548; Zadu-l-Me'ad: II/46 - Ibni Hisham: I/350-351, 374-377; Rahmetun li-l-Alemin: I/69, 70; Muhtesar Siretu-r-Resul nga Nexhdi, f. 106-110; Muhtesar Siretu-r-Resul nga Abdul-Vehhabi, f. 68-73. Ekzistojnë disa mospajttime në këto vepra, por kemi marrë atë që është përafërsisht e njëjtë të të gjithë.*

revolucionin ekonomik dhe as urrejtja ndaj tregtarëve të pamëshirshëm mekas. Kurejshët i ofruan Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*] pasuri, pushtet dhe luks që ta linte misionin, por ky refuzoi. Ndryshe, po t'i kishte këto ambicie, ai nuk do t'i refuzonte ofertat aq serioze të kurejshëve.

Pastaj, Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] dhe shokët e tij u bojkotuan, përjetuan një izolim dhe bllokadë ekonomike. Nuk mund të bënin tregti dhe as të blinin ushqime. Nga varfëria hanin edhe gjethe pemësh. A thua vallë kjo mund të bëhet për shkak të ambicieve për pasuri?!

Po kështu, si dëshmi, mund të merret edhe Hixhreti. Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] dhe shokët e tij, për hir të fesë, lanë pasuritë e tyre në Mekë, gjë që nuk do ta bënin po të ishte vetëm për ambicie materiale.

Nëse muslimanët, për një periudhë relativisht të shkurtër, arritën të çlironin madje edhe Persinë dhe Romën, dhe këtë si reflektim i forcës shpirtërore që kishin, a thua vallë kjo mund të komentohet si ambicie për pushtet dhe pasuri, apo si diç se, pas Islamit të tyre, fshihet dëshira për epshe dhe dëfrim?! Po të ishin të tillë, ata nuk do t'i arrinin kurrë këto fitore historike.

Po të kishin aspirata të tilla, muslimanët do t'i shfaqeshin ndryshe Rustemit, në betejën e Kadisijes. Siç transmetohet, Rebi'j Ibn Amiri kishte shkuar tek Rustemi dhe i kishte thënë: *Nëse pranoni Islamin, iu lëmë në tokat dhe pasurinë tuaj...* A kështu shprehen plaçkitësit dhe të pasionuarit pas pasurisë?!

3. Megjithëkëtë, ata edhe pse nuk vrapuan pas dynjasë dhe kënaqësive të saj, Allahu prapë iu dha të mira të shumta, jo për tjetër, pos për vërtetimin e ligjit hyjnor:

“E Ne duam t'i lartësojmë ata që u shtypën në tokë, t'i bëjmë udhëheqës dhe t'i bëjmë trashëgues.” (el-Kasas, 5)

Ligjërata e njëmbëdhjetë:

MIGRIMI I PARË NË ISLAM

Torturat ndaj muslimanëve kanë filluar në gjysmën ose në fund të vitit të katërt të pejgamberisë. Torturimi, edhe pse i rëndë, ende nuk kishte karakter të përgjithshëm. Në vitin e pestë të pejgamberisë, torturat, dhunimet, nga dita në ditë, nga muaji në muaj, bëheshin më të mëdha dhe më të ashpra⁴⁶.

Kjo zgjati deri në gjysmën e këtij viti, kur muslimanëve u ndalohej banimi në Mekë. Muslimanët këshilloheshin që të gjenin ndonjë mënyrë për të shpëtuar disi nga ky zullum i madh. Në këtë çast vendimtar për muslimanët, Allahu shpalli suren “El-Kehf-Shpella” si përgjigje ndaj mushrikëve në pyetjet që i bënë Resulullahut. Ndërkaq, kjo sure përmban tri rrëfime kur’anore, në të cilat Allahu u ofron muslimanëve këshilla me përmbajtje të pasur dhe të rëndësishme.

⁴⁶ Shih: Nektari i vulosur i Xhennetit, f. 107-113.

Resulullahu ishte njoftuar se Nexhashiu - Negusi, mbreti i Abisinisë, ishte njeri i drejtë dhe se në vendin e tij të gjithë njerëzit trajtoheshin njësoj, pa marrë parasysh racën, përkatësinë kombëtare dhe atë klasore. Askush nuk ishte i nënshtruar në atë vend. Për këtë arsye i urdhëroi muslimanët që të shpërnguleshin në Abisini dhe ta ruanin besimin e vet nga turbullirat.

Në muajin rexheb, të vitit të pestë të pejgamberisë, grupi i parë i as'habëve u shpërngul në Abisini. Grupi përbëhej prej dymbëdhjetë meshkujsh dhe katër grash dhe udhëhiqej nga Uthman b. Affani me bashkëshorten e tij Rukijen, vajzën e Resulullahut. Për këta dy, Pejgamberi ka thënë: *"Këta të dy janë familja e parë që e kanë bërë Hixhretin – shpërnguljen në rrugën e Zotit, pas Ibrahimit dhe Lutit."*⁴⁷

Në rrugë u nisën natën vonë, me qëllim që të mos i shihnin dhe të mos i pengonin kurejshët. Vajtën në bregun e Detit të Kuq dhe nga porti Shu'ajbet, me dy anije tregtare, kaluan detin dhe mbërritën në Abisini. Kurejshët nuk mund të qetësoheshin assesi për këtë mashtrim, andaj u nisën gjurmëve të tyre, por kur arritën në bregun e Detit të Kuq, muslimanët tanimë e kishin kaluar atë. Në Abisini u pranuan si mysafirë të mirëseardhur.⁴⁸

Një ditë, në muajin ramazan të të njëjtit vit, Resulullahu shkoi në Harem të Ka'bes. Aty takoi një grup të madh kurejshësh, të përbërë nga paria dhe zotërinjtë. Ai u ndal para tyre dhe filloi të recitonte suren En-Nexhm. Kjo gjë i befasoi të gjithë ata, sepse gjer atëherë nuk i kishin dëgjuar kurrë fjalët e Allahut. Mënyra e tyre e të folurit ka qenë e përditshme, komunikimi reciprok dhe këshillimi bëhej me fjalët:

Mos e dëgjoni këtë Kur'an, por flisni me zë të lartë për ta mundur atë! (Fussilet: 26)

Pasi recitimi melodik i kësaj sureje dhe fjala e Allahut me domethënie madhështore i befasoi shqisat e dëgjimit të tyre, ata harruan plotësisht se në çfarë shtate gjendeshin. Të gjithë ishin kthyer nga Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] dhe e dëgjonin me vëmendje. Mendja e tyre ishte e përqendruar tërësisht në atë që

⁴⁷ Muhtesar Siretu-r-Resul nga Abdullah b. En-Nexhdi, f. 92, 93; Zadu-l-Me'ad: 1/24; Rahmetun li-l-Alemin: 1/61.

⁴⁸ Rahmetun li-l-Alemin: 1/61; Zadu-l-Miad: 1/24.

dëgjonin, gjersa Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] erdhi në fund të sures me fjalët që i hapin zemrat:

“Pra, bëni sexhde për Allahun dhe adhuroni (Atë)!” (En-Nexhm: 62).

Pastaj bëri sexhde.

Gjatë tërë kohës askush nuk luajti nga vendi. Në realitet, bukuria e së vërtetës e kishte zbutur inatin në shpirtat e përqeshësve kryelartë, prandaj nuk mundën të rezistonin, por edhe ata i bënë sexhde Allahut.⁴⁹ Kur kuptuan se madhështia e fjalës së Allahut bëri që zotëri i lëku dhe paria e tyre të binin me fytyrë përtokë, ata u penduan. Me këtë gjest do t’u shkonte huq i tërë mundi që kishin bërë gjatë një viti e gjysmë, andaj i kaploi frika nga njerëzit që e kishin parë këtë, por edhe prej atyre që do ta dëgjonin.

Kritikat filluan të arrinin nga të gjitha anët. Ata nuk mund të dilnin para bashkëmendimtarëve të vet përveçse me gënjeshtër të reja. Gënjen përsëri, por kësaj radhe në një mënyrë tjetër. Gënjen se Resulullahu ishte i mëshirshëm ndaj zotave të tyre dhe se i ka lavdëruar ata duke thënë:

“Ata janë zota të mëdhenj dhe duhet të shpresohet në shefatin e tyre” (ndërmjetësimi për njerëzit në Ditën e Gjykimit). Ata thanë një gënjeshtër të madhe për Resulullahun, në mënyrë që të justifikoheshin për sexhden që i bënë Allahut e që e kishin bërë së bashku me Resulullahun. Jo, kjo assesi nuk është për t’u çuditur, sepse kjo pritet prej një populli i cili është autor i të gjitha gënjeshtërave.⁵⁰

Lajmi për këtë ngjarje arriti te muhaxhirët në Abisini, por me një petk krejt tjetër nga ajo e vërteta. Ata kujtuan se kurejshët e kanë pranuar Islamin, andaj u përgatitën për kthim dhe në muajin shevval të po atij viti u nisën për në Mekë. Një orë larg Mekës e kuptuan të vërtetën e kësaj ngjarjeje, andaj disa prej tyre përsëri u kthyen në Abisini, e të tjerët hynë në Mekë fshehtazi, apo nën mbrojtjen e dikujt.⁵¹

⁴⁹ Për këtë tregon Buhariu në kapitullin mbi sexhden në një version pak më të shkurtër nga Ibni Mes’udi dhe Ibni Abbasi. Të shikohet kaptina “Sexhdetu-n-Nexhm”, kaptina “Sexhda e muslimanëve dhe mushrikëve”: I/146 dhe kaptina “Çka ka përjetuar Pejgamberi dhe muslimanët nga mushrikët”: I/543.

⁵⁰ Tefhimu-l-Kur’ani: V/188.

⁵¹ Tefhimu-l-Kur’ani: V/188; Zadu-l-Miad: I/24, II/44; Hishami: I/364.

Numri i muslimanëve rritej gradualisht, por gjithashtu rriteshin edhe trysnitë e kurejshëve. Këtyre u erdhi shumë rëndë kur dëgjuan se Nexhashiu i kishte marrë muslimanët nën mbrojtjen e vet. Pezmi rritej në zemrat e tyre gjithnjë e më tepër, prandaj Resulullahu nuk pati tjetër zgjidhje, por u propozoi shokëve të vet që muslimanët e porsa transformuar të shkonin në Abisini.

Hixhreti i dytë ka qenë shumë më i vështirë sesa ai i pari. Tani kurejshët ishin shumë më të kujdesshëm, prandaj vendosën t'i pengonin muslimanët, por muslimanët përsëri qenë më të shpejtë se ata. Allahu ua lehtësoi rrugën dhe kaluan në Abisini, në vendin e mbretit Nexhashi, para se t'i arrinin kurejshët. Kësaj radhe u shpërngulën 83 meshkuj dhe 18 ose 19 gra,⁵² nëse me ta ka qenë Amri, sepse kjo nuk dihet saktësisht, ndërsa numrin e parë e ka pranuar dijetari i madh Muhammed Sulejman El-Mensur Fevri.⁵³

Komploti i kurejshëve kundër emigrantëve në Abisini

Kurejshëve u erdhi shumë rëndë që muhaxhirët gjetën strehim të sigurt për vete dhe për fenë e tyre. Për këtë arsye zgjodhën dy njerëz të aftë dhe mendjemprehtë, të cilët i dërguan pas tyre. Këta ishin Amër b. El-Asi dhe Abdullah b. Ebi Rebia. Me ta i dërguan shumë dhurata të vlefshme Nexhashiut dhe patrikëve të tij. Pasi ua dorëzuan këto dhurata, ata u treguan patrikëve se muhaxhirët janë mbartës të një feje të re, e cila nesër mund të rrezikonte edhe vetë Abisininë. Patrikët vendosën të shkojnë te Nexhashiu e të kërkojnë nga ai dorëzimin e muhaxhirëve këtyre të dyve. Por këta të fundit arritën te Nexhashiu para patrikëve dhe i thanë:

“O sundimtar, në atdheun tënd ka ardhur një grup të rinjsh, të cilët e braktisën fenë e popullit të vet, por nuk pranuan as fenë tënde. Erdhën me një fe të re, të cilën nuk e njohim as ne, e as ti. Ne na dërguan magnatët tanë dhe të tyre, mes të cilëve janë baballarët, xhaxhallarët dhe të afërmit e tyre, që të na i dorëzosh e t'ua dërgojmë, sepse ata e njohin më mirë marrëzinë e tyre për çka edhe i kanë qortuar.”

Patrikët, tanimë kishin arritur te Nexhashiu dhe dëgjuan fjalimin e këtyre dyve, dhe klithën: *“Të vërtetën flasin, o mbreti ynë, dorëzojua këtyre të dyve e le t'ua kthejnë popullit të vet në vendin e vet.”*

⁵² *Zadu-l-Me'ad: 1/24; Rahmetun li-l-Alemin: 1/61.*

⁵³ *Rahmetun li-l-Alemin: 1/61.*

Por, Nexhashiu ishte më i mençur sesa mendonin ata. Ai e konsideroi të domosdoshme të dëgjonte edhe palën tjetër, kështu që situata të ishte krejtësisht e qartë. Andaj i thirri muslimanët që të dilnin para tij. Ata erdhën. Nexhashiu i pyeti: *“Për çfarë feje e braktisët popullin tuaj, vatrën tuaj dhe të afërmit tuaj? Me sa di unë, as fenë time – Krishterimin nuk e pranuat, e as fenë e ndonjë populli tjetër.”*

Xha'fer b. Ebu Talibi doli para muslimanëve, e tha: *“O sundimtar, i takonim një populli që jetonte në injorancë dhe në lajthitje. Adhuronim idhujt, hanim mishin e kafshëve të ngordhura, bënim gjëra të ndaluara, i shqetësonim fqinjët. Më i fuqishmi prej nesh shtypte më të dobëtin. Ja, kështu jetonim, derisa Allahu na dërgoi Pejgamberin. Ai është nga populli ynë dhe ia dimë brezin dhe origjinën. E dimë se është i sinqertë, besnik dhe i drejtë. Ai na ftoi që t'i besojmë vetëm një Zoti dhe që vetëm Atij t'i nënshtrohemi. Na mësoi që të braktisim besëtytninë që manifestonim ne dhe etërit tanë, si dhe besimin në shumë idhuj. Na udhëzoi të flasim vetëm të vërtetën, të jemi njerëz besnikë dhe ta mbajmë fjalën, t'i respektojmë dhe t'i vizitojmë të afërmit tanë, të sillemi mirë me fqinjët. Na urdhëroi që t'i ndërpresim veprat e këqija, të mos gënjejmë, të mos shpenzojmë pasurinë e bonjakut, që të mos bëjmë shpifje dhe mos t'i përgojmë gratë e ndershme. Na urdhëroi që t'i bindemi vetëm Allahut, Një të Vetmit, që të mos bëjmë shirk - të mos i bëjmë Atij shok në adhurim. Na urdhëroi të bëjmë namaz, të japim zekat (një pjesë nga pasuria) dhe të agjërojmë Ramazanin.”*

Xha'feri ia numëroi bazat kryesore të Islamit dhe vazhdoi: *“Të gjitha këto ne i pranuan nga ai si urdhra, sepse i besuam fjalëve të tij, prandaj besuam edhe në pejgamberinë e tij dhe filluam t'i ndjekim mësimet e tij. U bëmë muslimanë dhe filluam të rrëfejme Islamin. Ne besojmë vetëm Allahun, nuk i bëjmë shok Atij, e ndalojmë atë që është e ndaluar për ne dhe e lejojmë atë që është e lejuar për ne. Ja pra, për këtë shkak na urren populli ynë, për këtë shkak na torturojnë dhe na dhunojnë për të braktisur fenë tonë, e për t'iu kthyer statujave dhe idhujve, që përsëri të veprojmë ashtu siç vepronim para pranimit të Islamit. Prandaj, për shkak të torturave të mëdha që ushtronin mbi ne, ishim të detyruar të vinim në vendin tënd.”*

Të zgjodhëm ty nikoqir nga gjithë mbretërit e vendeve të tjera. E dëshiroam mbrojtjen tënde, sepse kemi dëgjuar se në vendin tënd askush nuk ka qenë i keqtrajtuar.”

Nexhashiu e pyeti Xha'ferin: *“A ke diçka me vete nga Shpallja e Allahut?”* Xha'feri u përgjigj: *“Po.”* *“Atëherë ma lexo atë,”* - tha Nexhashiu.

Xha'feri u ngrit dhe recitoi fillimin e sures Merjem - **"Kaf, Ha, Ja, A'jn, Sad."** Nexhashiu qau, pasha Allahun! Qau dhe e tërë mjekra iu lag nga lotët. Qanë edhe patrikët dhe nga lotët e tyre u lagën Biblat që i mbanin gjithnjë të hapura para vetes. Sa fjalë të bukura ishin ato!

Pastaj Nexhashiu tha: *"Këtë që dëgjova dhe fjalët që i janë shpallur Isait, vijnë nga i njëjti "burim". Shkoni, jeni të lirë! Unë, për Zotin tim, nuk do t'ua dorëzoj këtyre të dyve - dhe u kthye nga Amri dhe Abdullahu - dhe mos të shpresojnë se do ta bëj këtë!"* Që të dy dolën jashtë të turpëruar, e Amri i tha shokut të vet: *"Për Zotin, nesër do të vijmë përsëri dhe unë do t'ua gjej dermanin te Nexhashiu për kokën e tyre."* Abdullahu tha: *"Mos e bëj këtë, ata i kanë të afërmit dhe farefisën e tyre. Edhe pse na kanë braktisur dhe kanë pranuar fe tjetër nga ajo jona, megjithatë ata janë tanët."* Por Amri ishte i vendosur. Të nesërmen që të dy vajtën te Nexhashiu, ndërsa Amri filloi të fliste: *"O mbret, ti i amnistove ata njerëz, por sikur ta dije se ç'thotë feja e tyre për Isanë!?"* Nexhashiu i thirri muslimanët dhe ua parashtrroi pyetjen për Isanë. Ata u befaskan, por, pasi kishin vendosur të flisnin të vërtetën pa marrë parasysh se për cilën krijesë është fjala, Xha'feri u përgjigj: *"Për Isanë dimë vetëm atë që kemi dëgjuar nga Pejgamberi ynë. Isai është rob dhe i Dërguari i Zotit. Ai është i biri i Merjemes (virgjëreshës së pastër, e cila me urdhrin e Allahut: "Bëhu!, ajo bëhet" ka lindur djalë), ai është fryma e Zotit dhe Fjala e Tij që ia ka dorëzuar Merjemes, virgjëreshës."*

Nexhashiu tha: *"Për Zotin tim, kjo që thatë për Isanë, ua shpëtoi jetën."* Pastaj tregoi shkopin e shtruar mes tij dhe muslimanëve, e tha:

"Neve na ndan aq sa është kjo vijë e shkopit."

Pastaj u tha muslimanëve: *"Shkoni, ju jeni të sigurt në shtetin tim. Kushdo që ju sulmon, do të ndëshkohet! As për një kodër ari nuk do të lejoja t'ju ndodhte ndonjë e keqe."* Mandej u kthye nga shtetasit e vet dhe tha, duke treguar me gisht nga Amri dhe Abdullahu: *"E këtyre këtu, ua ktheni të gjitha dhuratat që kanë sjellë. Mua nuk më duhen, për Zotin tim! Me ryshfet nuk e kam fituar këtë fron, e lëre më që me anë të ryshfetit t'i dorëzoj këta muslimanë. Derisa të kem popullin e dëgjueshëm dhe unë të jem mbret i dëgjueshëm që ndaj drejtësinë, këta janë të qetë."*

Ummu Selemja, e cila rrëfente këtë ngjarje, tha:

“Të dy kurejshët dolën nga Nexhashiu kokulur dhe pa e mbaruar punën për të cilën kishin ardhur. Ndërsa ne mbetëm në paqe, në shtëpi të mirë, te nikoqiri i mirë.”⁵⁴

Ky është versioni i Ibni Is’hakut.

Autorët e tjerë të sires thonë se dërgimi i Amrit te Nexhashiu është bërë pas Bedrit, e disa thonë se Amri ka qenë dy herë te Nexhashiu.⁵⁵ Mirëpo, pyetjet dhe përgjigjet që janë cekur gjatë bisedës së Nexhashiut dhe Xha’ferit në vizitën e dytë, janë gati të njëjta siç i ka paraqitur Ibni Is’haku, ndërsa pyetjet vërtetojnë se dialogu është bërë gjatë vizitës së parë. Komploti që përgatiti paria e Mekës pësoi disfatë. Plani u dështoi, prandaj e ndienin veten të ofenduar e të poshtëruar. Kuptuan se nuk ishin në gjendje t’i realizonin qëllimet e veta brutale, përveçse në suazat e pushtetit të tyre. Prandaj, në kokat e tyre lindi një ide e tmerrshme. Duke parë se nuk mund t’ia dilnin në krye, mënyra e vetme ishte që t’ia ndalonin Resulullahut përfundimisht veprimtarinë e mëtejshme në përhapjen e Islamit, nëse jo ndryshe, atëherë me shkatërrimin e plotë.

Mësimet e marra nga ky migrim

Migrimi i besimtarëve në Etiopi bart tri domethënie të rëndësishme:

1. Domethënia e parë:

- 1) Mbajtja e fesë është burim force dhe fuqie. Këtu qëndron edhe ruajtja e çdo të drejte të njeriut dhe kjo, patjetër, se thërret për mobilizim të përgjithshëm të misionarëve muslimanë për ta ruajtur këtë fe, qoftë kostoja e kësaj edhe internimi nga vendi, humbja e pasurisë dhe e vetë jetës. Kjo, për shkak se humbja e fesë paraqet rrezikun më të madh. Ndërsa, nëse feja e udhëheq shoqërinë, atëherë çdo humbje kompensohet...
- 2) Është ligj i Zotit përgjatë gjithë historisë se arsenali moral e ruan edhe atë material, kështu nëse ummeti është i fortë në moralin, besimin dhe sistemin shoqëror, atëherë edhe forca e tij materiale do të jetë më e konsoliduar dhe më e qëndrueshme. Ndryshe, dobësimi në aspektin moral është shenjë paralajmëruese edhe për shkatërrimin e fuqisë materiale.

⁵⁴ *Ibni Hisham - përmbledhtas: I/334-338.*

⁵⁵ *Muhtesar Siretu-r-Resul nga En-Nexhdi, f. 96-98. Në këto faqe gjenden gjerësisht pyetjet dhe përgjigjet e shkruara më sipër.*

Fakti se disa shtete, si Amerika dhe Evropa, me gjithë dështimet në aspektin moral, janë ende të fuqishme, nuk e zhvleftëson teorinë tonë. Gjendja e tyre e tanishme mbase është fillimi i fundit të tyre. Shkaku përse ne nuk mund ta vërejmë qartë këtë qëndron në atë se jeta jonë përballë jetës së historisë është shumë e shkurtër, ndërsa këto përfundime të mëdha vetëm syri i historisë mund t'i vërejë.

Në anën tjetër, mund të hasësh njerëz të varfër materialisht, por të pasur me besim të pastër, me moral të lartë, me dinjitet. Ata janë paralajmërimi i së ardhmes së ndritur të tyre. Vendi i tyre i pushtuar dhe pasuria e tyre e grabitur do t'iu kthehen shumë shpejt.

Këta njerëz sigurisht se janë muslimanët, ata që kanë besimin më të pastër dhe sistemin shoqëror më të drejtë...

- 3) Pikërisht për këto gjëra, që janë ideale të muslimanëve, ata sakrifikojnë pasuritë e tyre, e për këtë gjë po kështu është ligjësuar edhe migrimi.
- 4) Migrimi është një formë tjetër e persekutimit për shkak të besimit. Ai nuk nënkupton shpëtimin nga të ligat, por ndërrimin e sprovave, derisa të vijë zgjidhja përfundimtare prej Allahut të Madhëruar.
- 5) Meka e asaj kohe nuk ishte vatër islame, që të mos mendohet gabimisht se sahabët kanë braktisur vendin islam; atëbotë Meka dhe Habeshi (Etiopia) ishin të njëjta.
- 6) Sa i përket dispozitës së migrimit, ajo është ndërmjet lejimit, ndalimit dhe obligimit. Ai obligohet atëherë kur besimtari nuk mund t'i kryejë ritet fetare, si: namazi, agjërimi, haxhi, ezani etj. Lejimi bëhet kur besimtarin e godet ndonjë sprovë, që ia bën të vështirë qëndrimin, kështu që atij i lejohet të migrojë në vende të tjera islame, apo edhe joislame, me kusht që të ketë liri të plotë fetare. Ndërsa ndalohet kur migrimi do të kishte si pasojë braktisjen e ndonjë prej obligimeve fetare⁵⁶.

2. Domethënia e dytë:

- 1) Domethënia e dytë konsiston në të vërtetën përkitazi në lidhjet ndërmjet Isait dhe Muhammedit [*alejhimas selam*]. Negusi ishte ithtar i Krishterimit, fe së cilës i përmbahej me sinqeritet. Ai i kishte vënë vetes obligim që të

⁵⁶ Për më shumë rreth dispozitave të migrimit, referoju Tefsirit të Imam Kurtubiut (5/35) dhe atij të Ibnu-l-Arabiut (2/887).

mos e ndihmonte askënd që nuk ndante besimin e njëjtë me të. E, sikur triniteti të ishte pjesë e Krishterimit, sigurisht se Negusi do ta mbante atë, për shkak të sinqeritetit të madh që kishte në zbatimin e urdhëresave fetare, por, mos mohimi i fjalëve të besimtarëve muslimanë dëshmon se ai nuk e besonte një gjë të tillë.

- 2) Kemi lexuar se Negusi, kur kishte dëgjuar fjalët e Kur'anit, kishte thënë se këto fjalë dhe ato që i janë shpallur Isait [*alejhis salatu ves selam*] vijnë nga i njëjti burim. Këto fjalë i tha në praninë e priftërinjve të tij dhe dijetarëve të tjerë të krishterë.
- 3) Kjo provon se pejgamberët [*alejhimus selam*], që të gjithë, kanë proklamuar të njëjtin besim, pa dalluar nga njëri-tjetri as sa qimja e flokut. Kjo është dëshmi edhe për atë se polemikat dhe kundërthëniet ndërmjet ithtarëve të librit janë pasi që atyre iu erdhi e vërteta – ashtu siç thotë Allahu⁵⁷.

3. Domethënia e tretë

- 1) Në rast nevoje, lejohet hyrja e besimtarëve nën protektoratin e jomuslimanëve, pavarësisht se a janë këta jomuslimanë ithtarë të librit, siç ishte Negusi, apo idhujtarë, si ishin ata në Mekë, nën mbrojtjen e të cilëve hynë besimtarët pas kthimit nga Etiopia. Pejgamberin [*alejhis salatu ves selam*] e kishin marrë idhujtarët nën mbrojtje: xhaxhai i tij, Ebu Talibi dhe Mu'im Ibn Adijji, pas kthimit nga Taifi.
- 2) Kjo mbrojtje assesi nuk guxon të jetë shkas për dëmtimin e thirrjes islame, apo për ndërrimin e ndonjë parimi fetar. Argument për këtë marrim vetë rastin e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], i cili pasi pa se xhaxhai i tij, Ebu Talibi, po kërkonte të mos i përmendte idhujt për të keq, vendosi të dalë nga mbrojtja e tij, duke refuzuar që të heshtë ndaj të drejtave apo ndaj atyre që duhen sqaruar dhe shpjeguar...⁵⁸

⁵⁷ P.sh. në el-Bekare: 253. Përkthyesi.

⁵⁸ Për më shumë shih: Buti, Muhammed Seid Ramadan, Fikhus Sire, f. 91-94.

Ligjërata e dymbëdhjetë:

DELEGACIONI I PARË TE PEJGAMBERI [ALEJHIS SALATU VES SELAM]

Në kohën kur Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] dhe shokët e tij po përjetonin tmerrin në Mekë, një delegacion nga jashtë Mekës erdhi për të mësuar diç për fenë e tyre. Ishin pak më shumë se 30 burra, të krishterë nga Etiopia, të cilët erdhën me Xhaferin kur ky u kthye në Mekë. Kur u takuan me Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*], dëgjuan fjalët e Kur'anit dhe panë virtytet dhe tiparet e tij, që të gjithë e pranuan Islamin. Kjo gjë nuk e gëzoi Ebu Xhehlin, kështu që shkoi tek ata dhe iu tha: 'Nuk kam parë delegacion më mendjelehtë se ju. Populli juaj iu dërgoi të mësoni për këtë njeri, ndërsa ju me të qëndruar një herë me të, i besuat atij dhe e braktisët fenë tuaj.' Ata iu përgjigjën: '*Paqja qoftë mbi ju! Nuk po*

iu injorojmë, por ne kemi këtë në të cilën jemi dhe ju keni atë në të cilën jeni. Ne nuk e privojmë veten nga mirësia!

Mësimet, domethëniet dhe këshillat

1. Rasti i këtij delegacioni duhet të zgjojë interesimin tonë për dy gjëra:
 - a. Ardhja e tij që në kohën kur muslimanët përjetonin tmerrin dhe dhunën e paraparë të kurejshëve ndaj tyre. Kjo rastësi, kuptohet jo e paqëllimshme, është mësim për të gjithë thirrësit se vuajtjet dhe mundimet e tyre në rrugën e lartësimit të Fjalës së Allahut nuk nënkuptojnë dështimin dhe shuarjen dhe, rrjedhimisht, ata nuk duhet të nënshtrohen, dorëzohen apo të heqin dorë nga thirrja dhe misioni i tyre. Ndëshkimi është rrugë që duhet përshkuar patjetër për të ardhur tek fitorja...
 - b. Ky delegacion përbëhej nga 30 ose 40 burra të krishterë, të cilët kishin ardhur nga ana tjetër e detit, vetëm e vetëm që të njiheshin me fenë e re. Kjo, nënkupton se armiqtë e Islamit le ta bllokojnë sa të duan atë, ngase kurrë nuk do t'ia dalin që ta shkulim me rrënjë apo të privojnë të tjerët prej mirësive të saj. Ata nuk do të mund ta ndalin kurrë përhapjen dhe shtirjen e saj ankand botës. Ebu Xhehli e dinte këtë, dhe këtu qëndron sekreti pse ai i tha ato fjalë urrejtjeje dhe zilie...
2. Çfarë besimi morën këta pjesëtarë të delegacionit? A është besimi që i nxjerr nga errësira në dritë, apo çfarë? Realisht, besimi i tyre ka qenë vazhdimësi e besimit paraprak. Sipas historianëve, ata i përmbaheshin strikt udhëzimeve të Inxhilit, i cili i urdhëronte ta pasonin pejgamberin që do të vinte pas Isait [*alejhis salatu ves selam*]. Inxhili fliste dhe e përshkruante pejgamberin e ri pas Isait [*alejhis salatu ves selam*], kështu që nuk ka qenë e vështirë për ta pranimiti i kësaj feje. Apo thënë më mirë, besimi i tyre i pastër ka paraparë besimin dhe pasimin e Pejgamberit Muhammed [*alejhis salatu ves selam*].
3. Besimi i tyre nuk ka qenë kalim nga një fe në tjetrën, për shkak të favorizimit të kësaj të dytës ndaj të parës, por ka qenë vazhdimësia e besimit tek Isai [*alejhis salatu ves selam*]. Kjo është edhe domethënia e ajetit:
"Dhe kur u lexohet atyre, thonë: "Ne i kemi besuar atij, ajo është e vërtetë prej Zotit tonë, ne edhe para tij kemi qenë muslimanë!" (el-Kasas: 53)

Pra, ishim muslimanë dhe besonim në këtë që po predikon Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] qysh para dërgimit të tij, ngase kjo, në fakt, është ajo në të cilën thërret edhe Inxhili.

4. Kështu është puna me të gjithë besimtarët e sinqertë të Musait dhe Isait [*alejhimas selam*], ngase besimi në Teurat dhe në Inxhil nënkupton dhe thërret edhe për besimin tek Kur'ani dhe Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*].
5. Mu për këtë, Allahu e urdhëroi Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] që të ftonte çifutët dhe të krishterët në Islam duke kërkuar prej tyre që ta praktikonin vetëm atë që kishin në librat e tyre:
"Thuaj: "O ithtarë të librit, ju nuk jeni asgjë (në fe) derisa të mos zbatoni Teoratin, Inxhilin dhe atë që ju zbriti nga Zoti i juaj. E kjo që t'u zbrit ty nga Zoti yt do të shtojë te shumica prej tyre rezistencë e mohim. Po ti mos u keqëso për popullin që nuk beson." (el-Maide: 68)
6. Kjo nënkupton edhe vërtetimin e asaj që e kemi potencuar shumë herë se feja e vërtetë është një, që nga Ademi [*alejhis salatu ves selam*] e deri tek pejgamberi i fundit, Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*]. Kjo nënkupton, po kështu, se shprehja apo terminologjia (në shumës) 'fe qiellore' nuk ka kuptim.
7. Është e vërtetë se ka pasur legjislacione (sheriate) qiellore të mëhershme, sikurse që është e vërtetë se çdo legjislacion është anuluar nga legjislacioni vijues, por ajo që ne synojmë këtu është të mos krijohet një paqartësi rreth termave 'fe' (ar. din), që nënkupton besimin dhe 'legjislacion' (ar. shariat), që nënkupton dispozitat që kanë të bëjnë me dhurimet, moralin etj.

Ligjërata e trembëdhjetë:

VITI I DËSHPËRIMIT

Në vitin e dhjetë të pejgamberisë kaloi në amshim gruaja e Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*], Hatixheja [*Allahu qoftë i kënaqur me të*]. Po kështu, në këtë vit, një muaj e pesë ditë pas vdekjes së Hatixhes, - siç nënvizon Ibni Sa'di në Tabekatet e tij, - vdiq edhe xhaxhai i tij, Ebu Talibi.

Hatixheja [*Allahu qoftë i kënaqur me të*], siç shënon Ibni Hishami, ishte ministre e së vërtetës (vezire sidkin), këshilltare e së mirës. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ankohej tek ajo, ndërsa ajo i ofronte shoqëri dhe mirësi. Ndërsa Ebu Talibi ishte mbështetësi dhe mbrojtësi i tij tek populli. Ibni Hishami thotë: Kur vdiq Ebu Talibi, kurejshët e torturuan Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] me gjëra që sa ishte gjallë ai as që guxonin t'i bënin. Një kurejsh mendjelehtë i hodhi dhé në kokë Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]. Ai shkoi në shtëpi i pluhurosur, ndërsa njëra nga vajzat e tij u ngrit dhe ia shkundi atë duke qarë. Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] e qetësonte atë duke i thënë: “Mos qaj oj bija ime, se Allahu ka për ta mbrojtur babanë tënd!”

Për shkak të vështirësive me të cilat u ballafaqua këtë vit, Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] e quajti atë ‘Viti i Dëshpërimit!’

Mësimet, këshillat dhe urtësitë

Ç'urtësi mund të ketë përshpejtimi i caktimit të Zotit për vdekjen e Ebu Talibit para se muslimanët të fuqizoheshin në Mekë, kur dihet se ai e mbronte Muhammedin [*alejhis salatu ves selam*] nga të ligat e kurejshëve?

Ç'urtësi fshihet në vdekjen e Hatixhes [*Allahu qoftë i kënaqur me të*], kur dihet se Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] gjente prehje tek ajo?

Përgjigjen e këtyre pyetjeve do të mundohemi ta japim në pikat në vijim:

1. Sikur Ebu Talibi të ishte gjallë derisa të themelohej shteti islam në Medinë, do të mund të kuptohej sikur pas kësaj qëndronte vetë ai, dhe se ai, edhe pse nuk e kishte deklaruar besimin, ishte protagonist i kësaj feje.
2. Në të gjallë të Ebu Talibit, Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] ishte i sigurt, por jo edhe të tjerët, ndërsa me vdekjen e tij dhe të Hatixhes [*Allahu qoftë i kënaqur me të*], u zbardhën dy gjëra të rëndësishme të Islamit:
 - a. Mbrojtja dhe siguria janë prej Allahut të madhëruar. Ai e ka marrë në mbrojtje të Dërguarin e Tij dhe, pavarësisht se ka njerëz që e mbrojnë apo jo, ai do të jetë i sigurt nga të këqijat e idhujtarëve dhe se feja e tij do të korrë suksese.
 - b. Mbrojtja dhe ruajtja nga ana e Allahut⁵⁹ nuk nënkuptojnë edhe mbrojtjen nga shqetësimet, torturat dhe persekutimet. Ato kanë kuptimin se nuk do t'i rrezikohej jeta, se nuk do të vritej, se nuk do të vdiste nga të këqijat e tyre dhe se ata nuk do të mund ta ndalnin fenë e tij, sado shumë që të përpiqeshin për një gjë të tillë. Ka qenë caktim dhe urtësi e Allahut që shumë pejgamberë të sprovohen dhe të përjetojnë dhunë dhe terror të madh të ushtruar ndaj tyre, dhe kjo prapë nuk bie ndesh me mbrojtjen e Allahut. Allahu Fuqiplotë iu drejtua Muhammedit [*alejhis salatu ves selam*]:
Të cilët All-llahut i kundërvënë zot tjetër, e më vonë ata do ta kuptojnë (prapavijën e tyre). 97. Ne dimë mirë se ti ngushtohesh shpirtërisht për atë që thonë ata. 98. Po ti madhëroje me falënderime Zotin tënd e bëhu prej atyre që luten (përulen duke u falur)." (el-Hixhr: 96-98)
3. Përjetimi i këtyre sprovave nga Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] është që edhe thirrësit pas tij të mësojnë se si duhet t'i përballojnë vështirësitë.

⁵⁹ Shih: El-Maide: 67.

Pra, për të qenë shembull për ta edhe në këtë aspekt. Sikur Muhammedit [alejhis salatu ves selam] mos t'i ndodhte gjë, atëherë edhe thirrësit pas tij do të shpresonin një jetë dhe mision të tillë pa sprova dhe vështirësi.

4. Këto ndjenja ua lehtësojnë muslimanëve rrugën e tyre fetare, për shkak se ata mund të vuajnë ashtu siç vuajti krijesa më e zgjedhur, mund të torturohen ashtu siç u torturua Muhammedi [alejhis salatu ves selam]... Sado që të nënçmohen a të përqeshen, ata prapë e dinë se Muhammedit [alejhis salatu ves selam] iu hodh rërë në fytyrë. Një mbështetje shpirtërore për këtë mund ta marrin edhe nga udhëtimi i Muhammedit [alejhis salatu ves selam] në Taif, siç do ta sqarojmë në ligjëratën vijuese.
5. Disa e marrin vitin e dëshpërimit, në kuptimin sipërfaqësor, si vitin në të cilin Muhammedit [alejhis salatu ves selam] i vdiqën xhaxhai dhe gruaja, duke arsyetuar kështu mbajtjen e zisë për të vdekurit e tyre për një kohë të gjatë. Ky mbase është një keqkuptim i madh, ngase viti i dëshpërimit nuk ka këtë kuptim. Përkundrazi, ai nënkupton:
 - a. Arsyeja pse Muhammedi [alejhis salatu ves selam] e quajti atë si vit të dëshpërimit nuk është thjesht për vdekjen e xhaxhait dhe të gruas, por për shkak se daves apo misionit të tij iu mbyllën shumë rrugë. Siç e dini, xhaxhai i tij ishte shkak për hapjen e shumë rrugëve dhe mundësive për përhapjen e fesë së Allahut, gjëra këto që me vdekjen e tij morën fund. Për shkak se njerëzit nuk e besonin atë dhe nuk i përgjigjeshin ftesës së Allahut, Muhammedi [alejhis salatu ves selam] ndihej shumë keq dhe për këtë edhe e quajti atë vit si vit dëshpërimi. Konsideroj - e Zoti e di më së miri - se duke u nisur nga natyra njerëzore e Muhammedit [alejhis salatu ves selam], ai, krahas këtij fakti, mërzitej edhe për vdekjen e xhaxhait dhe gruas së tij. Muhammedi [alejhis salatu ves selam] ishte njeri si të gjithë ne.
 - b. Ajetet në vijim zbardhin për ne këtë të vërtetë historike:

Ne dimë se ty të brengos ajo që thonë, e ata nuk të gënjejnë ty, por ata mizorë mohojnë argumentet e All-llahut. 34. Janë përgënjeshtuar të dërguar para teje, duruan atë gënjeshtër dhe u torturuan përderisa u erdhi ndihma Jonë, prandaj s'ka kush që ndryshon fjalët (premtimet) e All-llahut. E ti je i njohur me disa nga ngjarjet e të dërguarve (edhe ti do të ndihmohesh sikurse ata). 35. Por, nëse refuzimi i tyre të është bërë brengë e madhe, ti kërkoje, nëse ke

mundësi, ndonjë vrimë në tokë ose shkallë në qiell e t'u sjellësh atyre ndonjë argument (po ti s'mund ta bësh këtë). Të kishte dashur All-llahu i kishte tubuar në rrugë të drejtë; po ti mos u bën nga të padijshmit (dhe mos u brengos).” (el-En'amë: 33-35)

Ligjërata e katërmbëdhjetë:

MIGRIMI I MUHAMMEDIT [ALEJHIS SALATU VES SELAM] NË TAIF

Në muajin shevval⁶⁰ të vitit të dhjetë të pejgamberisë, Resulullahu doli nga Meka dhe vajti në Taif⁶¹. Taifi është qytet afro gjashtë-dhjetë milje larg Mekës. Këtë distancë Resulullahu e kaloi në këmbë. Së bashku me të u nis edhe robi i tij i liruar, Zejd b. El-Harithi. Gjatë rrugës, Resulullahu i thërriste në Islam fiset që haste. Por asnjë fis nuk iu përgjigj thirrjes së tij. Kur arriti në Taif, takoi tre djemtë e prijësit të fisit Thekaf. Këta ishin: Abdu Jalijel, Mes'udi dhe Hubejbi, djemtë e Amër b. Umejr Es-Thekafit. Resulullahu u ul me ta dhe i thirri në Islam, i thirri që t'i besonin Allahut dhe t'i ndihmonin fesë së Tij. Njëri prej tyre tha: *"Unë do ta shkëlqoj mbulojën e Ka'bes, po që se me të vërtetë të ka dërguar Allahu."* I dyti tha: *"A thua Allahu nuk pati tjetërkënd përveç teje?"* E i treti tha: *"Për Zotin, kjo është hera e parë dhe e fundit që jam duke folur me ty. Nëse ti vërtet je Pejgamber, atëherë mua nuk më ka hije të flas me ty, e nëse nuk je, ti gënjen për Zotin, atëherë as që duhet të flas me ty."* Resulullahu u ngrit dhe tha: *"Ju thatë çka patët për të thënë, por mos i tregoni askujt për mua."*

⁶⁰ Mendimi i Nexhib Abadit në veprën "Historia Islamit": I/122, e që edhe unë e kam pranuar.

⁶¹ Shih: Nektari i vulosur i Xhennetit, f. 147-152.

Resulullahu qëndroi në Taif dhjetë ditë. Asnjërin nga njerëzit autoritarë nuk e thërriste në Islam pa shkuar personalisht tek ai e të fliste me të. Ata thanë: *“Lëshoje vendin tonë dhe ik,”* dhe i nxitën horrat e vet kundër tij. Duke dalë nga Taifi, horrat dhe sklevërit e përcollën duke e sharë dhe duke bërtitur. Kështu rreth tij u mbledh një mori njerëzish, të cilët u renditën në dy radhë, nga ana e majtë dhe e djathtë e tij. E gjuanin me gurë dhe e ofendonin me fjalë fyese. Dikush e goditi në kordhë mbi thembër dhe gjaku i rridhte në këpucë. Zejd bin El-Harithi e mbronte me trupin e vet. Resulullahu ndiente dhembje në kokë nga zhurma e madhe, britmat dhe goditjet. Ai dhe Zejdi u mbështetën në gardhin e një kopshti, pronar i të cilit ishin Utbe dhe Shejbe, djemtë e Rebia’s, të cilët jetonin tri milje larg Taifit. Pasi u fshehën pas këtij gardhi, vagabondët u kthyen në Taif. Resulullahu hyri në kopsht dhe u ul nën një hardhi afër një muri. Pasi pushoi pak dhe u këndell nga ajo çka i ndodhi, këndoi duanë (lutjen) e njohur e cila dëshmon për pikëllimin dhe dhembjen që ndiente në zemër pas ngjarjes së tmerrshme. Resulullahu ishte i pikëlluar sepse askush prej tyre nuk e pranoi Islamin.

Duaja e njohur e Taifit është kjo:

“O Zoti im, të lutem të më japësh fuqi dhe të më nxjerrësh nga kjo situatë tejet e rëndë në të cilën gjendem. Të lutem të më mbrosh nga poshtërimi njerëzor. O më i Mëshirshmi! Ti je Mbrojtës i të dobëtëve. Ti je Mbrojtësi im. Të lutem, mos më lër në mëshirën e të huajve, të cilët më pritën armiqësisht. O Zoti im, mos më lër në duart e tyre!”

O Krijuesi im, nëse Ti nuk je i hidhëruar me mua, atëherë nuk mërzitem për të gjitha këto vuajtje. Kujdesi Yt ndaj meje është tejet i madh, i mbështetem dritës së fytyrës Sate, me të cilën ke shpërndarë errësirën, dhe me ndihmën e së cilës qeveris në këtë botë dhe në botën e ardhshme, dhe të lutem hiqe hidhërimin Tënd nga unë! Më pajis me mëshirën Tënde gjersa nuk arrij kënaqësinë Tënde. Askush nuk ka fuqi dhe forcë, përveç Teje!”

Kur e panë djemtë e Rebia’s në këtë gjendje aq të mjerë, tek ata u zgjuan ndjenjat e mirësisë, andaj thirrën robin e tyre, djaloshin e krishterë të quajtur Addas, e i thanë: *“Çoja këtë vesh rrushi atij njeriu.”* Djaloshi iu afrua Resulullahut dhe ia dha, ndërsa Resulullahu e zgjati dorën, tha *‘Bismilahi’* - në emër të Allahut, e pastaj e hëngri. Addasi tha: *“Kështu nuk flet populli i këtyre anëve.”* Resulullahu e pyeti: *“Prej nga je ti dhe cilës fe i takon?”* Ai tha: *“Unë jam i krishterë nga Niniva.”* Resulullahu shtoi: *“Ti qenke, pra, nga fshati i njeriut të mirë, Junus b. Metait.”* Ai tha: *“E nga e di ti se*

kush është Junus b. Metai?” Resulullahu u përgjigj: “Ai është vëllai im. Ai është Pejgamber, e edhe unë jam Pejgamber. “Addasi e përqafoi Resulullahun dhe filloi t’i puthte kokën, duart dhe këmbët, ndërsa djemtë e Rebia’s e shikonin tërë këtë dhe i thanë njëri-tjetrit: “Ai atje do ta prishë djaloshin. Nuk do të të dëgjoj më!”

Kur u kthye Addasi, e pyetën: “Vaj halli për ty, çfarë të ndodhi?” Ai u përgjigj: “O zotëri, ky njeri më tregoi diçka që nuk mund ta dijë askush që nuk është Pejgamber.” Që të dy i bërtitën: “I mjeri ti, o Addas, do të të nxjerrë nga feja jote e do të të shpjerë në fenë e vet, e feja jote është më e mirë se e tij.”

Pas kësaj ngjarjeje, Resulullahu doli nga vendstrehimi dhe u nis për në Mekë, me zemër të shkallmuar, plot mërzi dhe pikëllim. Kur iu afrua vendit Karnul-Menazil, afër qytetit, Allahu i dërgoi Xhibrilin, së bashku me engjëllin e kodrave, i cili i tha se nëse ai e urdhëronte engjëllin e kodrave që t’i rrëzonte dy kodrat - El-Ahsheban - (të quajtura Ebu Kubais dhe el-Ahner) mbi banorët e Mekës, ky do ta bënte.

Buhariu e transmeton gjerësisht këtë rrëfim me senedin (vargun e transmetuesve) e vet nga Urvete b. Zubejri, të cilit i ka treguar Aishja radijAllahu anha se ajo i kishte thënë Resulullahut: “A ke pasur ditë më të vështirë se ajo në Uhud (beteja në Uhud)?” Ai u përgjigj: “Gjithçka kam përjetuar nga ky popull, por më së keqi më kanë pritur në Taif, ku e kam vënë veten në ultësi ndaj Ibni Abdi Jalili-mit. Ai nuk iu përgjigj dëshirës dhe thirrjes sime që të pranonte Shehadetin, e pasi nuk e bëri këtë, u largova prej tij i brengosur dhe i shqetësuar. Kam qenë në dremetje (kllapi) derisa arrita te vendi Karnul-Menazil. Aty ngrita kokën dhe pashë një re të vogël që më bënte hije, prandaj shikova më mirë dhe pashë se në të qëndronte Xhibrili, i cili m’u drejtua: “Allahu ka dëgjuar çfarë u ke thënë atyre dhe ç’përgjigje të kanë dhënë. Allahu të dërgon engjëllin e kodrave, të cilit mund t’i urdhërosh t’u bëjë çka të duash atyre.” Pastaj dëgjova zërin e engjëllit, i cili më tha: “O Muhammed, ja ku jam, çfarë dëshiron të bëj? Nëse dëshiron t’i rrëzoj këto dy kodra - El-Ahsheban - mbi ta, vetëm thuaj.” Resulullahu tha: “Dëshiroj që Allahu t’i shpjerë në rrugë të drejtë ata që duan të besojnë Allahun e Lartësuar, Një të Vetmin, dhe nuk do të bëjnë shirk, d.m.th., nuk do t’i bëjnë Atij shok në adhurim.”⁶²

⁶² Sahihu-l-Buhari, libri mbi fillimin e Krijimit: I/458 - kaptina: Çfarë ka përjetuar Resulullahu prej mushrikëve dhe munafikëve.

Në këtë përgjigje të Resulullahut pasqyrohet personaliteti i tij i jashtëzakonshëm, i pajisur me vlerat më të larta morale. Resulullahu u këndell plotësisht dhe zemra iu qetësua nga gëzimi për ofrimin e ndihmës nga Allahu prej sferave qiellore.

Pastaj vazhdoi rrugën për në Mekë. Kur mbërriti në luginën Nahël, u ndal dhe aty qëndroi disa ditë. Në atë luginë gjendeshin dy vende të përshtatshme për qëndrim: përroi i madh malor dhe fusha pjellore. Ne kemi hulumtuar nëpër libra, por nuk kemi mundur të përcaktojmë se ku gjendet saktësisht ky vend. Gjatë qëndrimit në këtë luginë, Allahu i dërgoi Resulullahut një grup xhinësh. Për këta xhinë Allahu flet në dy vende në Kur'an:

Në suren El-Ahkaf:

“Dhe, (kujtoju atyre kohën) kur t'i dërguam ty disa xhinë për të dëgjuar Kur'anin. Kur morën pjesë (në të dëgjuarit e Kur'anit), ata i thanë (njëri-tjetrit) “Heshtni!” E, kur përfundoi (të lexuarit), u kthyen te populli i tyre si paralajmërues. Ata thanë: “O populli ynë! Ne dëgjuam Librin, të shpallur pas Musait, i cili vërteton se janë të vërteta edhe ato para tij, i cili udhëzon te e vërteta dhe në rrugën e drejtë. O populli ynë, përgjigjuni të dërguarit të Allahut dhe besojini Atij! Ai do t'ju falë disa mëkate dhe do t'ju shpëtojë prej dënimit të dhimbshëm.” (El-Ahkaf: 29-31).

Në suren El-Xhinn:

“Thuaj (o Muhammed!): Mua m'u ka shpallur se disa prej xhinëve kanë dëgjuar dhe kanë thënë: “Me të vërtetë, kemi dëgjuar (një) Kur'an të mrekullueshëm, i cili udhëzon në rrugën e drejtë - e ne kemi besuar në të, dhe assesi nuk do t'i bëjmë shok askënd Zotit tonë.” (El-Xhinn: 1-2).

Nga këto ajete të cekura, si dhe nga traditat të cilat kanë rezultuar nga komentimi i këtyre bisedave, na bëhet e qartë se Resulullahu nuk ka qenë i njoftuar për ekzistencën e xhinëve. Për ta ka mësuar vetëm pas shpalljes së këtyre ajeteve. Kjo ka qenë hera e parë që është gjetur në shoqërinë e xhinëve. Teksti i traditave të mëvonshme na bën të ditur se ata kanë ardhur më shpesh pas këtyre ngjarjeve.

Në të vërtetë, Kur'ani ia ka zbuluar Resulullahut botën e xhinëve dhe i ka bërë të ditur aspektin e ri të ofrimit të ndihmës dhe thesarin e panjohur të gajbit (të panjohur dhe të pakuptueshëm për ne). Ndihma me ushtri, të cilën nuk e di as

nuk e sheh askush përveç Tij, është vërtetuar në ajetet e shpallura, në të cilat paralajmërohet suksesi i da'vetit të Resulullahut.

Me këtë njohuri të re është vërtetuar gjithashtu se asnjë fuqi e kësaj bote nuk është në gjendje t'ia zërë rrugën Islamit dhe suksesit të tij. Allahu, thotë:

“E ata që nuk i përgjigjen të dërguarit të Allahut, të atillët nuk do të mund t'i ikin Atij në Tokë dhe për ta s'ka mbrojtës, përveç Allahut. Ata janë në humbje të madhe.” (El-Ahkaf: 32).

“Dhe ne e kemi ditur se nuk do të mund t'i shpëtojnë Allahut në Tokë dhe nuk mund ta lodhin Atë duke ikur (në qiell).” (El-Xhinn: 12)

Pas kësaj ndihme, pas kësaj fitoreje dhe pas këtyre paralajmërimeve, u shpërndanë retë e errësirës, të trishtimit dhe të pikëllimit, të cilat e përcillnin Resulullahun të demoralizuar dhe të pikëlluar që nga dalja prej Taifit, dhe ai u kthye në Mekë me bindje të thellë që të vazhdonte misionin e filluar rreth interpretimit të Islamit dhe pranimit të Shpalljes së amshueshme të Allahut, me elan, fuqi, vullnet dhe entuziazëm të ri.

Atëherë, Zejd b. Harithi i thotë Resulullahut për afërsisht kështu: *“Si do të shkosh përsëri në Mekë, pasi të kanë dëbuar prej andej?”* Ai u përgjigj: *“O Zejd, siç po e sheh edhe vetë, Allahu ka zgjidhje për çdo gjë dhe sjell lehtësime. Ai do ta ndihmojë Fenë e Vet dhe do ta lartësojë Pejgamberin e Vet.”*

Pastaj Resulullahu vajti në shpellën Hira, prej ku e dërgoi një njeri nga familja Huza'ah tek Ahnes b. Shurejke që ta merrte nën mbrojtje. Ai u përgjigj: *“Unë nuk jam vendas, vetëm vendasit mund të marrin dikë nën mbrojtjen e vet.”* Pastaj dërgoi njërin të Suhejl b. Amri, e ky tha: *“Vërtet, familja Benu Amir nuk mund ta mbrojë familjen Benu Ka'b.”* Pastaj e dërgoi tek El-Mut'am b. Adijji, e ky u përgjigj: *“Po, unë e marr atë nën mbrojtjen time.”* Mandej ky thirri djemtë dhe fisin e vet dhe u tha: *“Armatosuni që të gjithë dhe shpërndahuni nëpër qoshet e Ka'bes, sepse e kam marrë Muhammedin nën mbrojtjen time.”* Pastaj dërgoi që të thërrisnin Resulullahun e të hynte në Mekë. Resulullahu u paraqit me Zejd b. Harithin dhe kaloi gjer në mesxhidul-Haram, ku u ndal. Mut'am b. Adijji u ngrit mbi devenë e vet dhe bërtiti: *“O kurejshë, unë e kam marrë Muhammedin nën mbrojtjen time, prandaj askush prej jush nuk guxon ta ofendojë.”* Në atë moment Resulullahu, i cili bënte tavaf

rreth Ka'bes, arriti te qoshja dhe këndoi duanë.⁶³ Pastaj i fali dy rekate namaz dhe vajti në shtëpinë e vet, gjersa Mu'ami dhe njerëzit e tij të armatosur e përcollën deri aty.

Rrëfëhet se Ebu Xhehli e ka pyetur Mu'amin: "A je mbrojtës i tij apo ithtar i tij?" Ai i përgjigjet: "Vetëm mbrojtës." Atëherë Ebu Xhehli tha: "Atë që e mbron ti edhe ne do ta konsiderojmë të mbrojtur."⁶⁴

Resulullahu nuk e ka harruar kurrë këtë vepër të mirë të Mu'amt, andaj në Bedër, përkitazi me robërit e luftës, ka thënë: "Po të ishte gjallë Mu'am b. Adijji e të ndërmjetësonte për këta këtu, të gjithë këta do t'ia lija atij."⁶⁵

Mësimet e përfituar nga ndodhia e Hixhretit në Taif

Meditimi i kësaj ndodhie do të na bënte të përfitonim mësimet e rëndësishme, nga të cilat veçojmë:

1. Vuajtjet, mundimet, torturat dhe persekutimet, me të cilat u ballafaqua Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*], janë pjesë përbërëse e misionit për kumtim. Ai ashtu sikurse ua mëson njerëzve besimin e vërtetë tek Krijuesi dhe dispozitat e adhurimeve, po kështu erdhi t'ua kumtojë praktikisht atyre durimin, ballafaqimin dhe format përkatëse të demonstrimit të tyre. Erdhi ta demonstrojë në praktikë atë që Allahu na urdhëroi:

"O ju besimtarë, bëni durim, bëhuni të qëndrueshëm kundër armikut, rrini të përgatitur dhe, që të shpëtoni, ruajuni dënimet të All-llahut." (Ali Imran: 200)

Po kështu, Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ka thënë: "Merrini prej meje ritet tuaja!"

Me këtë Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] sikur thotë: 'Duroni ashtu sikur kam duruar unë.'

Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] ua mësonte sahabëve artin e durimit në rrugën e Zotit, duke mos u hakmarrë ndaj atyre mendjelehtëve që e

⁶³ Pasi të kryhet rrethi i tavafit rreth Ka'bes, qëndrohet në këndin nga ku ka filluar tavafi, kthehen pëllëmbët e duarve nga këndi - Rukna - dhe këndohet duaja, pastaj vazhdon rrethi i dytë, e kështu me radhë. (shën. i përkth.).

⁶⁴ Ibni Hisham: I/419, 420, 441, 442; Zadu-l-Me'ad: II/46, 47; Muhtesar Siretu-r-Resul nga En-Nexhdi, f. 141-143; Rahmetun li-l-Alemin: I/71-74; Tarihu Islami nga Abadi: I/123, 124.

⁶⁵ Sahihu-l-Buhari: II/573.

provokuan, ani pse kishte mundësi hakmarrje sidomos kur i erdhi meleku i kodrave me Xhibrilin [*alejhimas selam*] dhe i tha se ishte në dispozicion të tij. Në fakt, ai vetëm priste urdhrin që të hidhte mbi ta një kodër të tërë, por, jo. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] tha: 'Kam shpresë se Allahu do të nxjerrë nga pasardhësit e tyre gjenerata që do ta adhurojnë vetëm Allahun dhe nuk do t'i shoqërojnë Atij askënd!'

2. Ankesa e Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*] tek Allahu nuk nënkupton plogështinë, ngase ajo në relacion me Allahun është një lloj adhurimi dhe përluje. Sprovat dhe fatkeqësitë kanë urtësi të shumta, një prej tyre është se e shtyjnë të sprovuarin drejt derës së Allahut. Nuk ka kundërthënie ndërmjet durimit të sprovave dhe ankimit tek Allahu. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] na i mësoi të dy çështjet. Shpirti i njeriut, sado të jetë i lartësuar, nuk mund të dalë jashtë njerëzores. Ai, nga vetë natyra, ndien kënaqësinë e begative dhe dhimbjen e ndëshkimit. Qetësohet me të parën dhe frikësohet nga e dyta. Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] favorizonte këtë të dytën, për ta kënaqur Allahun dhe për ta kryer obligimin e adhurimit ndaj Tij.
3. Nëse thellohemi pak në këtë ndodhi nga jeta e Pejgamberit [*alejhis salatu ves selam*], do të gjejmë se Allahu nuk ka dashur që, për shkak të dhimbjeve dhe problemeve, Muhammedi [*alejhis salatu ves selam*] të goditej nga pesimizmi apo plogështia. Pas torturave që ia bënë mendjelehtët, ne hasim në mirësinë e Allahut. Në këtë gjendje atij i vjen një argument mbështetës se feja e tij ishte feja e vetme e qëlluar. Addasi i krishterë erdhi i solli rrush dhe ia puthte kokën, duart, këmbët, për shkak se Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] e lajmëroi se ishte pejgamber, ashtu sikurse pejgamberi Junus Ibn Meta. Po kështu, edhe dy bijtë e Rebiah Ibn Utbes, që ishin armiq të përbetuar të tij, më në fund i qëndronin përpara me rrush.
4. Qëndrimi i Zejb Ibn Harithes, për ta mbrojtur Pejgamberin [*alejhis salatu ves selam*] nga torturat e mendjelehtëve taifasë, duhet të shërbejë si mësim se si duhet të sillemi me liderët tanë fetarë, kur atyre iu kanoset ndonjë rrezik.

Kjo po kështu nënkupton se muslimanët duhen gjithnjë të kenë liderë, në çdo kohë dhe vend, të cilët marrin përgjegjësitë e kumtimit të fesë. Besimtarët duhet të jenë në shërbim të tyre dhe të tregojnë gatishmëri kurdoherë që shfaqet nevoja e mbrojtjes së tyre.

5. Rrëfimi i dëgjimit të Kur'anit nga xhinët është argument, *së pari*, për ekzistimin e tyre, *së dyti*, për ngarkimin e tyre me besim dhe obligime, dhe *së treti*, se prej tyre ka besimtarë dhe jobesimtarë.

Kjo ndodhi është e vërtetë dhe Kur'ani e ka trajtuar atë në kaptinat el-Xhinn dhe el-Ahkaf.

Besimtarët duhet të besojnë se xhinët ekzistojnë dhe se ata janë të obliguar me adhurimin e Zotit sikurse ne, porse ne nuk mund t'i shikojmë me sytë tanë.

Besimtarët janë unikë sa i përket asaj se mohimi i ekzistimit të xhinëve është kufër dhe dalje prej feje, ngase kështu po mohohet diç që duhet pranuar patjetër.

6. Gjatë kthimit për në Mekë, Zejdi e pyeti Pejgamberin [*alejhis salatu ves selam*]: "Si po kthehesh në Mekë kur ata të nxorën me dhunë prej saj?!", ndërsa Pejgamberi [*alejhis salatu ves selam*] iu përgjigj: "O Zejd! Ke për të parë se si Allahu do të na bëjë zgjidhje dhe rrugëdalje. Allahu do ta ndihmojë fenë e Tij dhe do ta përkrahë të Dërguarin e Tij!"

Me gjithë këto vuajtje dhe mundime që pati, prapë asgjë nuk mundi ta dobësonte lidhjen e tij me Allahun. Ky besim i madh tek Allahu ishte sigurisht fryt i pejgamberisë.

Duke u bazuar në këtë, sprovat dhe problemet nuk duhet t'i zbrapsin thirrësit nga rruga e përhapjes së fjalës së Allahut. Thirrësit, me shtimin e problemeve dhe barrierave, duhet të shtojnë zellin dhe aktivitetet, ngase ai që ka për burim fuqie Allahun, nuk duhet të ndiejë lodhje kurrë. Derisa Allahu është Ai që urdhëron për kumtim, padyshim se ndihma dhe përkrahja e Tij janë me thirrësit. Lodhja, përtacia dhe zbrapsja janë imazhe vetëm të atyre që burim të fuqisë së tyre nuk e kanë Allahun dhe fenë e Tij, por mbështeten në potencialet dhe kapacitete e tyre. E duke e ditur se fuqia e njeriut është e kufizuar, atëherë nuk ka vend për çudi kur të shohim se si, në rast ballafaqimi me sprova dhe vështirësi, njeriu dëshpërohet dhe dështon.

Dhe Allahu xh.sh. Zoti o boterave di me mire.

Univerziteti Taibah-El Medinetul Munewere, Arabia Saudite